

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

PKR. Nr. 490/15

15 tetor 2015

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm]

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it, Jennifer Seel si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarja e Kosovës, Naime Krasniqi Jashanica dhe Gjyqtarja e EULEX-it, Katrien Gabriel Witteman, si anëtare e trupit gjykues, e asistuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it, Laurentiu Dumitrica si procesmbajtëse, në rastin penal kundër:

1)

Emri:	S.
Mbiemri:	Q.
Pseudonimi:	C.
Emri dhe mbiemri i babit:	I.Q
Emri i nënës / mbiemri i vajzërisë:	Sh. M.
Shtetësia:	Kosovar
Data e lindjes:	xxx
Vendi i lindjes:	xxx
Gjinia:	Mashkull
Vendbanimi:	xxx, Kosovë
Statusi civil:	xxx, xxx
Profesioni:	xxx
Niveli i arsimimit:	xxx

I akuzuar me aktakuzë të Zyrës së Prokurorit Special të Republikës së Kosovës PPS 40/2013 të datës 15 shtator 2014, e parashtruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës më 18 shtator 2014, (në tekstin e mëtutjeshëm “Aktakuza”) për akuzat si në vijim:

Akuza 3: **Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar**, në kundërshtim me nenin 283, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës më 2012 dhe ishte e zbatueshme neni 274 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës më 2003, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.

Akuza 4: **Kontrabandë me imigrantë**, në kundërshtim me nenin 170, paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës më 2012, dhe ishte i zbatueshëm neni 138 paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës më 2003, e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri jo më pak se pesë (5) vjet.

Akuza 10: **Dhënia e Ndhmës një personi tjetër në Pastrim të Parave**, në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), në lidhje me nenin 32 të *Ligjit 03 / L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit*, e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë të vlerës së pasurisë që është objekt i veprës penale.

2)

Emri	F.
Mbiemri	K.
Pseudonimi	M.
Emri dhe mbiemri i babait	A.K.
Emri i nënës / mbiemri i vajzërisë	A. H.
Shtetësia:	Kosovar
Data e lindjes:	xxx
Vend i lindjes:	xxx
Gjinia:	Male
Vendbanimi:	xxx Kosovë
Statusi civil:	xxx, xxx
Profesioni:	xxx
Niveli arsimor:	xxx

I ngarkuar në aktakuzë me akuzat si në vijim:

Akuza 3: **Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar**, në kundërshtim me nenin 283, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës më 2012 dhe ishte e zbatueshme neni 274 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës më 2003, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.

Akuza 5: **Kontrabandë me imigrantë**, në kundërshtim me nenin 170, paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës më 2012, dhe ishte i zbatueshëm neni 138 paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës më 2003, e

dënueshme me gjobë dhe me burgim deri jo më pak se pesë (5) vjet si anëtar i grupit, në bashkë kryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së.

3)

Emri	L.
Mbiemri	M.
Pseudonimi	
Emri dhe mbiemri i babait	B. M.
Emri i nënës / mbiemri i vajzërisë	Sh.R.
Shtetësia	Kosovar
Data e lindjes	xxx
Vendi i lindjes	xxx, Kosovë
Gjinia	Mashkull
Vendbanimi	xxx, Kosovë
Statusi Civil	xxx, xxx
Profesioni	xxx
Niveli i arsimimit	xxx

I ngarkuar në aktakuzë sipas akuzave në vijim:

Akuza 3: **Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar**, në kundërshtim me nenin 283, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës më 2012 dhe ishte i zbatueshëm neni 274 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës më 2003, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.

Akuza 6: **Kontrabandë me migrantë**, në kundërshtim me nenin 170, paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës më 2012, dhe ishte i zbatueshëm neni 138 paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës më 2003, e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri jo më pak se pesë (5) vjet si anëtar i grupit, në bashkë kryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së.

Akuza 10: **Dhënia e Ndhmës një personi tjetër në Pastrim të Parave**, në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), në lidhje me nenin 32 të *Ligjit 03 / L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit*, e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë të vlerës së pasurisë që është objekt i veprës penale.

4)

Emri	S.
Mbiemri	S.
Pseudonimi	
Emri dhe mbiemri i babait	S. M.
Emri i nënës/ mbiemri i vajzërisë	F. Th.
Shtetësia	Kosovar
Data e lindjes	xxx
Vendi i lindjes	xxx, Kosovë
Gjinia	Male
Vendbanimi	xxx, Kosovë
Statusi Civil	xxx, xxx
Profesioni	xxx
Niveli i Arsimimit	xxx

I ngarkuar në aktakuzë sipas akuzave në vijim:

Akuza 3: **Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar**, në kundërshtim me nenin 283, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës më 2012 dhe ishte i zbatueshëm neni 274 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës më 2003, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.

Akuza 7: **Kontrabandë me imigrantë**, në kundërshtim me nenin 170, paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës më 2012, dhe ishte i zbatueshëm neni 138 paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës më 2003, e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri jo më pak se pesë (5) vjet si anëtar i grupit, në bashkë kryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së.

Akuza 10: **Dhënia e Ndhmës një personi tjetër në Pastrim të Parave**, në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), në lidhje me nenin 32 të *Ligjit 03 / L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit*, e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë të vlerës së pasurisë që është objekt i veprës penale.

Pasi janë mbajtur seancat dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më:

1, 2, 21, 23 prill 2015;
2, 3, 4, 9, 10 qershor 2015;
7, 21, 22, 23 korrik 2015;
16, 17 shtator 2015;
13 tetor 2015.

Pas këshillim votimit që u mbajt më 14 dhe 15 tetor 2015;

Në pajtim me nenin 359 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, me datën 15 tetor 2015, nxjerr dhe shpall publikisht dhe në prani të të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe prokurorit, si vijon:

AKTGJYKIM

I. Në pajtim me nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Nr. 04/L-123 në fuqi që nga 1 janari 2013, me poshtë "KPP", në lidhje me **Akuzën 3** të aktakuzës, të pandehurit **S.Q., F.K., L.M. dhe S.S.** janë gjetur:

FAJTORË

Për veprën penale të **pjesëmarrjes në grup të organizuar kriminal**, në shkelje të nenit 283, paragrafët 1 dhe 5 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012,

Sepse

S.Q. nga 1 nëntori 2012 deri 9 dhjetor 2013, **F.K.** nga 15 nëntori 2012 deri 9 dhjetor 2013, **L.M.** nga 26 nëntori 2012 deri 9 dhjetor 2013 dhe **S.S.** nga 18 dhjetori 2012 deri 9 dhjetor 2013, në territorin e Kosovës dhe Serbisë, kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga ata vetë, bashkë kryesi i dënuar **S.Q1** dhe bashkë kryesit ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza si A.H., Z.V., A.H.S., A.J. O., M.L., I.B., A.L., R.R., E.P.S., Z.N., P.S., S.O., N.N e njohur si "N.", "V.G.K.", e njohur si "V.", A.C., G.I. dhe M.P, të cilët kanë vepruar në territorin e Kosovës, Serbisë, Hungarisë, Austrisë dhe Italisë, me synimin dhe me njohuri për qëllimin dhe veprimtaritë e përgjithshme të grupit të organizuar kriminal ose me synimin për të kryer një ose më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej se paku katër vjet, pikërisht

kontrabandimin e migrantëve në kundërshtim me nenin 170 të Kodit Penal të Kosovës duke e ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuonte në arritjet e veprimtarive kriminale të grupit, dhe kanë kryer krimin e rëndë në fjalë si pjesë e grupit të organizuar kriminal, me qëllim që të siguronin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfitime financiare ose përfitime të tjera materiale.

II. Në pajtim me nenin 365 të KPP-së, në lidhje me **Akuzën 4** të aktakuzës, i pandehuri **S.Q.** është gjetur:

FAJTOR

Për veprën penale të **kontrabandimit të migrantëve** si anëtar i grupit, në vazhdimësi, në shkelje të nenit 170, paragrafët 1 dhe 6 dhe nenit 81 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012,

Sepse

Prej rreth 23 janarit deri 25 nëntor 2013, **S.Q.**, në territorin e Kosovës, është angazhuar në kontrabandimin e migrantëve duke ua mundësuar personave të cilat nuk janë shtetas ose banorë të përhershëm të një shteti të caktuar që të kalojnë kufirin pa përmbushur kushtet për të hyrë e qëndruar në mënyrë të ligjshme në shtetin e caktuar pa përfillur kushtet e nevojshme ligjore për qëndrim me anë të mjeteve të deklaruara më parë ose me anë të mjeteve të tjera të paligjshme, për veprimet individuale në vijim në lidhje me personat e shënuar më poshtë:

(1) Kontrabandimin i migrantëve më ose rreth 23-24 janarit 2013, në lidhje me një grup prej shtatëmbëdhjetë (17) shtetasve të Kosovës, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari, të cilët u arrestuan më 24 janar 2013 në Bácsalmás, Hungari për hyrje pa dokumente ligjore: B.M. (i lindur më xxx), B.B (lindur më xxx), M.A (lindur më xxx), U.H (lindur më xxx), A.A (lindur më xxx), D.S. (lindur më xxx), J.I (lindur më xxx), B.M1 (lindur më xxx), Z.A (lindur më xxx), N.T.((lindur më xxx), A.S.((lindur më xxx), H.Z. (lindur më xxx), N.M.((lindur më xxx), M.B.M (lindur më xxx), B.T. (lindur më xxx), A.B (lindur më xxx), dhe N.A.((lindur më xxx), me vend mbërritje të mëtejshme të synuar si Vjena, Austri, e kryer si pjesë e grupit me S.Q1., A.H.S., R.R., F.K dhe bashkë kryes të tjerë ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza;

(2) Kontrabandimin i migrantëve mes 20 dhe 28 qershorit 2013, në lidhje me njëmbëdhjetë (11) shtetas të Kosovës, pikërisht S.D.((lindur më xxx., Nr. letërnjoftimi xxx.), D.J (lindur më xxx., Nr. letërnjoftimi xxx.), V.G (lindur më xxx., Nr. letërnjoftimi xxx.), S.H (lindur më xxx., Nr. letërnjoftimi xxx.), M.R (lindur më xxx., Nr. letërnjoftimi xxx.), P.H (lindur më xxx., ID xxx), L.H (lindur më xxx), E.H.((lindur më xxx), L.H.1 (lindur më

xxx), A.H (lindur më xxx) dhe A.D (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari, me vend mbërritje të mëtejshme të synuar si Vjena, Austri, e kryer si pjesë e grupit me S.Q1., M.L., I.B. dhe bashkë kryes të tjerë ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza;

(3) Kontrabandimin i migrantëve mes 16 korrikut 2013 dhe 10 gushtit 2013 në lidhje me një grup të shtetasve të Kosovës përfshirë R.R, (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tej në Vjenë, Austri, dhe Udine, Itali, e kryer si pjesë e grupit me S.Q1., L.M dhe bashkë kryes të tjerë ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza;

(4) Kontrabandimin i migrantëve mes 19 dhe 26 shtatorit 2013, në lidhje me një numër të pacaktuar të shtetasve të Kosovës përfshirë B.B.H., D.M (lindur më xxx), F.R.(lindur më xxx), T.R (lindur më xxx) dhe R.K (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tej në Vjenë, Austri, i kryer si pjesë e grupit me S.Q1., F.K., L.M., S.S. dhe bashkë kryes të tjerë ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza;

(5) Kontrabandimin i migrantëve mes 7 dhe 25 nëntorit 2013, në lidhje me një grup prej katër (4) shtetasve të Kosovës përfshirë Sh.H (lindur më xxx në xxx), E.H (lindur më xxx në xxx) dhe Sh.O. (lindur më xxx në xxx), të cilët u arrestuan në Hungari më xxx, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari, me vend mbërritje të mëtejshme të synuar si Vjena, Austri, të kryer si pjesë e grupit me S.Q1., F.K., L.M., S.S., N.N si "N.", "V.G.K. e njohur si "V." dhe bashkë kryes të tjerë ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza.

III. Në bazë të nenit 365 të KPPK, në lidhje me **Akuzën 5** të aktakuzës, i pandehuri **F.K.** është gjetur:

FAJTOR

Për veprën penale të **Kontrabandimit me migrantë** si anëtar, të nenit 170, paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 81 i Kodit Penal të Kosovës të 2012,

Pasi që

Nga data prej 23 janarit 2013 deri më 9 dhjetor 2013, **F.K.** në territor të Kosovës dhe Serbisë, i përfshirë në kontrabandimin me migrantë duke i mundësuar personave të cilët nuk janë shtetas apo banor të përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë, pa i përfillur kushtet e domosdoshme ligjore për qëndrim, me mjetet e lartpërmendura ose me çfarëdo mjetesh tjera të paligjshme, mbi veprimet individuale dhe në lidhje me personat e poshtë shënuar:

- (1) Kontrabandimi me migrantë rreth datave 23-24 janar 2013, në lidhje me një grup prej shtatëmbëdhjetë (17) shtetasve të Kosovës, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari, të cilët ishin arrestuar më 24 janar 2013 në Bácsalmás, Hungari për hyrje pa dokumente të ligjshme: B.M. (i lindur më xxx), B.B (i lindur më xxx), M.A (i lindur më xxx), U.H (i lindur më xxx), A.A (i lindur më xxx), D.S. (i lindur më xxx), J.I (i lindur më xxx), B.M1 (i lindur më xxx), Z.A (i lindur më xxx), N.T (i lindur më xxx), A.S (i lindur më xxx), H.Z (i lindur më xxx), N.M (i lindur më xxx), M.B.M (e lindur më xxx), B.T (i lindur më xxx), A.B (e lindur më xxx), dhe N.A (i lindur më xxx), me vazhdim më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me S.Q1., A.H.S., R.R., S.Q, dhe bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (2) Kontrabandimi me migrantë në apo rreth 9 prillit 2013, në lidhje me pesë (5) shtetas të Kosovës nga Kosova përmes Serbisë në Hungari, të cilët ishin arrestuar më 09 prill 2013 në Kunbaja, Republikën e Hungarisë për hyrje pa dokumente të ligjshme: B.M.1 (xxx), V.J.(xxx) dhe 3 të tjerë, me vazhdim të mëtejshëm në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me S.Q1., P.S., dhe bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (3) Kontrabandimi me migrantë në mes të 19 dhe 26 shtatorit 2013, në lidhje me një numër të shtetasve Kosovar, të cilët janë dyshuar se kanë përfshirë B., B.H., D.M, (lindur më xxx), F.R (lindur më xxx) dhe T.R. (lindur më xxx), Rasim Kabashaj (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me S.Q1., “A.”, **S.Q., L.M., S.S** dhe bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (4) Kontrabandimi me migrantë në mes të 7 dhe 25 nëntor 2013, në lidhje me një grup prej katër personash (4) shtetas të Kosovës duke përfshirë Sh.H (lindur më 17/2/1987 Plluzhine), E.H (lindur më 02/5/1988 Plluzhine) dhe Sh.O (lindur më 05/3/1997 Izbice), të cilët janë arrestuar në Hungari më 24/25 nëntor 2013, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari , me vazhdim më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me S.Q1., **S.Q., L.M., S.S.**, N.N. të njohur si “N.”, “V.G.K të njohur si “V.”, dhe bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (5) Kontrabandimi me migrantë në mes të 29 nëntorit dhe 9 dhjetorit 2013 në lidhje me një grup të shtetasve të Kosovës , nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me S.Q1., **L.M., S.S** dhe bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar.

IV. Në bazë të nenit 365 të KPPK, në lidhje me **Akuzën 6** të aktakuzës, i pandehuri **L.M.** është gjetur:

FAJTOR

Për veprën penale të **Kontrabandimit me migrantë** si anëtar të një grupi, në vazhdimësi, në shkelje të nenit 170, paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 81 të Kodit Penal të Kosovës 2012,

Pasi që

Nga data prej 7 qershorit 2013 deri më 9 dhjetor 2013, **L.M.**, në territor të Kosovës dhe Serbisë, i përfshirë në **Kontrabandimin me migrantë** duke i mundësuar personave të cilët nuk janë shtetas apo banor të përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë, pa i përfillur kushtet e domosdoshme ligjore për qëndrim, me mjetet e lartpërmendura ose me çfarëdo mjetesh tjera të paligjshme, mbi veprimet individuale dhe në lidhje me personat e poshtë shënuar:

- (1) Kontrabandimi me migrantë në mes të datës 7 dhe 19 qershor 2013, në lidhje me katër (4) grupe të shtetasve të Kosovës duke përfshirë emrin **A.R** (lindur më xxx, letërnj. xxx), **Sh.S** (lindur më xxx, letërnjoftim xxx) dhe **R.S** (lindur më xxx, letërnj. xxx), grupi i parë është kontrabanduar në apo rreth 7 qershorit 2013, duke përfshirë **N.M** (lindur më xxx), grupi i dytë i kontrabanduar në ose rreth datave 13-14 qershor 2013, duke përfshirë **N.A** (lindur më xxx), grupi i tretë i kontrabanduar në ose rreth 17 qershorit 2013 dhe grupi i katërt i kontrabanduar në ose rreth datës 18 qershor 2013, duke përfshirë **F.K** (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri dhe Udine, Itali, kanë kryer veprën si anëtar të grupit me **S.Q1.**, **M.L.**, **I.B.**, dhe me bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (2) Kontrabandimi me migrantë në mes të 16 qershorit dhe 10 gushtit 2013, në lidhje me një grup të shtetasve të Kosovës të dyshuar duke përfshirë **R.R.**, (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri dhe Udine, Itali, të kryer si anëtar të grupit me **S.Q1.**, **S.Q.**, dhe me bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (3) Kontrabandimi me migrantë në mes të datës 4 dhe 19 shtator 2013, në lidhje me një grup të shtetasve të Kosovës duke përfshirë **F.G.** dhe **A.S.**, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me **S.Q1.**, **A.H.S.**, dhe me bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (4) Kontrabandimi me migrantë në mes të datës 19 dhe 26 shtator 2013 në lidhje me një numër të shtetasve Kosovar të dyshuar duke përfshirë **B.**, **B.H.**, **D.M** (lindur më xxx), **F.R** (lindur më xxx) dhe **T.R** (lindur më xxx), **R.K** (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me **S.Q1.**, **S.Q.**, **F.K.**, **S.S.**, dhe me bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;

- (5) Kontrabandimi me migrantë në mes të datës 29 shtator dhe 2 tetor 2013, në lidhje me një grup të shtetasve të Kosovës, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tutje në Vjenë, Austri, të kryer si anëtar të grupit me S.Q1 dhe me bashkë kryesit e tjerë të pa akuzuar;
- (6) Kontrabandimi me migrantë në mes të 3 dhe 14 tetorit 2013, në lidhje me shtetasit e Kosovës A.S. dhe Q.S dhe grupet e shtetasve të Kosovës të arrestuar në Hungari më 8 tetor 2013, siç janë M.Th (lindur më xxx), L.U. (lindur më xxx), F.M. (lindur më xxx), H.S.((lindur më xxx), A.I (lindur më xxx xxx) dhe A.I. 1 (lindur më xxx xxx) dhe më 9 tetor 2013, siç janë L.U (lindur më xxx) dhe F.M. (lindur më xxx), nga Kosova përmes Serbisë për në Hungari, dhe kur ishin të suksesshëm, më tej në Vjenë, Austri, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1, dhe bashkë kryes të tjerë të pa- akuzuar;
- (7) Kontrabandimi me migrantë mes datave 7 dhe 25 nëntor 2013, në lidhje me një grup prej katër (4) qytetarëve të Kosovës duke përfshirë Sh.H.((i lindur me xxx në xxx), E.H (i lindur me xxx në xxx) dhe Sh.O (i lindur me xxx në xxx), të cilët qenë arrestuar në Hungari me datë 24/25 nëntor 2013, nga Kosova përmes Serbisë për në Hungari, si qëllim destinacioni duke pasur Vjenën në Austri, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1., **S.Q., F.K., S.S.**, A.C., N.N të njohur si “N”, “V.G.K, e njohur si “V”, dhe bashkë kryes të tjerë të pa-akuzuar;
- (8) Kontrabandimi me migrantë mes datave 29 nëntor 2013 dhe 9 dhjetor 2013 në lidhje me një grup të qytetarëve të Kosovës, nga Kosova përmes Serbisë për në Hungari dhe më tej në Vjenë, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1., **F.K., S.S** dhe bashkë kryes të tjerë të pa-akuzuar;
- V.** Në bazë të nenit 365 të KPP-së, në lidhje me **Pikën 7** të aktakuzës, I pandehuri **S.S** është gjetur:

FAJTOR

për veprën penale të **Kontrabandimit me migrantë** si pjesëtar i një grupi, në vazhdim, në shkelje të nenit 170, paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 81 i Kodit Penal të Kosovës, të vitit 2012,

Sepse

Nga ose rreth datës 16 qershor 2013, e gjer më 9 dhjetor 2013, **S.S**, në territorin e Kosovës dhe Serbisë, është angazhuar në kontrabandimin e migrantëve duke u mundësuar personave që nuk janë shtetas apo banorë të përhershëm të një shteti të caktuar për të

kaluar kufirin, pa përputhje me kërkesat për hyrje të ligjshme dhe të mbeten në shtetin në fjalë pa përmbushur kushtet e domosdoshme ligjore për të qëndruar nga mjetet më parë të cekura apo me mjete të tjera të paligjshme, në lidhje me veprimet e individëve dhe në lidhje me personat e dhënë si në vijim:

- (1) Kontrabandimi me migrantë mes datave 16 dhe 19 qershor 2013, në lidhje me tetë (8) qytetarë të Kosovës A.S (i lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx), N.K (i lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx), L.Th (e lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx), L.Th.1 (i lindur me xxx), A.M (e lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx), F.M (i lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx), K.B. (i lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx dhe A.N (i lindur me xxx, nr. i letërnjoftimit xxx) nga Kosova, përmes Serbisë, për në Hungari, me destinacion të synuar Vjenën, në Austri, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1., M.L., I.B, dhe bashkë kryes të tjerë të pa-akuzuar;
- (2) Kontrabandimi me migrantë mes datave 19 dhe 26 shtator 2013, në lidhje me qytetarët e Kosovës, që dyshohet të përfshijë të ashtuquajturin B., B.H., D.M (i lindur me xxx), F.R (i lindur me xxx), T.R (i lindur me xxx), dhe R.K (i lindur me xxx), nga Kosova, përmes Serbisë, për në Hungari, me destinacion të synuar Vjenën në Austri, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1., **S.Q., F.K., L.M.**, dhe bashkë kryes të tjerë të pa-akuzuar;
- (3) Kontrabandimi me migrantë mes datave 7 dhe 25 nëntor 2013 në lidhje me një grup prej katër (4) qytetarë të Kosovës, duke përfshirë Sh.H (i lindur me xxx në xxx), E.H. (i lindur me xxx në xxx) dhe Sh.O (i lindur me xxx në xxx), të cilët qenë arrestuar në Hungari me datë 24/25 nëntor 2013, nga Kosova, përmes Serbisë, për në Hungari, me destinacionin e synuar Vjena në Austri, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1., **S.Q., F.K., L.M.**, A.C., N.N të njohur si “N.”, V.G.K, e njohur si “V.”, dhe bashkë kryes të tjerë të pa-akuzuar;
- (4) Kontrabandimi me migrantë mes datave 29 nëntor dhe 9 dhjetor 2013, në lidhje me një grup të qytetarëve të Kosovës, nga Kosova, përmes Serbisë për në Hungari dhe më tej në Vjenë, e kryer si pjesë e një grupi me S.Q1., **F.K., L.M.** dhe bashkë kryes të tjerë të pa-akuzuar.

VI. Në bazë të nenit 364 (1.3) të KPP-së , në lidhje me **Pikën 10** të Aktakuzës, të pandehurit **S.Q., L.M., F.K. dhe S.S** përmes kësaj

LIROHEN

nga kryerja e veprës penale të; **Ndihma e dhënë një personi tjetër për pastrimin e parave**, e dënueshme me nenin 25, paragrafi 1 i KPK-së in në lidhshmëri me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-196 mbi parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit,

Sepse

nuk është provuar se të pandehurit e kanë kryer veprën me të cilën ata kanë qenë të akuzuar në aktakuzë.

- VII.** Pas aktgjykimeve me të cilat janë shpallur fajtorë, si më sipër, në bazë të nenit 365, paragrafi 1.3 i KPP-së, Gjykata, me anë të kësaj, cakton DËNIMET, si në vijim:

S.Q. për kryerjen e veprës penale të Pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal në lidhje me kontrabandimin e migrantëve, si një anëtar i një grupi, në vazhdim, në shkelje të nenit 283, paragrafët 1 dhe 5, neni 170, paragrafët 1 dhe 6 dhe nenit 81, të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, me anë të kësaj, dënohet me **katër (4) vjet burgim** dhe me një **gjobë prej njëmijë (1.000) Eurosh**.

F.K. për kryerjen e veprës penale të Pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal në lidhje me kontrabandimin e migrantëve, si një anëtar i një grupi, në vazhdim, në shkelje të nenit 283, paragrafët 1 dhe 5, neni 170, paragrafët 1 dhe 6 dhe nenit 81, të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, me anë të kësaj, dënohet me **katër (4) vjet burgim** dhe me një **gjobë prej njëmijë (1.000) Eurosh**.

L.M. për kryerjen e veprës penale të Pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal në lidhje me kontrabandimin e migrantëve, si një anëtar i një grupi, në vazhdim, në shkelje të nenit 283, paragrafët 1 dhe 5, neni 170, paragrafët 1 dhe 6 dhe nenit 81, të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, me anë të kësaj, dënohet me **katër (4) vjet burgim** dhe me një **gjobë prej njëmijë (1.000) Eurosh**.

S.S. për kryerjen e veprës penale të Pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal në lidhje me kontrabandimin e migrantëve, si një anëtar i një grupi, në vazhdim, në shkelje të nenit 283, paragrafët 1 dhe 5, neni 170, paragrafët 1 dhe 6 dhe nenit 81, të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, me anë të kësaj dënohet me **tre (3) vjet burgim** dhe me një **gjobë prej pesëqind (500) Eurosh**.

VIII. Në bazë të nenit 115 të KPP-së, e lexuar në lidhshmëri me nenin 112, paragrafi 1 i KPP-së, gjësendet si në vijim **konfiskohen përgjithmonë** si gjësende të cilat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale:

- Sekuestruar përkohësisht nga i akuzuari **S.Q.**: një (1) telefon celular Nokia, një (1) telefon celular iPhone 5 së bashku me SIM kartelën e bashkangjitur;
- Sekuestruar përkohësisht nga i akuzuari **L.M.**: katër (4) telefona celular Nokia dhe një (1) telefon celular Vodafone, me tre (3) kartela SIM të bashkangjitura dhe një (1) kartelë SD;
- Sekuestruar përkohësisht nga i akuzuari **S.S.:** një (1) telefon celular Sony Ericsson, dy (2) telefona celular Samsung, së bashku me kartelën SIM të bashkangjitur në to;
- Sekuestruar përkohësisht nga i akuzuari **F.K.**: dy (2) telefona celular Nokia, një (1) telefon celular Samsung, një (1) telefon celular AEG, katër (4) SIM kartela, dhjetë (10) karta telefoni dhe katër (4) libra kartelash.

IX. Në bazë të nenit 83 (1) të KPK-së, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, do të përfshihet në dënimet me burg.

X. Në bazë të neneve 365 (1.6), 450 (2) dhe 453 (1) të KPP-së të pandehurit janë të detyruar të paguajnë **shpenzimet e procedurës penale** në shumën totale prej tetëqind (800) Eurosh, të ndarë në shumën të barabarta prej dyqind (200) Eurosh për t'u paguar nga secili nga të pandehurit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas shpalljes së aktgjykimit final.

ARSYETIMI

A. SFONDI PROCEDURAL

1. Me datë 8 maj Prokurori Special I Republikës së Kosovës (Prokurori) ka lëshuar një Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve për **S.Q.1** për veprën penale të Kontrabandimit me Migrantë dhe Pjesëmarrjen në, apo Organizimin e një Grupi të Organizuar Kriminal. Me 03 shtator 2013 Prokurori ka lëshuar një vendim mbi Zgjerimin e Hetimeve ndaj të pandehurve **L.M., S.S., F.K., S.Q.** dhe M.F...
2. Më 9 dhjetor 2013, në bazë të kërkesës nga ana e prokurorit, Gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar arrestin e të pandehurve **S.Q.1, L.M., S.S., F.K.** dhe **S.Q...**
3. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata e ka shqiptuar masën e paraburgimit kundër **S.Q.1, L.M., S.S., F.K. dhe S.Q.** gjër me 9 janar 2014. Disa vazhdime të paraburgimit janë lëshuar. Me

- 3 qershor 2015 Gjykata vendosi që paraburgimi ndaj S.Q.1 të shtyhet derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se skadimi i afatit të dënimit të shqiptuar në aktgjykimin. Sa i përket të pandehurit **S.Q.**, Kryetari I trupit gjykues ka urdhëruar arrestin shtëpiak me 3 tetor 2014. Me 8 tetor 2014 Kryetari I trupit gjykues ka caktuar masën e arrestit shtëpiak kundër të pandehurve **L.M., S.S., dhe F.K.** Arresti shtëpiak ndaj të pandehurve **L.M., S.S., F.K. dhe S.Q** që ndërprerë me datë 7 prill 2015 dhe qe urdhëruar masa e sigurisë e paraqitjes në stacionin policor. Gjykata ka urdhëruar disa vazhdimë të masës së paraqitjes në një stacion policor, më e fundit me një zgjatje deri më 8 tetor 2015.
4. Më 18 shtator 2014 prokurori paraqiti aktakuzën e datës 15 shtator 2014 kundër S.Q.1, **S.Q., F.K., L.M., S.S.** dhe M.F. e cila I ka akuzuar të pandehurit siç është përcaktuar në dispozitiv.
 5. Më 3 tetor 2014, u mbajt një seancë fillestare. Gjatë kësaj seance rasti ishte ndarë ndaj të pandehurit **S.S.** në pajtim me nenet 35 dhe 36 të KPP-së, pasi i pandehuri ka pësuar disa probleme shëndetësore gjatë seancës. Më pas, Gjykata vendosi një afat për avokatët mbrojtës për të paraqitur kërkesat e tyre në bazë të neneve 249 dhe 250 të KPP-së deri më 24 tetor 2014.
 6. Më 14 tetor 2014, u mbajt një seancë fillestare në lidhje me të pandehurin **S.S.** Gjykata e njoftoi Avokatin mbrojtës se kërkesat në përputhje me nenet 249 dhe 250 të KPP-së, mund të paraqiten deri me datë 24 tetor 2014.
 7. Më 23 tetor 2014, Avokati mbrojtës i të pandehurit Sahit Sadriu ka paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe më 24 tetor 2014, Avokatët mbrojtës për të pandehurit S.Q.1. and **S.Q.** kanë parashtruar kërkesa për hedhjen e aktakuzës. Avokati mbrojtës për të pandehurin **S.Q.** gjithashtu ka kërkuar përjashtimin e provave të caktuara si të papranueshme.
 8. Më 21 nëntor 2014, gjykata lëshoi një vendim që adreson kërkesat e avokatit mbrojtës dhe ka vendosur të hedhi poshtë pikat 9 dhe 10 të aktakuzës. Në të njëjtën kohë, Gjykata vendosi të bashkojë të gjithë të pandehurit në një procedurë. Më 22 janar 2015, duke vendosur mbi ankesat e Prokurorit, Gjykata e Apelit lëshoi një vendim dhe I rivendosi akuzat 9 dhe 10 të aktakuzës.
 9. Më 2 prill 2015, Gjykata vendosi të veçojë rastin kundër të pandehurit M.F. pasi ky i fundit nuk u paraqit në gjykatë, pasi është ftuar sipas rregullit. Është lëshuar një urdhër arresti. Meqë F.M është në arrati, procedurat kundër tij janë ndarë.
 10. Më 8 maj 2015, Gjykata pranoi një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë të negociuar nga i pandehuri S.Q.1. dhe prokuroria. Më 21 maj 2015, pas mbajtjes së një seance në përputhje me nenin 233 (14) të KPP-së, gjykata pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe e ndërpreu procedurën kundër të pandehurit S.Q.1.

11. Shqyrtimi gjyqësor në lidhje me katër të pandehurit e mbetur **S.Q., F.K., L.M.** dhe **S.S.** u mbajt me 2,3,4, 9 dhe 10 qershor 2015, 7, 21, 22 dhe 23 korrik 2015, 16 dhe 17 shtator 2015 dhe 13 tetor 2015 me dispozitiv të aktgjykimit të shpallur më 15 tetor 2015.

B. KOMPETENCAT E GJYKATËS

12. Veprat Penale bien në kuadër të juridiksionit territorial dhe material të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe në kompetencë të një Kolegjit të përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtar Kosovar.

13. Në bazë të nenit 11 (1) të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03 / L-199, Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha rastet, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe. Në Nenin 9 (2.1) të të njëjtit ligj thuhet se Gjykata Themelore e Prishtinës me seli kryesore në Prishtinë është themeluar, ndër të tjera, në territorin e Komunës së Prishtinës.

14. Përveç kësaj, në bazë të nenit 15 (1.5) dhe (1.18) të Ligjit për Gjykatat, veprat penale të "Kontrabandimit me Migrantë", dhe "Krimet të Organizuar" bien brenda juridiksionit të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, i gjithë rasti është gjykuar nga Departamenti i Krimeve të Rënda.

15. Në përputhje me nenin 15 (2) të Ligjit për Gjykatat dhe në zbatim të Ligjit Nr 03 / L-053 mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, së bashku me Ligjin nr. 04 / L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Misionit të Ligjit në Republikën e Kosovës, në lidhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, gjyqtarët e EULEX-it kanë juridiksion dhe kompetencë për një rast që është në vazhdim e sipër nëse rasti u ishte caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.¹ Bazuar në nenin 3 (2) të Ligjit nr. 04 / L-273 më 22 janar 2015 një kërkesë i është dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës duke kërkuar për panelin në këtë rast të jetë i përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it, duke përfshirë një gjyqtar kryesues të EULEX-it. Asnjë përgjigje nuk është marrë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve dhe kërkesa konsiderohet të jetë e aprovuar.

16. Rasti që dëgjuar nga një trup gjykues i përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it, Seel, si Kryetare e trupit gjykues, Gjyqtari I EULEX-it Witteman dhe gjyqtarja Naime Krasniqi, si anëtarë të trupit gjykues.² Asnjë nga palët nuk e kanë kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues.

¹ Shih nenin 1A (1.2) në lidhshmëri me nenin 3(1) të Ligjit nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

² Gjatë katër seancave të para në këtë rast, të datës 1, 2, 21 dhe 23 prill 2015 gjyqtari Mikula ishte një prej anëtarëve të panelit. Ai u zëvendësua më vonë nga gjykatësi Eitteman. Sipas nenit 324 KPP –së, shqyrtimi kryesor filloi më 2 qershor 2015, kur Paneli i ri u prezantua dhe Aktakuza u lexua. Shih procesverbalin e datës 2 qershor 2015 faqe 2.

C. PROVAT

I. Provat e prezantuara përgjatë mbajtjes së Shqyrtimit Kryesor

17. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitarët si në vijim kanë dhënë deklaratat (sipas renditjes së paraqitjes së tyre në gjykim):

1. G.I. me 4 qershor 2015.
2. L.Z. me 4 qershor 2015.
3. H.M. me 4 qershor 2015.
4. H.R me 4 qershor 2015.
5. Sh.I me 9 qershor 2015.
6. D.B. me 10 qershor 2015.
7. A.S.me 7 korrik 2015.
8. M.U. me 21 korrik 2015.
9. Q.S.me 22 korrik 2015.

18. Gjatë gjykimit u vendos që dosja e rastit do të konsiderohet si e administruar, pasi palëve u është dhënë mundësia për të ngritur kundërshtimet.³ Shkresat e lëndës përbëhen nga 30 lidhëse përpiluara nga Prokurori duke përmbytur në veçanti:

10. Përgjimet Ligjore siq janë përgjimi I telefonave
11. Raportet e policisë, duke përfshirë edhe raportet në lidhje me operacionet e vëzhgimit.
12. Provat e marra nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar.
13. Dëshmitë e mbledhura vetëm nga policia.

19. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor janë bazuar në sugjerimet e Prokurorisë. Mbrojtja në mënyrë eksplicite nuk ka kërkuar për të dëgjuar ndonjë dëshmitar shtesë apo për të administruar prova shtesë.

I. Vlerësimi i Provave

20. Trupi gjykues ka shqyrtuar me kujdes pranueshmërinë e provave, por edhe ka vlerësuar se deri në çfarë mase provat e pranueshme mund të përdoren për ti bazuar faktet mbi to. Gjykata në veçanti vlerësoi çështjet e ngritura nga Mbrojtja në mocionet e saja, duke përfshirë edhe në fjalimet përfundimtare. Në lidhje me çështje të tjera , është vlerësuar

³ Procesverbali nga seanca e shqyrtimit kryesor me 22 korrik 2015, faqet 3 dhe 14.

sipas detyrës zyrtare, nëse dhe në çfarë mase provat në dispozicion të tilla si raportet e policisë, protokollet e përgjimet e telekomunikimeve, provat që merren, përmes ILA's, dhe dëshmitë e mbledhura ekskluzivisht nga policia ishin prova të pranueshme.

21. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor më 21 korrik 2015, palët u pajtuan që të i kenë provat e paraqitura në lidhëse nga ana e Prokurorit, të konsiderohen si lexuara pasi të gjitha palët i kishin marë dëshmitë që nga data nga shtatori 2014⁴. Paneli konstatoi se pasi që ishte administrua në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ka kundërshtime që u ngritën⁵ I gjithë materiali nga dosja e rastit, kishte prova të pranueshme. Megjithatë, Paneli konkludoi se për shkak të rregulloreve në Kodin e Procedurës Penale disa materiale nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë. Paneli nuk i përdori këto prova për të l vërtetuar faktet.

II. Vendimi mbi propozimin e palëve

Deklaratat e dëshmitarëve të zyrtarëve policorë

22. Gjatë seancës së 4 qershorit 2015 Avokatët mbrojtës D.O. dhe H.Zh., të mbështetur nga Avokati mbrojtës Hasim Loshi, kanë ngritur kundërshtime ndaj dëgjimit të G.I. si dëshmitar pasi që G.I. është një zyrtar policor. Prokurori I ka kundërshtuar këto kundërshtime. Sipas prokurorit fakti se G.I. është një zyrtar nuk e ndalon atë që të jetë një dëshmitar. Gjykata i hodhi poshtë kundërshtimet e ngritura nga ana e avokatit mbrojtës pasi ajo gjeti se kjo nuk është e ndaluar nga KPP-ja për të dëgjuar një zyrtar policor si dëshmitar. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se dëshmitari duhet të dëshmojë në lidhje me veprimet e tij.
23. Gjykata konstatoi se i njëjti ishte i zbatueshëm për deklaratat e zyrtarëve të tjerë të policisë që janë ekzaminuar gjatë shqyrtimit kryesor.⁶

Pranueshmëria e protokolleve të përgjimeve

24. Gjatë seancës së 21 korrikut 2015, avokati mbrojtës H.Zh paraqiti një mocion duke deklaruar se raporti dhe transkripti i përpiluar nga ekipi i hetuesve është i papranueshëm pasi (i) asnjëri prej tyre nuk ishte nënshkruar nga njerëzit të cilët I kanë hartuar ato, dhe (ii) biseda të caktuara janë dëgjuar nga një ekip, në vend se nga një person i caktuar. Prokurori kundërshtoi mocionin, duke argumentuar se (i) mocioni ishte I vonuar në bazë të nenit 97 (3) të KPP-së pasi që sfidimi I provave nga I pandehuri, duhet të paraqitet para shqyrtimit të dytë, dhe (ii) mocioni ishte i pabazuar pasi nenit 93 I KPP-së nuk kërkon që zyrtarët policorë ti nënshkruajnë procesverbalet dhe nuk ka asnjë

⁴ Procesverbal nga seanca e shqyrtimit kryesor me datë 21 korrik 2015, faqe 19.

⁵ Është vënë në dukje se kundërshtimet janë ngritur kundër pranueshmërisë së protokolleve të përgjimit të telekomunikimeve. Paneli I ka refuzuar këto kundërshtime, ashtu siq janë diskutuar në detaje si më poshtë.

⁶ Është vënë në dukje se në këtë pikëpamje avokati mbrojtës Zh e ka paraqitur një kundërshtim ndaj dëgjimit të dëshmitarit I., por I është referuar arsytimit të tij të mëhershëm, shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor nga data 22 korrik 2015, fq. 19 dhe 20.

dispozitë që e ndalon që masat të zbatohet nga një ekip.⁷

25. Gjatë seancës së 21 korrikut 2015 avokati mbrojtës D.O. paraqiti një mocion për shpalljen e raporteve të përgjimeve të papranueshme pasi ato do të përfshijnë supozimet e bëra nga hetuesit⁸. I pandehuri L.M. ka pohuar se raportet e përgjimit ishin të falsifikuara. Prokurori e kundërshtoi mocionin duke argumentuar se (i) Mocioni ishte i vonuar bazuar në Nenin 97 (3) të KPP-së, (ii) referenca është bërë nga avokati mbrojtës në bisedat familjare, ndërsa nuk ka biseda familjare që janë përmendur në përgjime përveç atyre që kanë të bëjnë me kontrabandimin e migrantëve, (iii) duke u bazuar në nenin 93 të KPP-së, transkriptet nuk duhet të nënshkruhen nga zyrtarët policorë, (iv) punonjësi i policisë që e zbaton masën fshehtë nuk duhet të specifikohet në urdhrin e gjykatës, dhe (v) ardhja në konkludime është thelbi i punës së hetuesve⁹, dhe ardhja në përfundimin se protokollet e përgjimeve duhet të konsiderohen si prova të pranueshme pasi që ato ishin (i) bazuar sipas urdhrave të ligjshme të gjykatës, dhe (ii) të zbatuara sipas dispozitave ligjore.
26. Gjykata u shpreh se të dyja, mocioni i H.Zh. dhe D.O. nuk janë të vonuara për shkak se, edhe pse çështjet e pranueshmërisë së provave janë diskutuar zakonisht gjatë fazës fillestare, në këtë rast është marrë informacion shtesë në lidhje me përgjimet dhe raportet vetëm gjatë shqyrtimit të dëshmitarëve në seancën kryesore.¹⁰
27. Prandaj, në lidhje me të dy mocionet nga avokati mbrojtës H.Zh dhe D.O., Gjykata i refuzon mocionet pasi që konstaton se protokollet e përgjimit janë të pranueshme. Përgjimet janë bazuar sipas urdhrave të ligjshëm të gjykatës¹¹ dhe janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Për më tepër, në bazë të nenit 93 (4) të KPP-së, nënshkrimi nuk është i nevojshëm, hetuesit mund të punojnë në ekipe dhe disa hetues mund të punojnë me udhëzim të mbikëqyrësit. Përveç kësaj, gjykata vëren se përfundimet e hetuesve nuk janë detyruese për gjykatën, por janë konsideruar "analizë" për hetime të mëtejshme dhe, kështu, nuk të çojnë në papranueshmërinë e përgjimeve dhe raporteve.
28. Së fundi, Paneli konstaton se pretendimi i të pandehurit L.M. se përgjimet ishin të falsifikuara nuk është e arsyetuar dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për vlerësim nga gjykata.

Pranueshmëria e përgjigjes ndaj kërkesës së ILA's (ndihma juridike ndërkombëtare)

29. Më 23 korrik 2015, prokurori i kërkoi Gjykatës të pranojë materiale të reja, si dëshmi e cila është dhënë si përgjigje ndaj kërkesës së NJN-së (ILA), e datës 3 shtator 2014

⁷ Procesverbalin nga shqyrtimi kryesor I datës 22 korrik 2015, faqe 5.

⁸ Shih procesverbalin e datës 22 korrik 2015, faqet 5 dhe 6

⁹ Shih procesverbalin e datës 22 korrik 2015, faqe 7

¹⁰ Përveç kësaj, gjykata vuri në dukje se kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja do të diskutohen si pjesë e vendimit përfundimtar.

¹¹ Shih lidhëset 4 dhe 5 që përmbajnë Urdhrat në fjalë nga Gjykata Themelore në Prishtinë

parashtruar nga prokurori.¹² Kjo kërkesë u kundërshtua nga avokati mbrojtës i cili pohoi se ajo është paraqitur shumë vonë¹³.

30. Gjykata gjatë seancës vendosi që materiali i ri ishte i papranueshëm dhe nuk do të jetë pjesë e dosjes së lëndës pasi: (i) kjo do të kërkonte përkthimin e 1500 faqeve nga hungarishtja në gjuhën angleze dhe shqipe që do të marrë të paktën disa muaj, (ii) në këtë mënyrë kjo do të ndikojë në parimin për të përfunduar procedurat brenda një kohe të arsyeshme, dhe (iii) dokumenti i pranuar nuk ka prova të reja ose një fakt të ri në përputhje me nenin 329 (4) të KPP-së, pasi të dyja palët ishin në dijeni të kërkesës së datës 3 shtator 2014 dhe asnjë nga palët nuk ka kërkuar që të presin materialin.¹⁴

III. Vlerësimi i provave Ex-officio

Deklaratat e kryesve hungarezë të veprës

31. Asnjë kundërshtim nuk është bërë kundër pranimit të deklaratave të bashkë-kryesve Hungarezë të cilat janë të paraqitura nga Prokuroria¹⁵. Megjithatë, Paneli konstaton se këto deklarata nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë. Gjykata vëren se këto deklarata janë bërë nga zyrtarët e policisë hungareze, dhe se individët janë ekzaminuar në cilësinë e të pandehurve. Vihet re se për këtë konstelacion nuk ka rregulla në KPP që e rregullojnë deri në çfarë mase këto deklarata mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor kundër të pandehurve të tjerë.
32. Prandaj, Paneli merr parasysh arsyet e ligjit procedural të Kosovës i cili ndalon përdorimin e drejtpërdrejtë të deklaratave, si dëshmi, në qoftë se deklarata nuk mund të sfidohet nga Mbrojtja gjatë marrjes në pyetje. Në këtë aspekt, Paneli miratoi një analogji të nenit 123 të KPP-së dhe vendosi se deklaratat e bashkë-autorëve Hungarezë nuk do të mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë; prandaj faktet në këtë rast nuk mund të bazohen në këto deklarata.

Deklaratat e dëshmitarëve

33. Paneli konstaton se në bazë të nenit 123 të KPP-së, deklaratat e dëshmitarëve të cilët nuk janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk duhet të përdoren si provë e drejtpërdrejtë. Por në rast të mospërputhjes midis deklaratave të bëra nga dëshmitarët gjatë shqyrtimit kryesor dhe gjatë intervistave nga faza paraprake, trupi gjykues e ka diskrecionin që ti bazojë gjetjet e tija në deklaratat e mëparshme, nëse ajo mund të jetë e arsyeshme të pohohet se ato ishin më të besueshme.

Informacion nga autoritetet hungareze

¹² Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 23 korrik 2015, fq. 2.

¹³ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 23 korrik 2015, fq. 3-4.

¹⁴ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 23 korrik 2015, fq. 6.

¹⁵ Shih protokollit e deklaratave të dëshmitarëve, lidhëset 28 dhe 29.

34. Një pjesë e dosjes së lëndës është informacioni i marrë nga autoritetet hungareze. Ky informacion përbëhet nga letrat e informacionit të dërguara nëpërmjet Europol-it dhe raportet e autoriteteve hungareze. Ky informacion nuk është sfiduar si dëshmi. Megjithatë, Gjykata vëren se këto letra të informacionit nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 219 (2) të KPP-së. Megjithatë, duke marrë parasysh nenin 219 (6) të KPP-së, këto dokumente mund të konsiderohen si dëshmi joformale, dhe pasi ato janë dërguar me një letër zyrtare ato janë konstatuar të jenë të pranueshme. Fakti që këto letra të informacionit janë paraqitur në aktakuzë si prova, pa mbështetjen e pohimit sipas nenit 219 (6) të KPP-së, nuk shpie në papranueshmëri.

D. DEKLARATAT E TË PANDEHURVE

35. Gjatë disa fazave të pandehurit kanë dhënë deklarata mbi rastin e tyre; gjatë fazës së procedurës paraprake dhe përgjatë deklaratave të tyre hyrëse dhe përfundimtare.

36. Është për t'u theksuar, se tre nga katër të pandehurit u deklaruan fajtor për akuzën e kontrabandës së emigrantëve, por jo për akuzën e pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal. Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon një procedurë pas deklarimit të fajësisë në vetëm një pjesë të akuzës, dhe në rast se faktet themelore për të dyja veprat penale janë të përziera. Paneli ka vendosur për të ua dhënë të pandehurve mundësinë për të sqaruar rastin e tyre para procedurës eventuale, për t'u dhënë atyre mundësinë për të përfituar plotësisht nga zbutja eventuale e dënimit e cila është e paraparë në rast të pranimit të fajit¹⁶. Marrja Zyrtare në pyetje e të pandehurve është bërë pasi që është mbyllur procedura e provave.

37. Gjatë procedurave të pandehurit kanë deklaruar si në vijim:

I. S.Q.

38. Më 20 janar 2014, **S.Q** dha dëshminë e tij para gjyqit në të cilën nuk ka deklarata të rëndësishme që janë bërë në lidhje me rastin.¹⁷ Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor në seancën e dytë fillestare me datë 2 qershor 2015, i pandehuri **S.Q** u vetë deklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat.¹⁸ Gjatë deklaratës së tij përmbyllëse, **S.Q** edhe një herë ka deklaruar se ai ishte i pafajshëm në lidhje me veprat penale me të cilat ai është akuzuar.

II. F.K.

¹⁶ Pavarësisht nga procedura normale dhe dispozita e nenit 384 të KPP-së, Paneli vendosi që në këtë situatë të drejtat e të pandehurve do të respektohen më mirë në qoftë se ata do e kishin mundësinë që të deklarohen në çështjen e tyre dhe tu përgjigjen pyetjeve para dhe pas procedurës së provave.

¹⁷ Shih Lidhjen 8, marrja në pyetje e të pandehurve në fazën paraprake.

¹⁸ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 2 qershor 2015.

39. Më 21 Janar 2014 **F.K.** ka përmendur në dëshminë e tij para gjyqit se ai nuk e njohte **L.M.** dhe **S.Q.**.. Më tej, ai ka deklaruar se ai e njohte **S.S.** që nga shkolla fillore dhe S.Q.1 për 4-5 muaj. F.K. ka mohuar të ketë qenë në kontakt me S.Q.1. apo **S.S.** lidhur me kontrabandimin e migrantëve.¹⁹ Megjithatë, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 3 qershor 2015, F.K. u deklarua fajtor për akuzën 5, pika 5 dhe 7.²⁰ Ai deklaroi se ai i ka marrë me makinë katër persona nga Rahoveci në Mitrovicë. Këta persona kanë shkuar në kufi dhe janë kthyer. Përpos kësaj, Fatmir Kastrati ka pohuar se ai një herë e ka dërguar një person me një pasaportë Serbe në Mitrovicë.
40. Në fjalimin përfundimtar të F.K. avokati mbrojtës ka përmendur se nuk është Konfirmuar se F.K. po mirrte pjesë në një grup të organizuar kriminal meqë nuk ka pasur asnjë grup dhe nuk ka pasur përfitime materiale.²¹

III. **L.M.**

41. Më 23 janar 2014, gjatë dëshmisë së tij të procedurës paraprake **L.M.** ka deklaruar se ai e njohte S.Q.1., por se ai nuk e njohte S.S derisa ai u arrestua. Sa i përket kontrabandimit të migrantëve, **L.M.** ka deklaruar se ai një herë e mori një person në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë matanë urës. Për më tepër, ai përmendi se ai ishte përdorur nga S.Q.1.²² Gjatë deklaratave hyrëse, **L.M.** u deklarua i pafajshëm për akuzën 3, pjesëmarrje në një grup kriminal të organizuar dhe akuzën 10, dhënia e ndihmës një personi tjetër në Pastrimin e Parave. Megjithatë, sa i përket akuzës 6, kontrabandimit të migrantëve, **L.M.** u deklarua fajtor, duke deklaruar se ai ishte i përfshirë në katër deri në gjashtë raste.²³
42. Në deklaratën e tij përfundimtare, avokati mbrojtës i **L.M.** ka ngritur kundërshtime ndaj provave të marra përmes përgjimeve. Përveç kësaj, ai deklaroi se nuk ka prova se **L.M.** ishte pjesë e një grupi të organizuar kriminal.²⁴ **L.M.** ka deklaruar vetë se ai deri diku i ka ndihmuar disa anëtarë të largët të familjes që të shkojnë jashtë shtetit.

IV. **S.S.**

43. Më 24 janar, në dëshminë e tij të procedurës paraprake **S.S.** ka deklaruar se ai e njohte **F.K.**., por nuk e njohte **L.M.**²⁵ Përveç kësaj, ai deklaroi se ai e kishte kontaktuar S.Q.1 pasi dhëndri dhe kunata e tij kishin kërkuar për të shkuar jashtë vendit. Megjithatë, në fund

¹⁹ Shih Lidhjen 8, marrja në pyetje e të pandehurve në fazën paraprake.

²⁰ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor me datë 3 qershor 2015, fq.3.

²¹ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor me datë 13 tetor 2015, faqe 9 dhe 10.

²² Lidhja 8, Dëgjimi i të Pandehurve.

²³ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 2 qershor 2015, fq. 7 dhe 13.

²⁴ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 13 tetor 2015, faqe 7 dhe 8.

²⁵ Lidhja 8, Dëgjimi i të Pandehurve.

që të dy prej tyre nuk përfundojnë në Vjenë. Më tej, ai deklaroi se ai ishte marrë vesh me S.Q.1 për të bërë aranzhimet për tezen e tij dhe fëmijët e saj që të dërgohen në Vjenë nga një kamp refugjatësh në Hungari. Megjithatë, ai shtoi se ai nuk ishte në dijeni se kjo gjë ishte e ndaluar për të ndihmuar dikë nga familja kudo që ata dëshirojnë për të shkuar. Më 13 gusht 2014 Sahit Sadriu ka deklaruar se ai e ka takuar **L.M.** një herë.²⁶ Gjatë deklaratave hyrëse, **S.S.** është deklaruar i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës, përpos për pikën 7 pikën 5 dhe 7.²⁷ Ai ka deklaruar se sa i përket pikës 7 pikës 5 dhe 7, ai ka kontrabanduar katër persona prej të cilëve tre ishin anëtarë të familjes së një shoku të tij.²⁸

44. Në fjalimin përfundimtar të **S.S.**, avokati i tij mbrojtës ka deklaruar se **S.S.** vetëm i ka ndihmuar anëtarët e familjes që të dalin jashtë vendit.²⁹ Për më tepër, sipas avokatit të tij mbrojtës, **S.S.** është përfshirë gabimisht në një grup të organizuar kriminal të pretenduar. Në veçanti, u theksua se **S.S.** ishte në dijeni të faktit se S.Q.1i printe një grupi të organizuar kriminal.³⁰ Përpos kësaj, kundërshtime qenë ngritur sa u përket përgjimeve.

E. FAKTET E PËRCAKTUARA

I. Rrethanat personale të të pandehurve

45. Lidhur me rrethanat personale të të katër të pandehurve trupi gjykues ka përcaktuar faktet e mëposhtme, në bazë të informacioneve të dhëna nga vetë të pandehurit³¹ dhe informacioneve në dispozicion në dosjen e lëndës, në mënyrë të veçantë, informacionet e marra në lidhje me të dhënat penale të të pandehurve:

(1) S.Q.

46. I pandehuri **S.Q.** është xxx vjeç. Ai u rrit në me vëllezërit dhe motrat. xxx i tij xxx është ish i-bashkë-pandehuri S.Q.1,, i cili u dënua në qershor të vitit 2015 për drejtimin e një grupi të organizuar kriminal, pas hyrjes në një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Sipas deklaratës së tij, **S.Q.** vijoi një shkollë për dymbëdhjetë vjet dhe më pas se ai ishte i përfshirë në punë fizike "rreth shtëpisë", deri në pesë vjet më parë, kur ai filloi të punojë si një xxx. Aktualisht ai punon në një xxx dhe fiton rreth xxx euro në muaj. I pandehuri është xxx; ai jeton bashkë me prindërit e tij dhe bashkëshorten e tij në shtëpinë e babait

²⁶ Lidhja 8, Dëgjimi i të Pandehurve.

²⁷ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 2 qershor 2015, fq. 7, 8 dhe 13.

²⁸ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 2 qershor 2015, faqe 16.

²⁹ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 13 tetor 2015, faqe 10.

³⁰ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 13 tetor 2015, faqe 12.

³¹ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 17 shtator 2015.

të tij në Qubrel, ku ai edhe ka jetuar gjithë jetën e tij. Gruaja e tij nuk ka të ardhura; prindërit e tij marrin një pension prej rreth 190 Euro së bashku.

47. Nuk ka dënime të mëhershme të regjistruara për të pandehurin **S.Q...**

(2) L.M.

48. I pandehuri **L.M** është xxx vjeç. Ai vjen nga xxx, nga i njëjti fshat ku të bashkë-pandehurit **S.1** dhe **S.Q** janë rritur. Ai ndoqi shkollën për 12 vjet, pas së cilës ai ka punuar së bashku me vëllezërit e tij si një bujk. Gjatë luftës në vitin 1999 ai shkoi në xxx. Pas kthimit të tij ai punoi si xxx dhe xxx, derisa ai shkoi për të punuar jashtë vendit në xxx për herë të parë në vitin 2006. Sipas deklaratës së tij ai pastaj u kthye disa herë në Kosovë, dhe deri në vitin 2013 u kthye në xxx dhe xxx disa herë, me qëllim për të punuar atje në mënyrë të paligjshme.

49. I pandehuri është i xxx; ai është babai i xxx fëmijëve të moshës xxx dhe xxx vjet. Ish-gruaja e tij ishte duke punuar si një nëpunëse në një dyqan, dhe familja ka jetuar në shtëpinë e vëllait të të pandehurit në fshat. Në fillim të vitit 2015 i pandehuri qe divorcuar. Që atëherë fëmijët kanë qëndruar me ish-gruan e tij dhe familjen e saj në xxx, dhe ai ka kontakte të rregullta me ta. Ai kohët e fundit u zhvendos në xxx, sepse ai gjeti një punë xxx. Ai fiton xxx euro në muaj. I pandehuri ka deklaruar se ka konsumuar sasi të mëdha të alkoolit gjatë viteve 2012 dhe 2013, por se ai e ka ndërprerë pirjen e alkoolit pasi ai ishte liruar nga paraburgimi.

50. Nuk ka dënime të mëhershme të regjistruara për të pandehurin **M..**

(3) F.K.

51. I pandehuri **F.K.** është xxx. Ai vjen nga xxx në Kosovë, ku ai u rrit dhe ka jetuar gjithë jetën e tij. Ai ndoqi një shkollë për tetë vjet, dhe më pas ka punuar si punëtor xxx. Në këtë moment ai është i papunë. I pandehuri është i martuar dhe baba i xxx fëmijëve, të moshave xxx, xxx dhe xxx vjeç. Gruaja e tij nuk është duke punuar, por duke u kujdesur për fëmijët dhe familjen. I pandehuri jeton me familjen e tij në shtëpinë e tij në Ratkoc.

52. Nuk ka dënime të mëhershme të regjistruara për të pandehurin **F.K.**

(4) S.S.

53. I pandehuri **S.S** është xxx vjeç. Ai u lind dhe u rrit në Ratkoc në Kosovë. Ai ndoqi shkollën për tetë vjet dhe pas kësaj ka punuar si një xxx.. Në vitin 1996 ai shkoi në xxx., për të punuar në kompaninë e vëllait të tij të ndërtimit. Ai u kthye në Kosovë në vitin xxx.. Pesë nga gjashtë vëllezërit e të pandehurit ende jetojnë në xxx.. Toka familjare në Kosovë, u

nda në vitin 2005, i pandehuri zotëron tokë dhe një shtëpi, por ai jeton në shtëpinë e vëllait të tij e cila është në gjendje më të mirë.

54. I pandehuri është i martuar dhe baba i xxx. fëmijëve, xxx. dhe xxx. vjeç. Ai jeton në xxx. së bashku me familjen e vëllait të tij më të vogël dhe xxx. fëmijët e tij. Ai punon si një fermer, por merr mbështetje financiare nga vëllezërit e tij.

55. Nuk ka dënime të mëhershme të regjistruara për **S.S.**

II. Kontrabandimi me Migrantë

56. Paneli konstatoi se katër të pandehurit në konstelacione të ndryshme, por gjithmonë në bashkëkryerje me S.Q.1, kanë organizuar dhe ekzekutuar të paktën dymbëdhjetë operacione të veçanta ku personat u sollën në mënyrë të paligjshme nga Kosova në vendet e Bashkimit Evropian.³²

57. Të katër të pandehurit kanë punuar së bashku me S.Q.1 dhe bashkë-kryerësit e tjerë në Kosovë, Serbi, Hungari, Austri dhe vende të tjera për të organizuar migrimin e paligjshëm të individëve nga Kosova në vendet e Bashkimit Evropian. S..1 dhe **S.Q., M.** dhe K kanë filluar këtë bashkëpunim së fundi në nëntor të vitit 2012, ndërsa **S.** u bashkua me grupin më së voni në shkurt të vitit 2013. Grupi në Kosovë është udhëhequr nga S.Q.1, i cili gjithashtu organizoi kontaktin me shumë bashkë-kryerës në vende të tjera.

58. Disa anëtarë të grupit do të vepronin si rekrutues për të gjetur individë nga Kosova të cilët ishin të dëshpëruar për të shkuar në vendet e Evropës Perëndimore, dhe të cilët ishin të gatshëm të paguajnë shuma të mëdha parash për këtë udhëtim të paligjshëm. Ndër këta rekrutues ishte në veçanti **L.M...**

59. Një operacion do të zhvillohej si në vijim: në shumicën e rasteve individëve u thuhej që të të takohen në Mitrovicë në një kohë të caktuar dhe vend të caktuar. Nga aty ata sillleshin në kufirin serbo-hungarez me autobus, makinë ose taksì. Ata ishin të shoqëruar nga **K**, apo bashkë-kryerës tjerë nga Kosova ose Serbia. Më tej, bashkë-kryesit i sillnin migrantët në grupe në këmbë mbi kufirin e gjelbër në mes të Serbisë dhe Hungarisë. Në anën Hungareze të kufirit, individët merreshin nga bashkë-kryesit hungarez, të cilët i kanë dërguar ata në të shumtën e rasteve në Vjenë, e ndonjëherë edhe në destinacione tjera.

60. Gjersa migrantëve u është thënë që të sjellin ca para të gatshme për të paguar disa nga shpenzimet përgjatë udhëtimit, pjesa më e madhe e udhëtimit është paguar pasi që

³² Në aktakuzë këto operacione janë të shënuara veçmas për çdo të pandehur. Për të shmangur përsëritjet në këtë aktgjykim veprimet individuale janë të referuara si "operacionet e trafikimit prej A në T". Këto operacione përfshijnë akuzat e padisë si më poshtë: A: pika 4 (1), 5 (1), 6 (1); B pika 4 (2), 5 (2), 6 (2), 7 (1); E: pika 4 (3), 5 (3), 7 (2); F: 5 (4), 7 (3); G: pika 4 (4), 6 (3), 7 (4); H: 7 (5); I: pika 4 (5); J: pika 4 (6), 7 (6); K: pika 4 (7), 5 (5), 6 (4); N: pika 4 (8), 6 (5); O: pika 4 (9), 5 (6), 6 (6), 7 (7); P: 6 (7); Q: 6 (8); R: 6 (9), 7 (8); S: pika 4 (10), 5 (7), 6 (1), 7 (9); dhe T: pika 4 (11), 5 (8), 6 (11), 7 (10).

migrantët të kenë arritur në destinacion e tyre final. Për një udhëtim janë paguar diku mes 1,500 dhe 2,600 Euro, një shumë e cila jo vetëm që i tejkalonte shpenzimet e udhëtimit por në të shumtën e rasteve përputhej me disa të hyra mujore të migrantëve. Tarifa e udhëtimit paguhej nga anëtarët e familjes së migrantit të cilët kanë qëndruar në Kosovë, apo janë dërguar përmes transferit.

61. Paratë janë ndarë në mes të anëtarëve të grupit. Shoferët hungarezë janë paguar nëpërmjet Western Union ose shërbimeve të tjera. Këto transaksione janë bërë nga S.Q.1, shumë shpesh nga **S.Q.**, i cili në shumë raste ka përdorur llogarinë e gruas së tij. Edhe **F.K.** dhe **L.M.** kanë transferuar para në vende të tjera për të shpërndarë të hyrat prej operacioneve të kontrabandës.
62. Në veçanti, Paneli konstatoi se të pandehurit kanë organizuar dhe kanë ekzekutuar operacionet e mëposhtme të kontrabandës.

(1) Operacioni I kontrabandimit E

63. Mes datave 23 dhe 24 Janar 2013 të pandehurit **F.K. and S.Q.**, së bashku me **S.Q.1.** dhe bashkë-kryes të tjerë, kanë organizuar dhe ekzekutuar udhëtimin e 17 personave nga Kosova për në Vjenë me qëllimin që të përfitonin materialisht nga ky aktivitet. Grupi përbëhej nga B.M., B.B., M.A., U.H., A.A., D.S., J.I., B.M.1, Z.A., N.T., A.S., H.Z., N.M., M.B.M., B.T., A.B., dhed N.A.. Këta njerëz nuk i kanë plotësuar kërkesat e nevojshme për të udhëtuar në vendet e Bashkimit Evropian, dhe u kanë paguar tarifa të pandehurve që organizuan paligjshëm kalimin e kufirit.
64. Më 23 janar 2013, individët ishin sjellë nga Kosova në kufirin serbo-hungarez; të paktën pjesërisht të shoqëruar nga **F.K.** Pas kalimit të kufirit atyre u është thënë të presin në një shtëpi të rrënuar afër xxx në Hungari, derisa ata do të merren nga shoferët hungareze. Ata qenë arrestuar së bashku me vozitësit e supozuar E.P.S dhe R.R. nga Policia Hungareze me datë 24 janar 2013, dhe ishin sjellë në një kamp për azil-kërkues në xxx menjëherë pas kësaj. Nga aty ata janë marrë nga bashkë-kryesit e grupit dhe janë sjellë në Vjenë me makinë.
65. Vozitësit Hungarezë ishin paguar për shërbimet e tyre me 25 janar 2013 përmes një transferi parash, ndërmarrë nga **S.Q.** tek A.H.S., e cila në atë kohë kishte drejtuar shoferët në Hungari, deri sa ajo u arrestua më 29 janar 2013.

Provat

66. Udhëtimi i individëve është provuar nga të dhënat nga Sistemi i Menaxhimit të Kufirit³³, e cila tregon se të gjithë këta njerëz kanë udhëtuar me autobus nga Kosova për në Serbi

³³ Raporti i përbashkët i ekipit hetues me datë 7 qershor 2013, duke përfshirë Të dhënat e Sistemit të Menaxhimit të Kufirit, lidhja 9, pika 8.

dhe janë regjistruar në Merdare me datë 23 janar 2013 në ora 12:50:15. Përfshirja e **K** vërtetohet nga fakti se në bastisjen që është bërë në ambientet e tij, një biletë autobusi nga Prizreni në Beograd u gjet në emër të **F.K.** me datë 23 janar 2013.³⁴ Informacioni në lidhje me arrestimin e këtyre individëve së bashku me shoferët hungareze rrjedh nga letrat e informacionit nga autoritetet hungareze³⁵, dhe ato qenë më tej të mbështetura nga deklarata e dëshmitares A.S.në shqyrtimin kryesor.³⁶ S është një zyrtar i policisë hungareze dhe ai ishte një hetues kryesor në këtë rast. Ai dha një deklaratë shumë të detajuar dhe koherente për përvojat e tija gjatë këtyre hetimeve, të cilat Paneli I ka gjetur të jenë plotësisht të besueshme. Ai ka folur në lidhje me arrestimin e dy vozitësve Hungarez, R.R. dhe E.P.S., që ka shpënë në hetime dhe arrestime të mëtejme. Dëshmitari ka dhënë një përmbledhje për rrjedhën e hetimeve, strukturën e grupit në Hungari, si dhe lidhjet në Kosovë, kryesisht për S.Q.1.

67. Kjo dëshmi mbështetet më tej nga rezultatet e zbulimit të të dhënave financiare³⁷, të cilat tregojnë se **S.Q** ka transferuar shumën prej 317.50 eurosh tek A.H.S. me 25 janar 2013, dhe më tej 109 EUR tek një bashkëpunëtor në Suboticë, Serbi me datën 30 janar 2013. Këto pagesa dyshohet të përbëhen nga pagesat për transportuesit në Hungari dhe Serbi për rolin e tyre në kontrabandë. Pretendimi se të pandehurit kanë përfituar nga pjesëmarrja në këtë operacion është përkrahur nga blerja e një makine nga ana e K. për 1,500 euro me datë 6 shkurt 2013, dhe blerja e një makinë në emër të **H.Q.**, gruaja e **S.**, për 2,500 euro me datë 11 mars 2013 nga **S.Q.**, sepse që të dy të pandehurit nuk kanë pasur të ardhura të rregullta gjatë kësaj periudhe kohore.

(2) Operacioni I kontrabandimit F

68. Rreth datës 9 prill 2013 I pandehuri **F.K.** nën udhëzimin e S.Q.1. dhe së bashku me bashkë-kryesit e tjerë kanë organizuar dhe ekzekutuar udhëtimin e pesë qytetarëve të Kosovës nga Kosova në Vjenë, me qëllim për të përfituar nga ky aktivitet. Individët nuk i kanë plotësuar kushtet për të hyrë në vendet e Bashkimit Evropian ligjërisht, dhe kanë paguar grupin për organizimin e migrimit ilegal.

69. Grupi, duke përfshirë B.M. dhe V.J, kanë udhëtuar nga Kosova, përmes Serbisë, për në Hungari, ku ishin sjellë në po të njëjtën shtëpi të rrënuar në Bácsalmás të cilën grupi e kishte përdorur edhe në operacionet e mëparshme . Me datë 9 prill 2013 ata janë marrë nga ky lokacion nga vozitësi P.S. në një makinë me targa hungareze me numër xxx.

³⁴ Raporti i përbashkët i ekipit hetues me datë 24 janar 2014, faqe 64, pika A4-17; lidhja19, pika D.

³⁵ Raporti i Zyrës hungareze Kombëtare të Hetimit, Departamenti kundër Krimin Trans nacional, Njësia e imigrimit të paligjshëm , marrë nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve me EUROPOL më 8 korrik 2013, lidhja 10, pika 2, faqe 32.

³⁶ Procesverbali nga seanca e shqyrtimit kryesor e datës 7 korrik 2015, faqet 5 deri në 8.

³⁷ Raporti i Policisë së Kosovës në zbulimin e të dhënave financiare e datës 28 Mars 2014, faqe15; lidhja 20, pika 5.

Menjëherë pas kësaj, të pesë individët dhe shoferi u arrestuan nga autoritetet hungareze dhe e sollën në një kamp për azilkërkuesit.

Provat

70. Udhëtimi i individëve në Hungari është provuar nga informacionet e marra nga autoritetet hungareze, të cilët e kanë raportuar arrestimin e B.M. dhe V.J në Kunbaja në Hungari.³⁸ Ata janë gjetur së bashku me bashkë-kryesin Hungarez P.S. në makinën e tij me targa xxx.. Më tej është mbështetur nga deklarata e dëshmitarit Stummer në shqyrtimin kryesor³⁹, që ka dhënë një llogari të ngjarjeve për Hetimet dhe arrestimet e ndërmarra nga autoritetet Hungareze, në mënyrë të veçantë ai përmendi rrethanat e arrestimit të vozitësit P.S. më 9 Prill 2013.
71. Përfshirja e të pandehurit **K.** është provuar nga fakti se gjatë bastisjes që është kryer në objektet e tija, bileta autobusi nga Beogradi për në Suboticë, me datë 7 prill 2013, dhe mbropa nga Subotica për në Beograd, me datë 9 prill 2013, dhe nga Beogradi në Prishtinë me datë 9 prill 2013, janë gjetur.⁴⁰ Përfshirja e **K.** në këtë operacion është mbështetur më tej nga transaksionet financiare të zbuluara nga hetimet financiare⁴¹, që tregojnë se ai ka bërë një numër të depozitave në para të gatshme në llogarinë e tij personale në fund të marsit të vitit 2013 dhe në fillim të prillit 2013, duke përfshirë shumat prej 5,000 EUR me 13 mars 2013, 1,010 EUR me 23 mars 2013 dhe 700 EUR me 3 prill 2013. Pasi i pandehuri nuk kishte asnjë burim tjetër të të ardhurave gjatë kësaj periudhe, Paneli mendon se shumat e transferuara ishin të përfituara nga aktivitetet e kontrabandës. Me datë 10 prill 2013, një ditë pas operacionit, ai e ka deponuar shumën e 2,700 EUR në llogarinë e tij bankare. Është e mundshme që ai i kishte marrë këto para nga migrantët të cilët e kanë paguar atë pas një operacioni kontrabandues që ka përfunduar me sukses. Më tej, me datë 6 prill 2013 **K.** ka transferuara shumën prej 1,500 EUR tek A.F.U. në Hungari.

(3) Operacioni kontrabandues G

72. Mes datës 7 dhe 18 qershor 2013, i pandehuri **L.M.**, nën mbikëqyrjen e S.Q.1. dhe së bashku me të tjerë bashkë-kryes, kanë organizuar dhe ekzekutuar udhëtimin e disa Kosovarëve, duke përfshirë A.R., Sh.S., R.S., N.M., N.A. dhe F.K. nga Kosova në Austri,

³⁸ Raporti i përbashkët i hetimit që ka të bëjë me informacionin e marrë nga autoritetet Hungareze me datë 20 maj 2013, Lidhja 9, pika 3, faqe 41; Raporti i Zyrës Hungareze Kombëtare të Hetimit, Departamenti kundër Krimin Trans-Nacional, Njësia kundër imigrimit të paligjshëm, marrë përmes EUROPOL-it më 8 korrik 2013, Lidhja 10, pika 2, faqe 32.

³⁹ Procesverbal nga seanca e shqyrtimit kryesor me date 7 korrik 2015, faqet 6 deri në 9.

⁴⁰ Të dhënat nga sistemi I Menaxhimit të Kufijve, Lidhja 10, pika 2, faqe 17.

⁴¹ Raporti i policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare me datë 28 mars 2014; Lidhja 20, pika 5, faqe 15.

dhe prej aty, në Itali, Francë dhe Gjermani, me qëllim që të përfitojnë nga ky aktivitet. Individët nuk i kanë plotësuar kushtet për të hyrë në vendet e Bashkimit Evropian ligjërisht, dhe për këtë arsye kanë paguar grupin për organizimin e migrimit ilegal.

73. Rreth datës 7 qershor 2013 grupi e ka organizuar udhëtimin e një grupi qytetarësh nga Kosova, duke përfshirë N.M.,, përmes Serbisë për në Hungari. Më vonë, në qershor, të pandehurit e kanë organizuar udhëtimin e një grupi të migrantëve nga Kosova në Serbi, ku grupi kishte ngecur. Në mesin e individëve ka qenë N.A., që është nisur nga Kosova në Serbi me 13 qershor 2013, me qëllim që të shkojë në Itali ose Francë. Me 18 qershor 2013 **L.M.** e ka shoqëruar F.K. nga Kosova në Serbi, kështu që ai mund të mund të takohet atje me grupin e migrantëve.

Provat

74. Udhëtimi i individëve vërtetohet nga informacioni që është pranuar nga autoritetet hungareze nëpërmjet Europol-it.⁴² Është mbështetur më tej nga deklarata e dëshmitarit Stummer në shqyrtimin kryesor⁴³, që ka deklaruar në lidhje me arrestimin e vozitësit A.L. i cili po i voziste migrantët përmes Hungarisë, dhe ka dhënë sqarime në lidhje me organizimin e grupit në Hungari.
75. Kjo është vërtetuar më tej nga raporti i SMK, e cila tregon se N.M. ka kaluar kufirin e Kosovës me Serbinë më 7 qershor 2013 në ora 12:45:05, N.A. ka shkuar nga Kosova në Serbi me datë 13 qershor 2013 në ora 12:33:50, dhe F.K. ka kaluar nga Kosova në Serbi me 18 qershor 2013 në ora 21:06:29. Të tre personat janë identifikuar nga policia përmes përgjimit të komunikimeve, sepse para dhe gjatë udhëtimit të tyre nga Kosova në Hungari dhe më tej ata kishin komunikime të gjata telefonike me S.Q.1.⁴⁴ Në këto biseda dhe mesazhe me tekst ata diskutojnë në lidhje me logjistikën e udhëtimit, si dhe detajet e pagesave dhe çështjeve që dolën gjatë udhëtimit.
76. Edhe pse i pandehuri K. nuk ishte paditur që të ketë marrë pjesë në këtë operacion të kontrabandimit, Paneli vëren se dëshmitë tregojnë se Kastrati është angazhuar në aktivitetet e grupit. Ai jo vetëm që e ka depozituar shumën prej 1.200 eurosh në llogarinë e tij, në fillim të qershorit; ai gjithashtu ka transferuar shumën prej 1,000 euro tek një pranues gjerman me datë 11 qershor 2013. Hetimi financiar gjithashtu zbuloi se gjatë qershorit të vitit 2013, **S.Q.** ka pranuar disa transfere të parave nga Gjermania, për të cilën ai nuk ka ofruar një shpjegim kur u pyet për këtë gjë .

⁴²Raporti i Zyrës kombëtare Hungareze të Hetimit, Departamenti kundër krimit trans-nacional, njësia kundër migrimit ilegal, e pranuar përmes EUROPOL shkëmbimit të mesazheve me datë 29 nëntor 2013, Lidhja 7, pika 2.

⁴³ Procesverbal nga seanca e shqyrtimit kryesor me datë 7 korrik 2015, faqe 9.

⁴⁴ Raporti i Ekipit për Hetime të Përbashkëta 3 korrik 2013, Lidhja10, pika 2, faqet 5 deri në 7.

77. Të dhënat e SMK dëshmojnë që Miftari ishte i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt në këtë operacion, pasi që ai personalisht ka udhëzuar F.K. nga Kosova në Serbi më datën 18 qershor 2013, dhe u kthyer në Kosovë ditën tjetër.⁴⁵ Përgjimi tregon që më vonë **S.Q.1.** e ka thirrur telefonin e K. dhe ka biseduar me **M.** Pjesëmarrja e **M.** në këtë operacion ishte vërtetuar në hetimet financiare.⁴⁶ Sipas këtyre, më datën 18 qershor 2013 Miftari i ka transferuar 1,700 EURO Vivien golan në Hungari, bashkëshortes së vozitësit **I.B.** Më datën 8 korrik 2013 Miftari i ka transferuar një shumë prej 200 EURO N.Z..
78. Përgjimi i telefonit të S.Q.1's⁴⁷ tregon që më datën 19 qershor 2013 ai e udhëzoi A.H.S. dhe të tjerët rreth transportit të individëve nga Vienna për në Itali dhe Francë. Gjatë bisedave S.Q.1's dhe H.S. gjithashtu diskutuan taksat që duhej të paguheshin ndaj disa vozitësve. Veç kësaj, përgjimi tregon që Q. kishte biseda telefonike me migrantët gjatë udhëtimit të tyre, për shembull me A.S., të cilit ai i dha udhëzime çfarë shumë të paguaj vozitësin. Në bisedat tjera i pandehuri S.Q.1's diskutoi arrestimin e vozitësit të quajtur Milan së bashku me disa migrantë, dhe ata tentuan të zgjidhin problemin që u ngrit pas arrestimeve.⁴⁸

(4) Operacioni i kontrabandimit H

79. Ndërmjet datave 16 dhe 19 qershor 2013 i pandehuri Sahit Sadriu dhe bashkëkryerësit e tjerë sipas udhëzimit të S.Q.1. organizuan kontrabandimin e një grupi të migrantëve me shtetësi kosovare në vendet e Bashkimit Evropian. Grupi përbëhej prej of A.S., N.K., L.Th., L.Th.1., A.M., F.M., K.B., dhe A.N. Këta individë nuk i plotësuan kushtet për të hyrë në ato vende.
80. Me datën 16 qershor 2013 individët ishin sjellë jashtë Kosovës. A.S. dhe A.N. të dytë ishin marrë jashtë Kosovës në ora 23:49:44. Migrantët e tjerë gjithashtu ishin marrë rreth datës 16 qershor 2013. Nga kufiri hungarez për në Vienë, individët ishin vozitur nga M.L. dhe I.B.. Megjithatë, më datën 19 qershor 2013 tetë migrantët së bashku me vozitësit e tyre ishin arrestuar nga policia hungareze në tokën hungareze.

Prova

81. Udhëtimi i individëve, në veçanti i A.S dhe A.N. janë dëshmuar nga të dhënat nga sistemi i menagjimit të kufirit dhe të dhënat e përfshira në raportin e hetimit të përbashkët. Në

⁴⁵ Shih të dhënat e sistemit të menagjimit të kufirit, regjistratori 10, tab. 2, faqe 17.

⁴⁶ Raporti i Policisë së Kosovës në zbulimin e të dhënave financiare të datës 28 mars 2014, Regjistratori 20, tab 5, faqe 15.

⁴⁷ Shih analizat e përgjimeve të ligjshme të **S.Q.1.**, regjistratori 26, tab 2, faqet 6 deri në 66.

⁴⁸ Shih analizat e përgjimeve të ligjshme të **S.Q.1.**, Regjistratori 26, tab 2, faqet 44 deri në 64.

këto dokumente ishte deklaruar që individët A.S., së bashku me A.N.kanë dalë nga Kosova me autobus të Erhan Trans Company më datën 16 qershor 2013 në ora 23:49 në kalimin kufitar në Merdare.⁴⁹ Përmes informatave të pranuar nga autoritetet hungareze përmes EUROPOL-it është dëshmuar që të dytë, së bashku me të tjerët, janë arrestuar në Hungari më datën 19 qershor 2013.⁵⁰ Veç kësaj, deklarata e dëshmitarit nga dëshmitari Stummer në shqyrtim kryesor kanë vërtetuar faktin që dy vozitësit M.L. dhe I.B të cilët vozisnin individë, ishin kapur nga Policia Hungareze.⁵¹

82. Përfshirja e të pandehurit **S.S** është dëshmuar nga të dhënat nga Sistemi i Menaxhimit të Kufirit, nga i cili paraqitet që **S.S.** ka hyrë në Kosovë përmes kalimit kufitar të Merdarit më datën 18 qershor 2013.⁵² Veç kësaj, biseda telefonike ndërmjet A.S dhe S.Q.1. dhe biseda ndërmjet S.S. dhe S.Q.1 që **S.S** ishte i përfshirë në udhëtim. Më datën 19 qershor 2013 A.S. kishte disa biseda telefonike me S.Q.1. në lidhje me makinat "Opel" që do të merrnin atë.⁵³ Në këtë aspekt, **S.S.** dhe S.Q.1. komunikuan në lidhje me këta dy migrantë dhe rreth dy makinave "Opel" për të transportuar migrantët.⁵⁴ Më tej, **S.** i dha S.Q.1. numrin e telefonit të A.S...⁵⁵ Më 19 qershor 2013 gjatë bisedës telefonike ndërmjet S.Q.1. dhe **M.**, telefoni iu ishte bartur A.S. për të informuar atë për shumën e të hollave që ai duhej të paguante, ai konfirmoi tek S.Q.1. në telefon që ai mund t'i garantoj **S. [S.]** që nuk do të ketë problem.⁵⁶ Më pas, gjatë deklaratave hyrëse **S.S.** u shpall fajtor në pikat 7, 5 dhe 7 pasi që ai kishte kontrabanduar katër persona prej të cilëve tre anëtarë të familjes dhe një shok. Në lidhje me pikën 7, pikën 5 këta anëtarë të familjes janë L.Th. dhe L.Th.1.⁵⁷ L.Th. dhe L.Th.1 i përkasin grupit të migrantëve të kontrabanduar ndërmjet datave 16 dhe 19 qershor 2013.

(5) Operacioni i Kontrabandimit J

83. Ndërmjet 20 qershorit 2013 dhe 28 qershorit 2013 kontrabandimi i grupit të migrantëve me qytetarë Kosovar nga Kosova, përmes Suboticës, Serbi në Hungari ishte organizuar nga S.Q.1. në bashkëkryerje me **S.Q.**, dhe të tjerët. Individët të cilët ishin kontrabanduar

⁴⁹ Raporti i Njësitit të Përbashkët i datës 3.07.2013, Regjistratori 10, tab. 2, faqe 2 e të dhënave të Sistemit të Menaxhimit të Kufirit, regjistratori 10, tab. 2, faqe 23. Sipas sistemit të Menaxhimit të Kufirit, A.N. kishte hyrë në Kosovë më datën 16 qershor 2013, në ora 18:18:07.

⁵⁰ Raport i Zyrës Kombëtare të Hetimit Hungarez, Departamenti Ndërkombëtar i Krimeve, Njësi kundër Imigrimit Ilegal, pranoi përmes EUROPOL, porosinë shkëmbyese më datën 29 nëntor 2013, regjistratori 7, tab. 2.

⁵¹ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor më datën 7 korrik 2015, faqe 11.

⁵² Të dhënat e Sistemit të Menaxhimit të Kufirit në lidhje me **S.S.**, regjistratori 10, tab. 2.

⁵³ Raporti i Njësitit të Përbashkët të Hetimit i datës 3.07.2013, Regjistratori 10, tab. 2, faqe 2.

⁵⁴ Raporti i Njësitit të Hetimit të Përbashkët të datës 3.07.2013, regjistratori 10, tab. 2, faqe 3.

⁵⁵ Raporti i Njësitit të Hetimit të Përbashkët të datës 3.07.2013, regjistratori 10, tab. 2, faqe 3.

⁵⁶ Biseda telefonike ndërmjet Sami Qitakut dhe Agron Sinanit më 19 qershor 2013 në ora 20:09, regjistratori 26, përgjimi ligjor, tab. 2, nr. 40.

⁵⁷ Shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor më datën 2 qershor 2015, faqe 16.

duke përfshirë njëmbëdhjetë qytetarë kosovarë: S.D., D.J., V.G., S.H., M.R., P.H., L.H., E.H., L.H1., A.H. dhe A.D..

84. Për të aranzhuar udhëtimin, më datën 26 qershor 2013 S.Q.1. e vëri në listë A.L si 'voztës të dytë' së bashku me S.T për të vozitur 4 deri në 5 migrantë nga Hungaria për në Vjenë. A.L ishte paguar EUR 1,143 nga H.M.Q, bashkëshortja e S.Q... Më tej, gjatë udhëtimit migrantët janë transportuar nga Veriu i Mitrovicës për në Suboticë dhe në Hungari nga G.I. dhe M.P.. Pagesat prej EUR 700 për secilin iu ishin bërë atyre më datën 28 qershor 2013 nga Hajrie H.M.Q..
85. Më 28 qershor 2013 M. L. dhe I. B., të cilët do të siguronin transportin e migrantëve nga kufiri serbo hungarez për në Mosonmagyaróvár ishin arrestuar nga policia hungareze së bashku me njëmbëdhjetë migrantë pasi që ata hynë pa dokumente. Më 3 korrik 2013, I.H., një i afërm i pesë nga migrantët, pagoi EUR 3,000 S.Q., për të marrë migrantët nga kampi dhe të transferoj ata në Francë.

Prova

86. Fakti që njëmbëdhjetë individë udhëtuan nga Kosova në Hungari dhe ishin kapur më datën 28 qershor 2013 së bashku me dy vozitës M. L. dhe I. B është vërtetuar nga informata e ofruar në Raportin e Hetimit të Përbashkët të datës 3 dhjetor 2013 dhe në porosinë e EUROPOL të datës 29 nëntor 2013.⁵⁸ Veç kësaj, deklarata e dëshmitarit nga A.S.konfirmon që dy vozitësit M. L. dhe I. B ishin kapur nga policia Hungareze më datën 28 qershor 2013 në kufi të Hungarisë dhe të Austrisë.⁵⁹
87. Informata financiare nga transfertat e UFP tregojnë që H.Q, bashkëshortja e S.Q., ka transferuar EUR 1,143 'voztës të dytë' A.L. më datën 3 korrik 2013 dhe EUR 700 secilin nga vozitësit M.P. dhe I.G.më datën 28 qershor 2013⁶⁰ Të gjitha nga këto transaksione të hollave ishin kryer më apo rreth udhëtimit prej njëmbëdhjetë individëve. Edhe pse këto transaksione ishin kryer në emër të H.Q dhe jo të S.Q., përgjimet, sikurse përgjimi i datës 17.07.2013 në ora 14:44:04, tregojnë që transaksionet ishin kryer nga apo për S.Q. duke përdorur emrin e bashkëshortes së tij.⁶¹ Më pas, informata nga UFP për transferin e të hollave tregojnë që S.Q. ka marrë EUR 3,000 më datën 3 korrik 2013 nga I.H.⁶² Kjo shumë

⁵⁸ Raporti i Hetimit të Përbashkët i datës 3 dhjetor 2013, faqe 2 dhe mesazhi i EUROPOL i datës 29 nëntor 2013, regjistratori 7, Kërkesat për NJN dhe përgjigjet, tab. 2.

⁵⁹ Shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor më datën 7 korrik 2015, faqe 10 dhe 11.

⁶⁰ Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014, faqe 16, regjistratori 20, Raportet e Dosjeve Financiare të Policisë.

⁶¹ Raporti i Njësitit të Përbashkët të Hetimit i datës 19 korrik 2013, faqe 12 dhe 13, regjistratori 11.

⁶² Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014, faqe 6, regjistratori 20. Duhet të përmendët që pesë prej migrantëve të kapur P.H., L.H2., E.H., L.H., A.H. kanë H. si mbiemër ngjashëm me personin i cili transferoi fondet. Duhet të përmendët nga versioni origjinal në shqip nga informatat është e qartë që S.Q. ishte pranuesi i fondeve të dërguara nga I.H., shih faqen 28 dhe 29 të Raportit të Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014. Sidoqoftë, përkthimi në

e të hollave gjoja ishte transferuar tek **S.Q.** për të marrë migrantët e zënë nga kampi në Francë.

(6) Operacioni i Kontrabandimit K

88. Ndërmjet fundit të korrikut 2013 dhe 10 gushtit 2013 grupi i udhëhequr nga S.Q.1. organizoi dhe krye udhëtimin ilegal të grupit të qytetarëve të Kosovës, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tej. Operacioni ishte organizuar nga S.Q.1. së bashku me **S.Q.**, **L.M.** dhe të tjerët.
89. S.Q.1. i angazhoi dy vozitësit G.I. dhe M.P për të marrë migrantët nga veriu i Mitrovicës përmes Suboticës në Hungari. A.H.S. dhe A.J.O aranzhuan për të transportuar nga kufiri serbo hungarez në vendet e mëtejme. A.O. do të merrte migrantët nga Vjena, pasi që vozitësi A.L të kishte marrë ata nga kufiri serbo hungarez për të sjellë ata në Vjenë.
90. Eventualisht, tetë persona ishin rekrutuar prej të cilëve së paku katër kishin kaluar kufirin ilegalisht për në Hungari, duke përfshirë Remzi Ramadanin i cili kishte dalë nga Kosova përmes Portës 31 më datën 9/10 gusht 2013, në ora 00:52. Më datën 10 gusht 2013 migrantët kaluan në Hungari.

Prova

91. Udhëtimi i individëve është dëshmuar nga përgjimi telefonik ndërmjet S.Q.1. dhe A.H.S., si dhe ndërmjet S.Q.1. dhe disa migrantëve.⁶³ Fakti që R.R. i përkiste këtij grupi është dëshmuar nga deklarata e të pandehurit **M.**, i cili në besim deklaroi të ketë ndihmuar dhe organizuar udhëtimin e R., së bashku me të dhënat e sistemit të menaxhimit të Kufirit.
92. Është dëshmuar që **S.Q.** ishte përfshirë në Kontrabandim të këtyre individëve pasi që ai kujdesej për aranzhimet financiare. Më datën 16 korrik 2013 H.M.Q. përmes UFP transferoi EUR 851 tek A.O.J.⁶⁴ Veç kësaj, më datën 16 korrik 2013 H.M.Q. transferoi EUR 700 të dyve G.I. dhe M.P. përmes DMTH.⁶⁵ Përgjimi i datës 17 korrik 2013 në ora 14:44:04 tregon që këto transaksione ishin kryer nga apo për **S.Q.** duke përdorur emrin e bashkëshortes së tij.⁶⁶ Më pas, telekomunikimi i përgjuar i **S.Q.** më 16 deri në 28 korrik

anglisht i raportit në faqe 6 të raportit përmban një përkthim të gabuar të referencës në shqip kështu duke iu referuar fondeve si “të pranuar nga I.H.”.

⁶³ Shih Analizat e përgjimeve ligjore të **S.Q.**, Regjistratori 26, tab 3, faqe 109; tab 5, faqet 134 deri në 180.

⁶⁴ Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014, faqe 16/17, regjistratori 20, Raportet Financiare të Policisë së Kosovës.

⁶⁵ Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin financiar të informatave të datës 28 mars 2014, faqe 16/17, regjistratori 20, Raportet Financiare të dosjeve policore.

⁶⁶ Raporti i Njësitit të Përbashkët të Hetimit të datës 19 korrik 2013, faqe 13, regjistratori 11.

2013 tregon përfshirjen e tij në aktivitetet kontrabanduese. Në këto biseda ai ishte duke biseduar me **S** çështjet financiare dhe çështjet e tjera në lidhje me logjistikën e operacionit kontrabandues. Për shembull më datën 21 korrik 2013 **S**. i dërgoi një SMS numrit xxx: „R.i, unë jam **S**. Ju do të shkoni tek të afërtit e juaj brenda tre ditëve. Unë do të vij dhe do të ju lajmëroj rreth detajeve “. ⁶⁷

93. Pjesëmarrja e **L.M.** në kontrabandimin e këtij grupi të veçantë të migrantëve është dëshmuar pasi që ai pranoi fajësinë në pikën 6, në veçanti përmendjen e rastit të R.R. ⁶⁸ Veç kësaj, përgjimi i datës 17 korrik 2013 si bisedë telefonike ndërmjet S.Q.1. dhe **S.Q.** tregon përfshirjen e **L.M.** në Kontrabandim pasi që gjatë bisedës telefonike gjithashtu **L.M.** foli me S.Q.1. çështjen e të hollave, transportin e migrantëve. ⁶⁹ Llogaria e tij është vërtetuar nga të dhënat e sistemit të menaxhimit të kufirit duke treguar që **L.M.** ka kaluar kufirin nga Rudnica në Serbi më datën 14 korrik 2013.

(7) Operacioni i Kontrabandimit N

94. Ndërmjet 4 shtatorit 2013 dhe 18 shtatorit 2013 grupi i udhëhequr nga S.Q.1. ishte rekrutuar në mënyrë aktive të cilët ishin të interesuar të udhëtojnë në vendet e bashkimit evropian, dhe ata organizuan dhe kryen udhëtimin ilegal të grupit prej qytetarëve kosovar, duke përfshirë F.G. dhe A.S. nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe më tej. Ky operacion ishte organizuar nga S.Q.1., me **L.M.** dhe të tjerët si bashkëkryerës.

95. Më datën 4 shtator 2013, EUR 1,350 iu ishin transferuar nga **L.M.** tek MP për të transportuar migrantët nga veriu i Mitrovicës lartë për në Suboticë dhe më tej. Veç kësaj, **L.M.** ishte përfshirë në rekrutim të migrantëve. Atje do të ishin katër migrantë për t'u nisur më 11 shtator 2013, në fakt, këta migrantë ishin dërguar në Vjenë nga një vozitës i quajtur Sasha.

96. Më 12 shtator 2013 një transport tjetër prej katër migrantëve ishte planifikuar nga S.Q.1.. Këta migrantë u nisën nga Kosova më datën 16 shtator 2013.

Prova

97. Është dëshmuar nga përgjimi i komunikimit të pandehurve **Q. and M.** që grupi ka planifikuar transportin e tre migrantëve për në Gjermani. ⁷⁰ Veç kësaj migranti i katërt i rekrutuar nga **L.M.** dëshironte të shkonte në Gjermani. **L.M.** e rekrutoi migrantin për të

⁶⁷ Raporti i Njësitit të Përbashkët të Hetimit të datës 21 gusht 2013, faqe 13, regjistratori 11, tab. 3.

⁶⁸ Shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor më 2 qershor 2015, faqe 7 dhe 14.

⁶⁹ Raporti i Përbashkët të Hetimeve të datës 19 korrik 2013, faqe 13, regjistratori 11, tab. 3.

⁷⁰ Shih regjistratorin 27, përgjimi ligjor i **S.Q.**, tab. 7, faqet 37 deri në 121; Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor të **L.M.** të datës 2 tetor 2013.

shkuar në Vjenë dhe ai ishte në kontakt me anëtarin e familjes nga migranti nga Prekazi të cilin ai e informoi që pagesa do të ishte EUR 100 avans dhe EUR 1,200 për në destinacion.

98. Që udhëtimi i së paku disa prej individëve, sikurse F.C. dhe A.S., në fakt u bë kjo është dëshmuar nga përgjimet ligjore.⁷¹ Komunikimet e shumta të përgjimeve telefonike të datës 18 shtator 2013 ndërmjet S.Q.1. dhe ndër të tjerët F.C. dhe një vozitës i quajtur C. tregon që aranzhimet ishin bërë nga S.Q.1. për nisje dhe transportim të F.C. dhe dokumentit të tij të udhëtimit nga Vjena.⁷² Veç kësaj, përgjimet telefonike të datës 18 dhe 19 shtator 2013 dëshmojnë që çështjet e transportimit ishin diskutuar me A.S.⁷³
99. Përgjimet ndërmjet 9 shtatorit 2013 dhe 12 shtatorit 2013 dëshmojnë që **L.M.** i ka rekrutuar migrantët, kishin takime me bashkëkryerësit për të diskutuar transportin e migrantëve dhe marrjen me çështjet financiare. Më datën 10 shtator 2013 Luani foli me bashkëkryerësin përmes telefonit duke e informuar atë që një grua dhe një fëmijë ishin kthyer.⁷⁴ Ditën e njëjtë, S.Q.1. e përdor telefonin e **L.** për të diskutuar çështjet e transportimit dhe një bashkëkryerës tjetër **S.** e thirr **L.** për të informuar atë që migrantët do të takojnë atë.⁷⁵ Më 11 shtator 2013 Luani ka biseda të ndryshme telefonike dhe ndër të tjera **S.** për të diskutuar migrantët e mundshëm.⁷⁶ Babai i njërit nga migrantët e mundshëm është përmendur, **H.** ⁷⁷ **L.M.** ka biseda telefonike me këtë **H.R.** në ditën e njëjtë duke e informuar **H.R.** se ku të takoheshin.⁷⁸ Më pas, përgjimi nga data 11 shtator 2013 tregon që katër migrantë të mundshëm ishin diskutuar me një nga ata nga Prekazi.⁷⁹ Më 12 shtator 2013 në njërën nga thirrjet e tija telefonike **L.M.** është pyetur nga një emigrant “hej njeri, a keni numër të kontaktit të personave që na transportojnë neve në anën tjetër gjatë natës”. **L.** i përgjigjet që një natë më parë kishte pasur probleme dhe ai i referohet **A.**, bashkë kryerëses në Hungari.⁸⁰ Veç kësaj edhe çështja e të hollave është ngritur. Më vonë, S.Q.1. e informon **L.M.** që bashkë kryerësja **A.** me

⁷¹ Raporti i Hetimit të Përbashkët i datës 25 shtator 2013, regjistratori 12, tab 5; Regjistratori 27, përgjimi ligjor i **S.Q.**, tab 7, faqet 37 deri në 121.

⁷² Raporti i Hetimit të Përbashkët i datës 25 shtator 2013, regjistratori 12, tab 5, faqe 3.

⁷³ Raporti i Hetimit të Përbashkët i datës 25 shtator 2013, regjistratori 12, tab 5, faqe 5

⁷⁴ Raporti i hetimit të përbashkët mbi përgjimin ligjor i datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 10 shtator 2013 në ora 12:25, faqe 3, regjistratori 11, tab 21.

⁷⁵ Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor i datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 10 shtator 2013, në ora 2);23, faqe 3, regjistratori 11, tab 21.

⁷⁶ Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor i datës 2 tetor 2013, faqet 4 – 8, regjistratori 11, tab 21.

⁷⁷ Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor të datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 11 shtator 2013 në ora 18:06, faqe 4, regjistratori 11, tab 21.

⁷⁸ Raporti i hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor të datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 11 shtator 2013 në ora 18:12, faqe 7, regjistratori 11, tab 21.

⁷⁹ Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor të datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 11 shtator 2013 në ora 17:52, faqe 6, regjistratori 11, tab. 21.

⁸⁰ Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor të datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 12 shtator 2013 në ora 17:14, faqe 3, regjistratori 11, tab 21.

siguri është arrestuar.⁸¹ Përgjime të tjerra të shumta tregojnë që **L.M.** në mënyrë aktive rekrutonte migrantë dhe organizonte operacionet e kontrabandimit.⁸² Policia ka përgjuar në total prej 48 bisedave në lidhje me kontrabandimin e migrantëve nga telefoni i **L.M.'s** ndërmjet datës 9 shtator 2013 dhe 18 shtator 2013. Më 11 shtator 2013 në ora 17:56:56 S.Q.1. dhe **L.M.'s** gjithashtu diskutuan shumat që ata do të pranojnë nga kontrabandimin dhe profiti i mundshëm.⁸³

100. Në deklaratë të tij të datës 17 qershor 2014, H.R. deklaroi që i biri i tij, F.R. me ndihmën e **L.M.** në mënyrë ilegale ka shkuar në Itali “diku gjatë shtatorit”. H.R. kishte takuar L. për të diskutuar udhëtimin dhe shpenzimet prej EUR 2,400. H.R. e qoi të birin e tij tek **L.M.** në Skenderaj, ai i pagoi **L.M.** EUR 2,400 në këste.⁸⁴ Sidoqoftë, gjatë shqyrtimit kryesor H.R. deklaroi që ai nuk ishte **L.M.** të cilit ai i kishte dhënë të hollat, por një L. tjetër.⁸⁵ Më pas, H.R. deklaroi që atij nuk i kujtohej nëse ai kishte folur me **L.M.** në telefon. Edhe pse ka diskrepanca ndërmjet dëshmimeve të H.R., trupi gjykues bindet nga deklarata e tij e datës 17 qershor 2014 pasi që përmbajtja e kësaj deklarate ishte konfirmuar gjatë dëshimit të zyrtarit policor M.U. i cili e kishte bërë intervistën më 17 qershor 2014.⁸⁶ Më pas, trupi gjykues konstatoi që ishte e qartë që dëshmitari në shqyrtim kryesor nuk donte të akuzonte të pandehurit në mënyrë direkte.

101. Përfshirja e **L.M.** në operacionet e kontrabandimit është më tej e dëshmuar nga të dhënat financiare që tregojnë që përmes UFP **L.M.** dërgoi EUR 1,350 tek M.P më datën 4 shtator 2013.⁸⁷ M.P është njëri nga vozitësit që në mënyrë të rregullt ishte shfrytëzuar nga grupi për të kontrabanduar migrantët përmes Serbisë.

102. Përfshirja e **L.M.'s** në Kontrabandim të migrantëve për periudhën 19 shtator 2013 është dëshmuar me biseda të shumta telefonike ndërmjet atij dhe S.Q.1. që ishin përgjuar për transportim të migrantëve dhe në të cilën mundësi migrantët ishin diskutuar.⁸⁸ Gjithashtu çështjet financiare në lidhje me migrantët ishin diskutuar përmes telefonit.⁸⁹

(8) Operacioni i kontrabandimit O

⁸¹ Raporti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin ligjor të datës 2 tetor 2013, përgjimi i datës 12 shtator 2013 në ora 10:17, regjistratori 11, tab 21.

⁸² Shih për shembull përgjimin e datës 11 shtator 2013, në ora 13:09, 14:40:18, 17:14:50, 17:17:44, 17:23:03, 17:52:07

⁸³ Përgjimi ligjor për **L.M.**, përgjimi i datës 11 shtator 2013, në ora 17:56:56, regjistratori 21, faqe 83.

⁸⁴ Intervista e dëshmitarit H.R e datës 17 qershor 2014, regjistratori 29, tab 5.

⁸⁵ Shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor më 4 qershor 2015, faqe 34, 35.

⁸⁶ Shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor më 21 korrik 2015, faqe 12.

⁸⁷ Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014, faqe 8, regjistratori 20.

⁸⁸ Raporti i Hetimit të Përbashkët I datës 25 shtator 2013, regjistratori 12, tab 5, faqe 8 dhe 9.

⁸⁹ Raporti i Hetimit të Përbashkët i datës 25 shtator 2013, regjistratori 12, tab 5, faqe 12.

103. Ndërmjet 17 shtatorit 2013 dhe 26 shtatorit 2013 një grup në përbërje të S.Q.1, **L.M.**, **F.K.**, **S.S.** dhe të tjerëve organizuan dhe kryen udhëtimin ilegal prej një grupi të migrantëve, përfshirë qytetarë të Kosovës B., B.H., D.M., F.R., T.R., dhe R.K., nga Kosova në shtetet e Bashkimit Evropian.
104. Më 17 shtator 2013 S.Q.1 filloi të organizoj një operacion kontrabandues për transportim të një grupi të migrantëve nga Kosova për në Hungari më 22 shtator 2013. Veç kësaj, një migrant tjetër do të dërgohej në Budapest. Më 20 shtator 2013 një migrant tjetër B.H. arriti në Budapest sikurse që ishte aranzhuar nga S.Q.1
105. Më 20 shtator 2013 S.Q.1. e përfshiu **S.S.** në organizim të operacionit tjetër. **S.S.** i gjeti katër migrantë dhe aranzhoi për një vozitës nga Kosova për në Suboticë dhe për në Hungari. Ishin pajtuar që profitet do të ndaheshin ndërmjet S.Q.1. dhe **S.S.**. Së bashku me dy migrantë të tjerë grupi do të kontrabandohej nga ETC Mitrovica më 22 shtator 2013 dhe më tej. Një pjesë e grupit ishte dërguar nga **S.S.** nga Mitrovica, dhe një pjesë tjetër ishte marrë matanë urës nga **F.K.**. Grupi i **F.K.** nuk ishte lejuar të kaloj kufirin kur janë kontrolluar dokumentet e tyre. Ditën tjetër më 23 shtator 2013 ata bënë një përpjekje tjetër e cila ishte e suksesshme. Migrantët me destinacion në Vjenë arritën atje rreth datës 25 shtator 2013.
106. S.Q.1. të shumtën e aranzhonte për pjesën e udhëtimit që i përkiste kalimit kufitar nga Hungaria në Austri. Në momentin që migrantët arrinin destinacionin e tyre final shumat e fundit të hollave paguheshin nga të afërmit e tyre grupit.

Prova

107. Raporti i vëzhgimit i datës 27 shtator 2013 dëshmon që pranë S.Q.1, **F.K.**, dhe **L.M.** ishin të përfshirë në operacion të kontrabandimit që ndodhi më 22 shtator 2013 rreth orës 20:00 duke u nisur nga ETC Mitrovicë.⁹⁰ E fundit është vërtetuar nga hetuesi D.B. i cili dëshmoi në gjykatë që gjatë vëzhgimit në kohën që ai e ka parë **F.K.**, **L.M.**, dhe S.Q.1. në parkun e ETC-së së Mitrovicës. Të shumtën **L.M.** dhe S.Q.1. ndërmjetësonin me migrantë në parking.⁹¹
108. **F.K.** ishte përfshirë në operacion siç është dëshmuar nga informatat nga raporti i vëzhgimit si dhe përgjimet e datës 22 deri në 26 shtator 2013 që tregojnë që **F.K.** ishte (i) në kontakt me migrantët, për shembull kur ai flet me një grua për të takuar në Rahovec duke i treguar këtu: “shiko bëhu gati rreth orës gjashtë”,⁹² (ii) diskutimet me një bashkë kryerës tjetër që ka ndodhur në kufirin serb më 22 shtator 2013 në lidhje me një

⁹⁰ Raporti i vëzhgimit i datës 27 shtator 2013, regjistratori 17, tab 11.

⁹¹ Shih procesverbalin e seancës së datës 10 qershor 2015, faqe 7 dhe 8.

⁹² Përgjimi ligjor **F.K.**, përgjimi i datës 22 shtator 2013, në ora 13:04:49, faqe 1, regjistratori 23, tab 1.

migrantë që nuk kishte certifikatë të lindjes, ata vendosin që të takohen në ETC dhe **F.K.** e këshillon atë në lidhje me çështjen: “(...) është më mirë të merresh një të re [certifikatë ekstrakt], sepse ata munden të na kthejnë neve prapa përsëri”⁹³, (iii) duke e këshilluar **B.** në rrugën e tij për në Hungari dhe pas hyrjes në Zvicër **B** e informon **F.K.**: “Po ne arritëm, vëllai im do të ju jap juve të hollat nesër” pas të cilës **F.K.** kërkon: “si qëndron puna rreth të tjerëve, a kanë arritur ata akoma (...)”⁹⁴, (iv) duke iu ndihmuar ndërmjet **F.K.** dhe **S.Q.1.** rreth operacionit në mbrëmje më 22 shtator 2013 dhe fakti që një migrant është kthyer⁹⁵, (v) duke ndihmuar ndërmjet **F.K.** dhe **S.Q.1.** në të hollat që iu ishte kthyer nga vozitësi nga një natë më herët kur nuk mund të bëhej transporti, dhe ku të merren të hollat: **Rahovec**⁹⁶, (vi) diskutimi i të hollave në lidhje me çështjet me **S.Q.1.** në lidhje me udhëtimin që ishte bërë: **S**: “Saktë kishte 5200, 100 Euro nga banka Ëestern Union, 100 për udhëtim..(...)”, **Fatmir**: “Ju është dashur që të vini. Pse nuk erdhët por e dërguat vëllain e juaj [**S.Q.**]”⁹⁷.

109. Sa i përket përfitimit material të arritur, të dhënat financiare tregojnë që **F.K.** ka pranuar një deponim me para të gatshme prej EUR 300 më 25 shtator 2013.⁹⁸ Veç kësaj, i biri i tij **F.K.1.** pranoi një deponim me para të gatshme nga babai i tij në vlerë prej EUR 3,200 më 25 shtator 2013.⁹⁹ Sidoqoftë, pastër bazuar në informatat e dhëna në raport nuk mund të vërtetohet ndonjë lidhje direkte ndërmjet shumës dhe operacionit të kontrabandimit, përveç nga fakti që të dy transaksionet ishin kryer në fund të operacionit të kontrabandimit.
110. Përveç raportit të vëzhgimit të referuar më sipër, përgjimet e komunikimeve telefonike dëshmojnë përfshirjen e **L.M.** Përgjimet nga 18 dhe 19 shtator 2013 ndërmjet **L.M.** dhe **S.Q.1.** tregojnë që **L.M.** ishte në kontakt me migrantët për të rekrutuar ata.¹⁰⁰
111. Përgjimet e datës 20 shtator 2013 ndërmjet **S.S.** dhe **S.Q.1.** dëshmojnë që **S.S.** ishte i përfshirë në planifikim të operacionit të kontrabandimit, sikurse gjetja e migrantëve dhe pastaj kontaktimi i **S.Q.1.** për të aranzhuar transportin: ‘nuk ka gjasa për të vozitur sonte njerëzit’(...) ‘dhe të hënën në sa ora më duhet t’i sjell ata atje?’.¹⁰¹ Më 22 shtator 2013, në ora 12:31 **S.** e thërret **S.Q.1.**: “Sonte është mirë”. **S**: “Çdo gjë është në rregull?”.¹⁰² Më vonë **S.Q.1.** dhe **S.S.** thërrasin për të diskutuar shpenzimet e transportimit të

⁹³ Përgjimi ligjor **F.K.**, përgjimi i datës 22 shtator 2013, në ora 22:28:08, faqe 36, regjistratori 23, tab 1.

⁹⁴ Përgjimi ligjor **F.K.**, përgjimi 25 shtator 2013, në ora 01:52, faqe 121, 123, regjistratori 23, tab 1.

⁹⁵ Përgjimi ligjor **F.K.**, përgjimi i 22 shtatorit 2013, në ora 22:38:44, faqe 45-47, regjistr. 23, tab 1

⁹⁶ Përgjimi ligjor **F.K.**, përgjim 23 shtator 2013, ora 17:25, faqe 62, 63, regjistratori 23, tab 1 dhe përgjimi ligjor **F.K.**, përgjim 24 shtator 2013, në ora 12:05, faqe 84, 85, regjistratori 23, tab 1.

⁹⁷ Përgjimi ligjor **F.K.**, përgjim 26 shtator 2013, ora 11:39 faqe 156, regjistratori 23, tab 1

⁹⁸ Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014, faqe 13, regjistratori 20.

⁹⁹ Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e informatave financiare të datës 28 mars 2014, faqe 13, regjistratori 20.

¹⁰⁰ Raporti i Njësitit të Përbashkët të Hetimit të datës 9 tetor 2013, faqe 8 – 10, regjistratori 12, tab 5.

¹⁰¹ Njësitit të Hetimit të Përbashkët i datës 2 tetor 2013, faqe 2 dhe 3, regjistratori 11, tab 19

¹⁰² Njësitit të Hetimit të Përbashkët i datës 9 tetor 2013, faqe 2, regjistratori 12, tab 18

migrantëve, S: “Pak më lirë, e bën 1.3 për mua këtë herë.”¹⁰³ Në ora 22:49 në ditën e njëjtë S. dhe S.Q.1 flasin rreth migrantëve të cilët ishin refuzuar në kufi dhe diskutojnë se si të aranzhojnë një udhëtim tjetër për ata ditën tjetër.¹⁰⁴ Ditën tjetër S. e informon S1 që ai i ka rregulluar dokumentet për personin i cili ishte kthyer.¹⁰⁵ S.Q.1 e thërret S.S. dhe S. e informon atë që ata do të jenë atje në ora tetë e tridhjetë.¹⁰⁶ Më 24 shtator 2013 S. dhe F.K. e thirrin S.Q.1 dhe flasin rreth të hollave që dy nga ata i kanë borgj S.Q.1 në lidhje me migrantët.¹⁰⁷

112. Përfshirja e S.Q. në këtë operacion është dëshmuar nga përgjimi i telekomunikimeve. Përgjimi i numrit të telefonit 049549593 i përdorur nga Fatmir Kastrati tregon një numër të bisedave telefonike ndërmjet F.K. dhe S.Q. më 24, 25 dhe 26 shtator 2013. Nga këto biseda është e qartë që kontrabandimin i një grupi të njerëzve, duke përfshirë personin e quajtur B., për në Zvicër ishte diskutuar. Bisedat e përgjuara telefonike ndërmjet S.Q. dhe K. and S. pa dyshim tregojnë që më datën 25 shtator 2013 S.Q. takoi S.S. and F.K. në Klinikë, ku S. dhe K i dorëzuan të hollat S. që t’i jap ato S1.¹⁰⁸ Rrjedhimisht, në bisedën e datës 26 korrik 2013, në ora 11:39 F.K. e pyet pse S1. e ka dërguar vëllain e tij, dhe nuk ka ardhur vet.

113. Veç kësaj, i pandehuri në shqyrtim kryesor deklaroi që në këtë rast ai shkoi në Klinikë për të marrë të hollat për vëllain e tij. sa i përket S.Q. deklaroi se nuk e kishte ditur për çka ishin këto të holla, trupi gjykues merr parasysh kohën e gjatë që S.Q. ishte i përfshirë dhe numrin e madh të transaksioneve që ai kishte kryer, dhe e vlerëson deklaratën e tij si jo të besueshme.

(9) Operacioni i kontrabandimit Q

114. Ndërmjet 29 shtatorit 2013 dhe 2 tetorit 2013 i pandehuri L.M. nën udhëzimin e S.Q.1. së bashku me bashkëkryerësit e tjerë organizuan udhëtimin e katër personave: dy gra, një burrë dhe një fëmijë. Ky grup përfshinte qytetarë kosovarë.

115. Grupi udhëtoi nga Mitrovica për në Hungari përmes Suboticës. Sidoqoftë, në kufirin hungarez ndodhi një problem dhe migrantët u morën nga një vozitës tjetër i cili punonte për dikë tjetër. Megjithatë, çështja u zgjidh dhe përfundimisht grupi u transportua për në Vjenë.

¹⁰³ Njësiti i Hetimit të Përbashkët i datës 9 tetor 2013, faqe 2, regjistratori 12, tab 18

¹⁰⁴ Njësiti i Hetimit të Përbashkët i datës 9 tetor 2013, faqe 2, regjistratori 12, tab 18

¹⁰⁵ Njësiti i Hetimit të Përbashkët i datës 9 tetor 2013, faqe 3, regjistratori 12, tab 18

¹⁰⁶ Njësiti i Hetimit të Përbashkët i datës 25 shtator 2013, faqe 11 dhe 12, regjistratori 12, tab 5

¹⁰⁷ Njësiti i Hetimit të Përbashkët i datës 9 tetor 2013, faqe 3, regjistratori 12, tab 18.

¹⁰⁸ Njësiti i Hetimit të Përbashkët mbi përgjimin e numrit të telefonit 049549593, regjistratori 7, tab 16, faqet 100, 140, 154, 155.

Prova

116. Përfshirja e **L.M.** në udhëtim prej së paku V.M., njëri nga katër migrantët, është dëshmuar nga përgjimi i datës 3 tetor 2013 në të cilin ai pajtohet me H.M. për të u takuar tek shkolla e Drenasit afër pompës së benzinës për të kryer pagesën, pasi që V.M. kishte arritur në Vjenë.¹⁰⁹ Veç kësaj, **L.** e kontakton S.Q.1. për të informuar atë që ai do të shkoj në Drenas për të marrë të hollat në pompën e benzinës.¹¹⁰
117. Më tej është vërtetuar nga dëshmimi i procedurës paraprake të H.M.¹¹¹, i cili dha llogari faktin që në tetor 2013 **L.M.** i ndihmoi vëllait të tij V.M. për të udhëtuar në Austri pasi që ai nuk kishte dokumentet e duhura për të hyrë në Austri. V.M. e takoi **L.M.** në Mitrovicë. Nga atje V.M. udhëtoi më tej. Veç kësaj, H.M. pas arritjes së vëllait të tij në Vjenë pagoi **L.M.** pjesën mbetëse prej EUR 900 deri në 1,000 në Drenas, në pompë të benzinës Al Petrol¹¹² Ndërmjet dëshimit të procedurës paraprake të H.M dhe deklaratës së tij gjatë shqyrtimit kryesor ekzistojnë mospërputhjet.¹¹³ Sidoqoftë, Znj. Sh.I., zyrtare policore e cila kishte kryer intervistën e procedurës paraprake, konfirmoi gjatë shqyrtimit kryesor që H.M. kishte deklaruar që ai personalisht e kishte paguar **L.M.** për udhëtimin e të birit të tij¹¹⁴ Duhet të theksohet që Znj Sh.I. e bëri këtë deklaratë pas marrjes së kopjes së intervistës pasi që ajo nuk mund të kujtonte intervistën së pari.

(10) Operacioni i kontrabandimit R

118. Ndërmjet 3 tetorit 2013 dhe 14 tetorit 2013 i pandehuri **L.M.** nen direktivat e S.Q.1. se bashku më bashkëkryerësit të tjerë kane organizuar udhëtimin e grupit të migrianteve duke përfshirë shtetas të Kosovës A.S., Q.S., M.Th., L.U., F.M1., H.S., A.I., dhe A.I.1.
119. Më 3 tetor 2013 grupi prej 7 deri në 8 personat do të transportoheshin nga **L.M.** nga ETC në Mitrovicë në veri të Mitrovicës që të takohen më një shofer Serb i cili do ti transportonte ata në Hungari dhe më tej deri në Vjene. Më arritjen e migrantëve në destinacionin e tyre **L.M.** do të grumbullonte fondet nga familjet e migrianteve.
120. Operacioni tjetër i kontrabandimit është aranzhuar në mes S.Q.1. dhe **L.M.** **L.M.** ka siguruar që vozitësi Hungarez Z.N. është udhëzuar mire. Grupi i migrantëve, 4 të rritur dhe 2 fëmijë janë zënë duke kaluar ilegalisht në Hungari përmes një fushe.

¹⁰⁹ Përgjimet e datës 3 tetor 2013, në ora 21:30:59, 22:10:37 dhe 22:59:23, regjistr. 21, tab 2.

¹¹⁰ Përgjimi ligjor i datës 3 tetor 2013 në ora 21:30:59, 22:10:37 dhe 22:59:23, regjistr 21, tab 2.

¹¹¹ Procesverbal I dëgjimit të dëshmitarit H.M e dates 17 qershor 2014, regjistr. 29, tab 7

¹¹² Procesverbal I dëgjimit të dëshmitarit H.M e dates 17 qershor 2014, regjistr. 29, tab 7.

¹¹³ Shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor më 4 qershor 2015, faqe 26. Për shembull gjatë seancës së shqyrtimit kryesor H.M deklaroi që **L.M.** nuk ishte në Mitrovicë në atë kohë kur vëllai i tij ishte atje dhe që ai kurrë nuk i ka paguar të hollat **L.M.** por një personi tjetër.

¹¹⁴ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 9 qershor 2015, faqe 13.

121. Më 8 tetor 2013 migrantët M.Th., L.U., F.M1., H.S., A.I., dhe A.I.1 janë arrestuar se bashku më shoferin Hungarez Z.N... Përveç kësaj më 9 tetor 2013 L.U.dhe F.M1përsëri janë arrestuar nga policia hungareze.
122. M etej një operacion tjetër i Kontrabandimit është organizuar gjate periudhës se njëjtë kohore. Migrantët do të udhëhiqeshin nga K.F., një shqiptar më banim në Gjermani nga veriu i Mitrovicës në Subotice të Serbisë.

Provë

123. Udhëtimi i migrantëve është provuar nga deklarata e A.S.. S. ka dëshmuar se më 8 tetor 2013 njësitë policor Hungarez i ka arrestuar migrantët dhe Z.N.. S. ka dëshmuar se Z.N. ka punuar se bashku më S.Q.1. që të transportoj migrantët. Përveç kësaj ai deklaroi se më 9 tetor 2013 dy migrantët se bashku më R.S. janë arrestuar nga Policia Hungareze, këta dy migrantët janë arrestuar më 8 tetor 2013 gjithashtu.
124. Përfshirja e **L.M.** në operacion të datës 3 tetor 2013 është provuar nga përgjimet telefonike që tregojnë që Miftari ka pasur disa biseda telefonike më migrantët se ku duhet të takoheshin. ETC në Mitrovicë¹¹⁵. Në vazhdim përgjimet telefonike të datës 3 tetor 20:36 tregojnë se Miftari është njoftuar nga S.Q.1. mbi faktin se njeri prej migrantëve ka heq dore, ashtu duke e bere grupin në total prej 7 personave¹¹⁶. Më 3 tetor 2013 **L.M.** ishte në kontakt më L.Z lidhur më atë se ku duhet të takoheshin. L.Z është njeri prej migrantëve i cili ka udhëtuar më 3 tetor 2013¹¹⁷. Në vazhdim përgjimet të 3 tetorit 2013 dëshmojnë se **L.M.** ishte përfshirë në Kontrabandim të A.S., të cilin e udhëzoi që të takohej më të¹¹⁸. E njëjta aplikohet edhe për migrantin të quajtur Q.S. më të cilin **L.M.** ishte në kontakt më 3 tetor 2013 që ti tregoj atij se ku do të takohen¹¹⁹.
125. Kjo e fundit është vërtetuar nga dëshmia në procedurën paraprake të L.Z. më 18 qershor 2014 ku ai ka deklaruar se ai ishte në kontakt më S.Q.1 dhe se iu është thënë të shkoje në ETC Mitrovica, ku ai e ka kontaktuar një person rreth 40 vjeçar më mjekër¹²⁰. Nga ETC ai është transportuar afër urrës ku ata i shkëmbyen makinat pasi që ata kaluan kufirin Serbi – Hungari, pranë tij ishin rreth 8 personat të tjerë. Në deklaratën e tij L. nuk

¹¹⁵ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 21 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 3 tetor 2013, faqe 2-4 dhe 6, regjistrator 13, tab 4

¹¹⁶ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 21 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 3 tetor 2013 në ora 20:36 minuta, faqe 4, regjistrator 13, tab 4

¹¹⁷ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 25 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 3 tetor 2013 në ora 21:11 minuta, faqe 10, regjistrator 13, tab 7

¹¹⁸ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 25 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 3 tetor 2013 në ora 20:23 minuta, faqe 13, regjistrator 14, tab 7

¹¹⁹ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 25 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 3 tetor 2013 në ora 20:33 minuta, faqe 13, regjistrator 14, tab 7

¹²⁰ Procesverbali i seancës se dëshmitarit Labinot Zaneli, regjistratori 29. Tab 8;

e ka cekur emrin e **L.M.**... Sidoqoftë, numri i tij i telefonit përputhet më numrin e telefonit që e ka thirre **L.M.** më 3 tetor 2013 në ora 21:11 minuta. Edhe pse ka mospërputhje në mes dëshmisë se L.Z. pranë gjykatës më 4 qershor 2015 dhe dëshmisë se tij paraprake, gjykata do të qëndroj pranë dëshmisë se tij të datës 17 qershor 2014 pasi që përmbajta e kësaj deklarate është konfirmuar gjate dëshmisë se oficerit policor D.B. i cili ka kryer intervistën më 18 qershor 2014¹²¹.

126. Dëshmia e procedurës paraprake e Q.S. vërteton se provat nga përgjimet telefonike sikurse që S. deklaroi se ai ka diskutuar më **L.M.** rreth mundësive të dërgimit të djalit të tij jashtë vendit¹²². Është vendosur që **L.M.** do të beje aranzhimet dhe **S.** është njoftuar se do të nisen në ora 21:00 nga ETC Mitrovica. Ekzistojnë disa mospërputhje në mes dëshmisë se procedurës paraprake të Q.S. dhe dëshmisë se tij të deponuar pranë gjykatës më 22korrik 2015, sidoqoftë, gjykata do të qëndroj pranë deklaratës se tij të datës 18 qershor 2014, pasi që përmbajta e kësaj deklarate është konfirmuar gjate dëshmisë se oficerit policor D.B. i cili ka kryer intervistën më 18 qershor 2014¹²³. Më tej paneli gjeti se dëshmitari faktikisht ngurronte që drejtpërsëdrejti të akuzoj të pandehurit gjate seancës se shqyrtimit kryesor, pasi që ai nuk mund ti jepte sqarime për mospërputhje në deklaratat e tija.

127. Në dëshminë e tij të procedurës paraprake të datës 18 qershor 2014 A.S. deklaroi se ai dhe disa migrantët të tjerë janë larguar nga ETC Mitrovica dhe hyrën në një makine Pasat ngjyre hiri¹²⁴. Kjo vërtetohet më përgjimet e datës 3 tetor 2013 në mes **L.M.** dhe A.S..

128. Përfshirja e **L.M.** në Kontrabandim të katër të rriturve dhe dy fëmijëve është dëshmuar më përgjimet të datës 4 tetor 2013 ku **L.M.** dhe S.Q.1 diskutuan rreth këtyre migrantëve dhe S.Q.1 thotë “ (...) një grua po vjen më dy fëmijë në Krap, një tjetër po vjen...”¹²⁵. Përveç kësaj më 5 tetor 2013 Samiu e njofton Luanin: (...) ata i kthyen pas pasi që fëmijët nuk janë të qete”¹²⁶.

129. Në vazhdim një SMS nga **L.M.** për M tregon se **M.** është përfshirë në aranzhimin e shoferit të Hungarisë Z.N. që të transportoj migrantet në Vjenë: “N.Z. Wien 1.500 të merre”¹²⁷. Përveç kësaj përgjimet të datës 4 tetor 2013 dëshmojnë se **L.M.** ka bere aranzhimet që të transportoj 4 të rriturit dhe 2 fëmijë. Në pyetjen e shoferit potencial se

¹²¹ Shiko procesverbalin e seancës se 4 qershorit 2015, faqe 10.

¹²² Procesverbali i seancës se dëshmitarit Qazim Spahiu, regjistratori 29, tab 10.

¹²³ Procesverbali i seancës se 10 qershorit 2015, faqe 10

¹²⁴ Procesverbali i seancës se dëshmitarit Arben Salih, regjistratori 29, tab 9

¹²⁵ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 21 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 4 tetor 2013 në ora 20:13 minuta, faqe 4, regjistratori 13, tab 4

¹²⁶ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 21 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 5 tetor 2013 në ora 07:40 minuta, faqe 4, regjistratori 13, tab 4

¹²⁷ Raporti ekipor i hetimeve te përbashkëta të datës 21 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 4 tetor 2013 në ora 12:14 minuta, faqe 7, regjistratori XIII, tab 4

perse **L.** nuk ka punuar më 'D': **L.** " nuk mundem sepse janë 4 të rriturit dhe se ata do të më japin vetëm 400 euro", pas kësaj është përgjigjur; " nëse do të shkojnë më makine do të kenë probleme sepse atyre i nevojiten ulëset të veçanta për fëmijë¹²⁸. Pas këtij përgjimi shume thirrjet telefonike kane vijuar ku **L.M.** ka aranzhuar për transportin e migrantëve.

(11) Operacioni i Kontrabandimit S

130. Në mes 7 dhe 25 nëntorit 2013 të pandehurit **L.M., S.Q., F.K. dhe S.S** sipas direktivave të **S.Q.1.** se bashku me bashkëkryerësit të tjerë kane organizuar udhëtimin e disa personave, duke përfshirë grupin e 3 deri në 4 shtetas të Kosovës, përfshirë **Sh.H., E.H. dhe Sh.O.** nga Kosova për në Vjene.
131. Aranzhimet për grupin janë bere para 7 nëntorit 2013. Më 7 nëntor 2013 grupi ka udhëtuar nga Mitrovica për në Hungari përmes Subotices. Në zonën afër kufirit grupi është vonuar dhe është dashur që të vazhdoj në këmbë përmes zonës malore të Hungarisë më 11 nëntor 2013, përfundimisht duke shkuar në Gjermani.
132. Pas 11 nëntorit 2013 operacioni i Kontrabandimit është organizuar nga **S.Q.1, F.K., S.S. dhe L.M.** Më 18 nëntor 2013 migrantët të përzier u nisen nga Mitrovica për në kufirin e Serbisë- Hungarisë. Megjithatë, rrugës migrantët u ndalen.
133. Në vazhdim më 20 nëntor 2013 një grup i migrantëve është transportuar nga Kosova në Hungari nga shoferi serb, 'C'. Në kufirin Hungarez ai është takuar më **N.N., 'N.** që të transportoj disa nga migrantet. **V.G.K.** 'V do ti transportonte tre migrant ilegal, **Sh.H., E.H. dhe Sh.O** për në Vjene. Megjithatë, më 24 nëntor 2013 ata u ndalen nga policia hungareze, kështu që migrantët nuk ishin të suksesshëm në kalimin e kufirit.

Provat

134. Fakti që "V." dhe 'N janë ndaluar nga policia hungareze mbështetet me deklaratën e dëshmitarit **A.S.** me 7 korrik 2015 në të cilën deklaratë ka thënë "(...) i fundit (incidenti) ka qenë në nëntor (...) kur dy zonja hungareze sapo ishin kontrolluar në afërsi të kufirit serbo-hungarez kur ishin në lidhje të ngushtë me **S.Q.1.**"¹²⁹
135. Raporti i vëzhgimit i datës 18 nëntor 2013 i përpiluar nga polici 836 tregon se **S.Q.1, F.K. dhe S.S** ka qenë të përfshirë në kontrabandimin e së paku 4 migrantëve që janë

¹²⁸ Raporti ekipor i hetimeve të përbashkëta të datës 21 tetor 2013, përgjimet ligjore të datës 4 tetor 2013 në ora 18:38 minuta, faqe 4, regjistrator XIII, tab 4

¹²⁹Shiko procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor me 7 korrik 2015, faqe 14.

nisur nga Mitrovica në mbrëmje me 18 nëntor 2013.¹³⁰Raporti tregon se S.Q.1 ka dërguar një migrant në ETC në Mitrovicë ku janë takuar me **F.K.** and **S.S...** **F.K.** i ka dërguar së pak 4 migrantë në veri të Mitrovicës me pasat ngjyrë të gjelbër. Pastaj që të tre janë takuar në pompën e derivateve Al Petrol për të biseduar dhe janë larguar më pas. Këto data përputhem me veprimet që janë zhvilluar me 18 nëntor 2013.

136. **S.Q.** ishte i përfshirë në pjesën financiare të veprimeve kontrabanduese. Kjo vërtetohet nga të dhënat financiare që tregojnë se me 18 dhe 29 nëntor 2013 përmes DMTH-së **S.Q.** ka pranuar 500 € nga A.C. në Gjermani.¹³¹ Pasi që A.C.ka transportuar migrantë në Gjermani ka të ngjarë që paratë e transferuara kanë ardhur nga migrantët të cilit i ka transportuar A.C.për S.Q.1. dhe të tjerët. Përgjimet e datës 18 tetor 2013 tregojnë se **S.Q.** ka qenë në kontakt me A.C. për transferimin e parave, A. e thërret **S.** dhe i thotë: “ T’i kam dërguar 500 € në emrin tuaj **S.Q.** në Money Gram”.¹³² Pastaj, përgjimi i datës 11 nëntor 2013 ndërmjet **S.Q.** dhe nënës së tij tregon se ai ka qenë në dijeni për aktivitetet kontrabanduese që po zhvilloheshin.¹³³

137. Përveç të dhënave në raportin e vëzhgimit të datës 18 nëntor 2013, përgjimi ligjor i datës 11 nëntor 2013 në ora 15:56:25 i telekomunikimeve të zhvilluara ndërmjet S.Q.1. dhe F.K. dhe më vonë mes S.Q.1. dhe **S.S.** vërteton se Sahit Sadriu ka qenë i përfshirë në organizimin e operacionin kontrabanduese që është zhvilluar me 18 nëntor 2013 siç shpjegohet nga raporti i vëzhgimit.¹³⁴

138. Përveç raportit të vëzhgimit të datës 18 nëntor 2013 që vërteton përfshirjen e F.K. në veprimin kontrabandues në atë datë, nga përgjimi i datës 7,8, 9 dhe 10 nëntor 2013, në të cili ka shumë komunikime telefonike që F.K. ka pasur kryesisht me **S.Q.**, vërtetohet qartë përfshirja e F.K. në veprimet kontrabanduese që janë zhvilluar ndërmjet 7 dhe 11 nëntor 2013. Në një përgjimi të datës 7 nëntor 2013 F.K. e pyet **S.Q.**, hapur se sa to të ishte ‘fitimi’ për të.¹³⁵ Përgjimet e datës 14, 17 dhe 18 nëntor 2013 tregojnë se F.K. ka qenë i angazhuar në caktimet për operacionin me 18 nëntor 2013.¹³⁶

139. Edhe përgjimet e datës 7, 8, 9 dhe 10 nëntor 2013 të cekura më sipër tregojnë përfshirjen e **L.M.** në operacionin kontrabandues që ka ndodhur mes datës 7 dhe 11 nëntor 2013.¹³⁷ Për shembull përgjimi i datës 10 nëntor 2013 në ora 22:44 në të cilin **L.M.** dhe F.K. kanë diskutuar problemet që kanë ndodhur kur disa migrantë kanë hyrë

¹³⁰Raporti i Vëzhgimit i Policisë së Kosovës i datës 18 nëntor 2013, Regjistratori 17, fashikulli 22.

¹³¹Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2013, faqe 6, Regjistratori 10, fashikulli 5.

¹³²Raporti i Ekipit të përbashkët hetues i datës 28 nëntor 2013, faqe 2, Regjistratori 14, fashikulli 9.

¹³³Raporti i Ekipit të përbashkët hetues i datës 28 nëntor 2013, faqe 2, Regjistratori 14, fashikulli 9.

¹³⁴Përgjimi ligjor i datës 11 nëntor 2013 në ora 15:56, faqe 351, Regjistratori 18, fashikulli 3.

¹³⁵Përgjimi ligjor i datës 7 nëntor 2013 në ora 19:00, Regjistratori 23, fashikull 3.

¹³⁶Përgjimi ligjor i datës 14, 17 dhe 18 nëntor 2013, regjistratori 23, fashikulli 3.

¹³⁷Raporti i hetimeve të përbashkëta i datës 26 nëntor 2013, Regjistratori 13, fashikull 8.

gabimisht në një veturë.¹³⁸ Por duket se nuk ka prova se **L.M.** ka qenë i përfshirë në këtë aktivitet që është zhvilluar rreth datës 24 nëntor 2014.

(12) Operacioni kontrabandues T

140. Mes fundit të nëntorit dhe 9 dhjetorit 2013 të pandehurit **K. M.** dhe **S.** në bashkëpunim me S.Q.1 dhe të tjerët kanë organizuar dhe i kanë dërguar në mënyrë të paligjshme disa persona nga Kosova në shtetet e Bashkimit Evropian. Në fund të nëntorit dhe fillimit të dhjetorit, të pandehurit K. dhe S janë angazhuar në gjetjen e personave të interesuar për ta paguar grupin në fjalë për organizimin e udhëtimit të paligjshëm për në Austri, Itali dhe shtete tjera të Bashkimit Evropian. Këta tre persona kanë gjetur të interesuar dhe kanë planifikuar udhëtimin e tyre i cili duhej të fillonte me 4 dhjetor 2013 nga Kosova nëpër Serbi dhe Hungari.

141. Me 4 dhjetor 2013, në mbrëmje, i pandehuri K. ka takuar në stacionin e autobusëve në Prishtinë një djalë rreth moshës 25 vjeç, ka marrë para nga ai dhe e ka shoqëruar me autobus deri në Serbi. Mes 6 dhe 8 dhjetor 2013 i pandehuri e ka organizuar udhëtimin e grupit nëpër Serbi ku ishin shoqëruar nga M. dhe K.. S.Q.1. e ka organizuar transportin nga Hungaria deri në Austri dhe Gjermani me A.C.

142. Mes 8 dhe 9 dhjetori 2013 të pandehurit kanë sjellë në Hungari një grup migrantësh nga Kosova nëpër Serbi, ku i kishte marrë një shofer hungarez sipas udhëzimeve të S.Q.1.. Ky grup kishte gjithsej tetë persona me shtetësi të Kosovës që ishin arrestuar pak më vonë nga policia hungareze kur kishin vazhduar udhëtimin e tyre nëpër Hungari.¹³⁹

Provat

143. Aktivitetet në rekrutimin e grupit nga fundi i nëntorit 2013 e tutje vërtetohen nga përgjimet e telekomunikimit të gjithë personave të pandehur.¹⁴⁰ Nga këto biseda shihet qartë se të pandehurit bashkë me S.Q.1. kanë rekrutuar disa persona, kanë organizuar udhëtimet e tyre duke filluar me 4 dhjetor 2013 dhe kanë caktuar çmimin për çdonjërin. Nga përgjimet merret vesh se M. dhe K. kanë shkuar në Seri për të ndihmuar udhëtimin, kanë hasur në disa probleme dhe janë grindur me njëri tjetrin.

144. Arrestimi i grupit prej 8 kosovarëve dhe i një shoferi hungarez vërtetohet nga deklarata e dëshmitarit S. në shqyrtimin gjyqësor¹⁴¹ dhe mbështetet nga informatat e siguruar nga organet e Hungarisë.

¹³⁸Përgjimi ligjor i datës 10 nëntor 2013 në ora 22:44, Regjistratori 23, fashikull 3.

¹³⁹Shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor me 7 korrik 2015, faqe 14.

¹⁴⁰Raporti i ekipit të përbashkët hetues i datës 13 dhjetor 2013, Regjistratori 14, fashikull 26.

¹⁴¹Shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor me 7 korrik 2015, faqe 14.

145. Përfshirja e të pandehurit S. vërtetohet nga përgjimi i komunikimit të shpeshtë që ky zhvillon me S.Q.1, **L.M.** and F.K.. nga numri xxx dhe xxx .¹⁴² P.sh, në një bisedë mes S. dhe S.Q.1, me 3 dhjetor 2013 në ora 18:03:47, **S.** thotë: “ Jam këtu po merrem me një, mendoj se ka ndërruar mendjen, dëshiron të dështoj, dhe unë do të mbes vetëm me një.”
146. Përfshirja e F.K. në një operacion me 4 dhjetor 2013 mbështet nga vëzhgimi i policisë po atë ditë.¹⁴³ K. është parë kur ka takuar një person në stacion e autobusëve në Prishtinë ku ka pranuar disa para dhe së bashku me personin kanë hyrë në një autobus për në Serbi. Caktimi i udhëtimit më pastaj vërtetohet nga përgjimet e numrit të telefonit të Kastratit xxx i cili tregon se gjatë kësaj periudhe K. ka qenë në kontakt ditë për ditë edhe me të pandehurit tjerë për organizimin e udhëtimit të migrantëve.¹⁴⁴
147. Përfshirja e **L.M.** vërtetohet nga përgjimi i telekomunikimeve.¹⁴⁵ Me 9 dhjetor 2013 në ora 11:29 **M.** ka pasur një bisedë me një person me emrin S. i cili ka përdorur numrin e Austrisë, me të cilin ka diskutuar për transportin e personave nga Subotica. Në këtë bisedë ata kanë diskutuar edhe për çmimin dhe **M.** thotë se ka në plan të shkoj në Suboticë të nesërmen .¹⁴⁶

III. Struktura e grupit

(1) Përmbledhje

148. Pas vlerësimit të provave të paraqitura trupi gjykues ka vërtetuar se të katër të pandehurit kanë qenë anëtarë të grupit që rregullisht ka ndihmuar migrimin ilegal të kosovarëve për në vendet e Bashkimit Evropian. Qëllimi i vetëm i grupit ishte përfitimi material me anë të këtyre aktiviteteve. Ky grup kishte në përbërje së paku 20 persona në Kosovë, Serbi, Hungari, Austri dhe Gjermani, dhe udhëhiqej nga S.Q.1. që drejtonte aktivitetet e grupit në Kosovë.
149. Trupi gjykues ka gjetur prova bindëse se të katër të pandehurit jo vetëm se kanë marrë pjesë në organizimin dhe ekzekutimin e operacioneve për kontrabandimin e personave si u cek më lartë por ata kanë qenë anëtarë të këtij grupi ndërkombëtar që ka qenë aktiv së paku për një vit. Këtë katër persona kanë pasur dijeni për aktivitetet e grupit, për ekzistencën e tij dhe rolin e anëtarëve tjerë në grup, për modus operandi-n e

¹⁴²Raporti i ekipit të përbashkët hetues i datës 11 dhjetor 2013, Regjistratori 14, fashikull 21.

¹⁴³Raporti i vëzhgimit i Policisë së Kosovës i datës 11 dhjetor, Regjistratori 17, fashikull 24.

¹⁴⁴Raporti i ekipit të përbashkët hetues i datës 11 dhjetor 2013, Regjistratori 14, fashikull 18.

¹⁴⁵Raporti i ekipit të përbashkët hetues i datës 13 dhjetor 2013, Regjistratori 14, fashikull 24.

¹⁴⁶Përgjimi i datës 9 dhjetor 2013, 20:56, Regjistratori 21, fashikull 5, faqe 419.

grupit dhe qëllimin për të përfituar. Të pandehurit kanë qenë në dijeni se i kanë ndarë mes vete të fitimit dhe kanë marrë pjesë në shpërndarjen e hiseve.

150. S.Q.1's vëllai i **S.Q.**, ka qenë më pak i përfshirë në kryerje e këtyre operacioneve në terren por ai kishte detyrë të kujdesej për transaksionet financiare brenda grupit ose ndërmjet migrantëve dhe grupit. Rolet e anëtarëve tjerë në Kosovë deri diku ishte fleksibile. Të tre personat në periudhën afro një vjeçare kanë qenë rregullisht të angazhuar me aktivitetet e grupit dhe të gatshëm për bashkëveprim me grupin në çdo kohë.
151. M., K. dhe S. aktivisht kanë rekrutuar personat të tjerë për t'i kontrabanduar. Në këto raste ata kanë marrë kompensim shtesë. Në disa raste ka pasur konflikte rreth këtyre kompensimeve. Të tre të pandehurit kanë marrë pjesë në organizimin edhe realizimin e udhëtimeve duke komunikuar me migrantët, duke u takuar me ta në Mitrovicë ose diku tjetër dhe duke i transportuar ata në Mitrovicën veriore ose më larg në Serbi deri në kufirin serbo-hungarez në Suboticë. Në shumë raste grupet kanë udhëtuar me autobus, nganjëherë edhe me veturë. Nëse lindnin probleme gjatë udhëtimit, të pandehurit zakonisht e njoftonin S.Q.1i cili pastaj organizonte rrugë alternative.
152. Për zbatimin e operacioneve grupi mbështetej në rrjetin e fortë të bashkëkryesve në Serbi dhe Hungari. Të shumtën e herëve bashkë-kryes të pa identifikuar kanë sjellë grupe të migrantëve përtej kufirit serbo-hungarez. Migrantëve u është thënë të presin nëpër vende afër kufirit derisa t'i marrin shoferët hungarezë.
153. Bashkë-kryesit hungarezë i koordinonte Z.V. dhe më vonë A.H.S., që ishin në kontakt të rregullt me S.Q.1. Ata ua caktonin datat dhe rrugët shoferëve që i transportonin migrantët me veturë në Austri ose shtete të Evropës. Në këtë grup bënin pjesë, mes tjerëve, këta shoferë: A.H., Z.V., R.R., E.P. S., M. L., I.B. dhe P.S... Shoferët hungarezë kanë marrë ndërmjet 150 dhe 200 euro për një person pas transportit me sukses. Këto para u dërgoheshin atyre nga Kosova nëpërmjet disa kompanive për transferte të parave pasi kryheshin operacionet. Të gjithë të pandehurit i kanë kryer transaksionet në Kosovë kurse parat u janë dërguar shoferëve drejtpërdrejt ose të njohurve të tyre.

(2) S.Q.

154. Trupi gjykues ka konstatuar se **S.Q.**, vëllai i S.Q.1, ka qenë anëtar i grupit të organizuar kriminal më së voni nga nëntori 2012. Ai kishte rol të përgjithshëm të kujdesej për transaksionet financiare dhe ta zëvendësoj vëllain kur ai nuk ishte aty. Në shumë raste ai ishte përgjegjës për transferimin e parave nga personat e kontrabanduar pas arritjes te bashkë-kryesit në Hungari. Veç kësaj, ai kishte takuar në Kosovë klientë

ose të afërm të tyre për mbledhjen e parave dhe ishte takuar me bashkë-kryes kosovar. **S.Q.** nganjëherë zëvendësonte vëllain e tij edhe në takimet me bashkë-kryes tjerë dhe ishte i përfshirë në përpjekjet e **S.Q.1** për zbulimin e prejardhjes së përfitimit që siguronte.

155. I pandehuri ishte në dijeni për aktivitetet kriminale dhe strukturën e grupit dhe i njihnte të pandehurit tjerë dhe rolet e tyre në grupin në Kosovë. Ai e dinte se grupi synonte të nxjerr përfitime nga aktivitetet e paligjshme dhe qëllimi i tij ishte ta mbështes këtë objektiv.

Prova

156. Të gjeturat faktike si më lartë për të pandehurin **S.Q.** bazohen kryesisht në hetimet financiare, nga përgjimet e ligjshme të telekomunikimeve në lidhje me provat e tjera të pranuar. Raporti i Policisë së Kosovës për zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2014¹⁴⁷ tregon se **S.Q.** prej nëntorit 2012 ka bërë transaksione financiare për grupin më shumë se 40 herë. Ai u ka dërguar para anëtarëve të grupit në Hungari ose ka marrë pagesa nga migrantët në Austri ose vende tjera duke përdorur llogari bankare ose nëpërmes kompanive për transferte të parave. Në shumë raste tjera shuma relevante janë dërguar në emër të gruas së **S.Q.**, H.M.Q. Është vënë re se nga telekomunikimet e përgjuara padyshim mësohet se i pandehuri e ka përdorur emrin e gruas së tij për kryerjen e transferteve¹⁴⁸. Në disa raste gjatë përgjimit të telekomunikimeve ai ka diskutuar mbi atë se po e përdorte emrin e saj, p.sh., me 17 korrik 2013 në ora 14:44.¹⁴⁹

157. Raporti për zbulimin e informatave financiare¹⁵⁰ tregon p.sh., se me 13 nëntor 2012 nga H.M. i është dërguar shuma prej 86 € nëpërmes UFP A.H -it në Hungari. Pastaj hetimet kanë treguar se me 14, 16 dhe 26 nëntor 2012 dhe me 7 dhjetor 2012 një shumë prej 1,486 € nga H.M. i është dërguar nëpërmes UFP Z.V në Hungari. Me 22 nëntor 2012 Z.V. -s në Hungari i janë dërguar 367.50 € në emër të H.M.. Me 29 nëntor dhe 19 dhjetor 2012 A.H.S -it në Hungari i është dërguar një shumë prej 186 € në emër të H.M. Me 20 qershor, 3 dhe 16 korrik 2013 shumat 1, 338 €, 1, 143€ dhe 851€ u janë dërguar Z.S.H. dhe A.L. në Hungari dhe A.O.J. në Austri në emër të H.M... Me 28 qershor dhe 16 korrik 2013 shuma prej 2,800€ i është G.I. and M.P. në Serbi përmes DMTH në emrin e H.M. Raporti i sipërm më tej tregon se gjatë qershorit dhe korrikut 2013 Qitaku ka pranuar nëpërmjet UFP disa shuma gjithsej 4,900€ nga dërguesit në Gjermani,

¹⁴⁷Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2014, Regjistratori 10, fashikull 5.

¹⁴⁸Shiko raportin e ekipit të përbashkët të hetimeve i datës 19 korrik 2013, faqe 13 dhe 14, Regjistratori 11.

¹⁴⁹Shiko raportin e ekipit të përbashkët të hetimeve i datës 19 korrik 2013, faqe 2, 3, 12, 13, Regjistratori 11.

¹⁵⁰Raporti i policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2014, faqe 6, regjistratori 10, fashikull 5.

Belgikë dhe Francë. Me 19 dhe 29 nëntor 2013 ai ka marrë nëpërmes DMTH-së një shumë prej 1,000 € nga A.C., një bashkë-kryes i supozuar që jeton në Gjermani.

158. Në deklaratën e tij i pandehuri **Q.** ka thënë se ka bërë transfere në emër të vëllait të tij, pa ditur qëllimin e transferit. Duke pasur parasysh numrin e madh të transaksioneve, përdhën gjatë së cilës janë kryer ato dhe destinimin për ku ishin dërguar parat, trupi gjykues konstaton se kjo deklaratë nuk është e besueshme. Se i pandehuri ka pasur dijeni për aktivitetet e grupit në fjalë mbështetet edhe nga përgjimi i telekomunikimeve. Nga përgjimi i komunikimeve mes S.1. and **S.Q.** është e qartë se **S.Q.** dërgonte dhe pranonte para në emër të vëllait dhe të grupit të kontrabandistëve. Në disa rase Samiu i ka treguar **S.** si të bëj transfere.¹⁵¹
159. Përfshirja e **S.Q.** në menaxhimin e përfitimeve provohet mes tjera edhe me faktin se sipas raportit¹⁵² shuma prej 5,000 €, para në dorë, është deponuar në llogarinë bankare të H.M., në bankën RBKO kurse sipas përgjimit të telekomunikimeve është e qartë se këto para janë të S.Q.1. dhe janë depozituar nga **S.Q.**... Përveç kësaj, sipas informata të siguruar gjatë hetimeve financiare dhe informatave nga inspektorati i Agjencionit të Regjistrimit Civil i pandehuri në periudhën nga dhjetori 2012 deri në shtator 2013 ka regjistruar katër vetura të ndryshme në emër të vet.
160. Trupi gjykues gjen se sipas hetimeve financiare në periudhën hetuese i pandehuri nuk ka pasur të ardhura të ligjshme dhe se gjatë gjykimit nuk ka dhënë ndonjë shpjegim për aktivitete e cekura financiare.
161. Fakti se i pandehuri ka qenë në dijeni për strukturën e grupit mbështetet nga rezultati i hetimeve financiare si edhe nga përgjimet. Rezultati i përgjimit të telekomunikimeve tregon se **S.Q.** i ka njohur anëtarët tjerë kosovarë të grupit dhe ka qenë në kontakt me ta. Kjo dëshkohet me faktin se anëtarët tjerë janë përmendur gjatë bisedave të zhvilluara mes S.1 dhe **S.Q.**, dhe se **S.** ka pasur kontakt të drejtpërdrejt me bashkë-kryesit ose me telefon ose personalisht. .P.sh., me 17 korrik 2013 në ora 16:16 gjatë një bisede telefonike ndërmjet **S.** dhe S.1, S.1 ia jap telefonin **L.** Në një bisedë tjetër po të njëjtën ditë ora 16:20 ata e përmendin emrin e **L.**¹⁵³ Me 18 nëntor 2013 në ora 20:11 nga një përgjim telefonik mësohet se **S.** do të takohet me **L.** dhe këtë e diskutojnë me **S.**¹⁵⁴
162. Me 15 tetor 2013 në ora 19:55 nga përgjimi ligjor i numrit të telefonit 0498852539 i regjistruar në emër të F.K. merret vesh për një bisedë ndërmjet dy femrave të panjohura

¹⁵¹Raporti i ekipit të përbashkët hetues në përgjimin e numrit të telefonit 049602418, regjistratori 9, fashikull 9, faqe 130.

¹⁵²Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 23 mars 2014, faqe 16, regjistratori 10, fashikull 5.

¹⁵³Shiko raportin mbi ekipin e përbashkët hetues i datës 19 korrik 2013, faqe 2 dhe 3 dhe Regjistratori 11.

¹⁵⁴Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049602418, Regjistratori 9, fash 9, faqe 129.

që kanë përmendur kalimin e disa personave dhe se S.1. e kishte marrë **S.** me vete ¹⁵⁵. Me 11 nëntor 2013 në ora 11:28 nga telefonata ndërmjet **S.Q.** dhe nënës së tij mësohet se të dy janë të informuar mirë për aktivitetet e S.1. ¹⁵⁶.

163. Provat tregojnë se **S.Q.** ka qenë në kontakt edhe me të pandehurit tjerë. Përgjimet e telekomunikimeve tregojnë se me 6 dhjetor 2013 në ora 13:53 **S.S.** ka thirrur **S.** dhe e ka pyetur për S.1.. Ai thotë se kishte disa probleme urgjente për t'i zgjedhur. Është e qartë se **S.** e kupton pa sqarime tjera. Atij i kërkohet ta informoj S.1.. sapo të jetë zgjuar nga gjumi.¹⁵⁷ Nga përgjimi i komunikimit me 18 tetor 2013 në ora 21:12 mësohet se **S.S.** ka shkuar te shtëpia e S.Q.1.. S.1.. nuk ka qenë aty por ai është takuar me **S.** i cili e ka thirrur S.1. që të bisedojnë.

164. Fakti se **S.Q.** në disa raste ka shërbyer si zëvendës për S.Q.1. provohet edhe nga disa përgjime telefonike. Në shumë raste të tjerët e kanë thirrur Salihun që kanë dashur të flasin me S.Q.1. dhe kanë pasur vështirësi sepse ky i dyti shpesh i ka ndërruar numrat e telefonit. Sipas përgjimit të telefonit të **S.Q.** ai ka marrë mesazhe për kontrabandim të migrantëve me 7, 10, 12 dhe 18 tetor dhe 18 e 25 nëntor 2013. ¹⁵⁸ Nga përgjimet e bisedave telefonike mësohet pa dyshim se me 25 shtator 2013 **S.Q.** është takuar me **S.S.** dhe F.K. në Klinikë për ta zëvendësuar vëllain e vet dhe të merret me transaksionet financiare brenda në grup. Në një bisedë me 26 korrik 2013 në ora 11:39 F.K. ka pyetur pse Samiu e kishte dërguar vëllain e vet.¹⁵⁹ Me 20 shtator 2013 S.Q.1. është përgjuar derisa ka zhvilluar një bisedë telefonike me një klient me ermin A., gjatë bisedës ai thotë se në çdo rast A., mund ta kontaktoj edhe vëllain e tij. ¹⁶⁰

(3) L.M.

165. Trupi gjykues ka gjetur se **L.M.** ka qenë anëtarë shumë aktiv i grupit më së voni prej nëntorit 2012 deri në arrestimin e tij në dhjetor 2013. Ai e ka njohur S.Q.1. që prej fëmijërisë dhe ka pasur një lidhje të ngushtë me të. **M.**, siç ceket në përshkrimin e incidentit të kontrabandës, ka pasur rol aktiv në organizimin dhe realizimin e operacioneve të kontrabandës, por ka qenë edhe rekrutues aktiv i migrantëve të ri dhe është marrë me shpërndarjen e përfitimeve materiale. Ai ka takuar S.Q.1. shpeshherë dhe ka qenë në kontakt me **S.Q.** dhe të pandehurit tjerë. Ai takonte migrantët për diskutimin e udhëtimit dhe merrte pagesat.

¹⁵⁵Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049549593, Regjistratori 7, fash 16, faqe 328.

¹⁵⁶Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049602418, Regjistratori 9, fash 9, faqe 129.

¹⁵⁷Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049602418, Regjistratori 9, fash 9, faqe 222.

¹⁵⁸Raporti i ekipit të përbashkët hetues i datës 25 nëntor 2013, Regjistratori 9, fash 7, faqe 70 deri 72.

¹⁵⁹Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049549593, Regjistratori 7, fash 16.

¹⁶⁰Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049864936 i datës 25 shtator 2013, Regjistratori 8, fash 6, faqe 48.

166. I pandehuri ishte në dijeni për aktivitetet kriminale dhe strukturën e grupit jo vetëm në Kosovë por edhe në Hungari. Ai i njihte të pandehurit tjerë dhe i dinte rolet e detyrat e tyre në grup dhe jo vetëm që ka vepruar sipas udhëzimeve por ka marrë vendime krye në vete për zbatimin e operacioneve. Ai kishte për qëllim të nxjerr përfitime nga aktivitetet kriminale.

Prova

167. Faktet e vërtetuara dhe roli i **L.M.** bazohen në përgjimet e telekomunikimeve, operacioneve të vëzhgimit, hetimeve financiare, marrjes në pyetje të dëshmitarëve si edhe në deklaratat e tij gjatë gjykimit. I pandehuri ka pranuar se ka marrë pjesë në dy raste të kontrabandës por ka mohuar se ka pasur dijeni për ekzistencën e grupit dhe se ka krijuar përfitimit të konsiderueshme nga ky aktivitet.

168. Prova kryesore për pjesëmarrjen e të pandehurit Miftari në operacionet e kontrabandës është paraqitur më lartë. Trupi gjykues ka gjetur prova shtesë të cilat vërtetojnë rolin e të pandehurit në grup, njohjen e tij me strukturën e grupit dhe qëllimin e tij për të krijuar përfitime materiale me aktivitetet kriminale.

169. I pandehuri ka deklaruar se nuk ishte në dijeni për ekzistimin e grupit. Në bazë të pjesëmarrjes së ngjeshur të pandehurit në këto operacione dhe përmbajtjes së përgjimeve trupi gjykues ka vlerësuar se kjo deklaratë nuk është e besueshme. Nga provat e cekura më lartë është më se e qartë se **M.** ka qenë në kontakt të rregullt me S.Q.1. Po ashtu është vërtetuar edhe se ai ka qenë në dijeni për strukturën jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj. Gjatë një bisede telefonike ndërmjet **L.M** dhe S.Q.1 me 12 shtator 2013 të pandehurit kanë diskutuar për rolin e A.H.S si organizatore e shoferëve hungarez.¹⁶¹Nga ky komunikim shihet se **M.** ka dijeni për strukturën e grupit në Hungari dhe për problemet që kanë ndodhur pas arrestimit të saj.

170. Në disa raste i pandehuri ka kryer transfere financiare për bashkë-kryesit në Hungari. Në nëntor dhe dhjetor 2012 ai u ka transferuar shuma të mëdha S.O. dhe Z.V..-it. Në qershor 2013 i ka dërguar V.G. -it në Hungari 1,700 euro. Me 4 shtator 2013 i ka transferuar 1,350 € M.P., -s – shofer hungarez.¹⁶²

171. Se **M.** e kishte njohur F. K. dhe ka bashkëpunuar me të vërtetohet nga përgjimi i telekomunikimeve ndërmjet tyre.¹⁶³ Përgjimi tregon qartë se **M.** dhe K. kanë diskutuar për operacionet individuale, për strukturën e grupit dhe rolin e S.Q.1 dhe zbatimin e

¹⁶¹Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e numrit 049812663, Regjistratori 11, fash 21, faqe 171.

¹⁶²Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 23 mars 2014, Regjistratori 10, fash 5.

¹⁶³Përgjimi ligjor i **L.M.**, Regjistratori 21, 22; bisede me 2 nëntor 2013 në ora 16:59, 7 nëntor 2012 në ora 19:23, 10 nëntor 2013 në ora 22:44.

operacioneve në proces. Gjatë një bisede këta diskutuan rastin kur dy nga migrantët në udhëtim kishin gjetur një grup tjetër kontrabanduesish dhe kishin vendosur ta vazhdojnë udhëtimin me ta.¹⁶⁴ Operacionet e vëzhgimit të policisë tregojnë se i pandehuri gjatë një operacioni kontrabandues vetë ishte takuar me F.K. me 22 shtator 2013.¹⁶⁵

172. Pas analizimit të përgjimeve të telekomunikimit trupi gjykues vërtetoi se i pandehuri për një kohë të konsiderueshme ka qenë gati çdo ditë i angazhuar në organizimin e kalimit të paligjshëm të kufirit. Nga përgjimi shihet qartë qëllimi i tij për nxjerrjen e përfitimit material dhe është vërtetuar që jo vetëm se ka ekzekutuar udhëzimet e S.Q.1, por ka pasur liri veprimi në negocimin e çmimeve. Këtë e dëshmojnë edhe deklaratat e dëshmitarëve që kanë deklaruar se **M.** ka kërkuar shuma të konsiderueshme të parave për organizimin e udhëtimit të paligjshëm për në shtetet e bashkimit evropian. Në rastin e Q.S. i pandehuri ka kërkuar një çmim prej 2,800€ për ta organizuar në mënyrë të paligjshme migrimin e djalit të dëshmitarit.¹⁶⁶

(4)F.K.

173. Trupi gjykues ka gjetur se **F.K.** ka qenë anëtarë shumë aktiv i grupit më së voni nga nëntori i vitit 2012. Ai e kishte për detyrë t'i shoqëroj grupet e migrantëve nga Kosova në kufirin serbo-hungarez por është marrë edhe me rekrutimin e migrantëve të ri, planifikimin e udhëtimeve dhe mbledhjen e shpërndarjen e përfitimeve materiale.

174. I pandehuri ka pasur dijeni të plotë për aktivitetet kriminale dhe për strukturën e grupit dhe ka qenë në kontakt të rregullt me S.Q.1. dhe **S.S.**, por edhe me anëtarët tjerë të grupit nga Kosova. Ai ka pasur për qëllim të krijoj përfitime nga aktivitetet kriminale.

Provat

175. Faktet e vërtetuara për rolin e **F.K** bazohen në përgjimin e telekomunikimeve, sendeve të konfiskuara gjatë bastisjeve në shtëpitë e të pandehurit, nga vëzhgimi i operacioneve të vëzhgimit dhe hetimet financiare si dhe nga deklaratat e tij gjatë gjykimit. I pandehuri ka pranuar se ka marrë pjesë në operacionet e kontrabandës dy herë, kur u kishte ndihmuar të njohurve që kanë dashur të migrojnë në vendet e Bashkimit European në mënyrë të paligjshme.

176. Prova kryesore për pjesëmarrjen e të pandehurit **K.** në operacionet e kontrabandës është paraqitur më lartë. Trupi gjykues ka gjetur prova shtesë që vërtetojnë rolin e të

¹⁶⁴Përgjimi ligjor i **L.M.**, Regjistratori 21, 10 nëntor 2013 në ora 22:44

¹⁶⁵Raporti i vëzhgimit i datës 27 shtator 2013, regjistratori 17, fash 11.

¹⁶⁶Shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor me 22 korrik 2015, në lidhje me deklaratën e dëshmitarit në procedurë paraprake me 18 qershor 2014, Regjistratori 29, fash10.

pandehurit në grup, njohjen e tij me strukturën e grupit dhe synimin për të nxjerrë përfitime materiale me aktivitete kriminale.

177. Gjatë bastisjeve në shtëpinë e Kastratit është gjetur një numër i madh i biletave të autobusit për relacionin Prishtinë ose Prizren – Beograd e deri në Suboticë.¹⁶⁷ Shihet qarët se i pandehuri që nga nëntori i vitit 2012 ka udhëtuar rregullisht në Suboticë dhe është kthyer të nesërmen. Kur është marrë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri ka pranuar se ka udhëtuar në Suboticë shumë shpesh gjatë kësaj periudhe por nuk ka dhënë ndonjë shpjegim të besueshëm se çka bënte atje.
178. Trupi gjykues ka konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka marrë pjesë në aktivitetet e grupit për përfitime materiale dhe se ka përfituar nga këto aktivitete. Trupi gjykues ka marrë në konsideratë se i pandehuri gjatë kohës në fjalë nuk ka pasur ndonjë të hyrë të paligjshme por ka kryer disa transaksione financiare që tregojnë se ka pas në posedim shuma të mëdha parash. Siç u përshkrua më lartë në përshkrimin e provave për operacionet individuale i pandehuri ka depozituar shuma të mëdha parash në llogarinë e vet bankare dhe të birit në mars dhe në prill, në gusht 2013 dhe u ka dërguar transaksione bashkë-kryesve hungarezë. Në nëntor 2012 i pandehuri ka depozituar shumat 1,500€ 1,200€ dhe 1200 franga në llogarinë e vet bankare.¹⁶⁸ Me 4 dhe 13 dhjetor 2012 ka depozituar 2,500 dhe 500€ në llogarinë e vet, me 25 shtator 2013 ka depozituar 3,500€ në llogarinë e vet bankare.¹⁶⁹
179. Të gjeturat mbi qëllimin e të pandehurit dhe të qenët në dijeni për strukturën e grupit bazohen edhe në rezultatet e përgjimit të ligjshëm të telekomunikimeve. Nga biseda e zhvilluar ndemjet të pandehurit dhe **S.S.** me 19 shtator 2013¹⁷⁰ kuptohet qarët se këta kanë biseduar për të përfitimet e tyre në operacionet e zhvilluara dhe se kanë biseduar për rolin e S.Q.1. në organizim. Përgjimet tjera me 27 dhe 30 shtator 2013 tregojnë se i pandehuri komunikon me migrantë dhe ju ofron atyre transport të paligjshëm për në Evropë ose Vjenë. Përgjimi tregon se i pandehuri ka qenë në kontakt të rregullt me bashkë të akuzuarin **L.M.,,** me të cilin ka diskutuar në hollësi për zbatimin e operacioneve, edhe për problemet e mundshme dhe rrugët alternative dhe përfitimin që u mbetet atyre.¹⁷¹

¹⁶⁷Raporti i ekipit të përbashkët hetues i datës 24 janar 2014; Regjistratori 19, fash D.

¹⁶⁸Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2014, Regjistratori 20, fash 5.

¹⁶⁹Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 23 mars 2014, Regjistratori 20, fash 5

¹⁷⁰Përgjimi ligjor i datës 19 shtator 2013 në ora 22:33, Regjistratori 11, fash 24, faqe 195.

¹⁷¹Përgjimi ligjor i **L.M.,,** Regjistratori 21, 22; biseda me 2 nëntor 2013 në ora 16:59, 7 nëntor 2012 anë ora 19:23, 10 nëntor 2013 në ora 22:44.

180. Vëzhgimi i policisë me 22 shtator 2013 tregon se Kastrati dhe Miftari kanë pasur kontakte personale edhe gjatë operacioneve.¹⁷²

181. Bisedat e përgjuara tregojnë se edhe **K.** ishte i përfshirë në organizim dhe i ka ditur qartë rolet e ndryshme të bashkë-kryesve në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Gjatë një bisede telefonike **K.** po fliste me S.Q.1. i cili ankohej për **L.M...** Në një bisedë ndërmjet **K.** dhe S.Q.1. me 22 nëntor 2013 në ora 10:06:16 ata diskutojnë për çmimin që kanë caktuar për një foshnje që kontrabandohet. S.Q.1. thotë se nuk do të caktoj ‘gjysmë çmimi’ për një foshnjë, **K.** thotë: “mund t’i çosh përmes maleve pa pagesë por hungarezët nuk do ta bëjnë këtë”, dhe më vonë “kurrë nuk do tu kërkoja njerëzve të paguanin për fëmijë të vegjël, ka pasur raste kur vetë i kam paguar hungarezët për fëmijë të vegjël”.

(4) S.S.

182. Trupi gjykues ka gjetur se **S.S.** ka qenë pjesëtar aktiv i grupit më së voni nga shkurti i vitit 2013. Ai kishte për detyrë të rekrutoj migrantë por edhe t’i shoqëroj ata nga Kosova deri në kufirin serbo-hungarez. Ai është marrë më pak sesa anëtarët tjerë të grupit me aktivitetet por kishte dijeni për aktivitetet kriminale dhe strukturën e gjithë grupit. Ka qenë në kontakt të rregullt me S.Q.1 dhe **F.K.**, si edhe me anëtarët tjerë kosovar të grupit, me shoferët serbë dhe me migrantët. Ai ka marrë pjesë në aktivitetet e grupit me qëllim të përfitimit material.

Provat

183. Faktet e vërtetuara për rolin e **S.S.** janë bazuar në përgjimin e telekomunikimit, operacioneve vëzhguese dhe hetimet financiare si edhe në deklaratat e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor. I pandehuri ka pranuar se ka marrë pjesë në operacionet e kontrabandimit dy herë kur i ka ndihmuar të njohurit që kanë dashur të migrojnë në mënyrë të paligjshme në shtetet e bashkimit Evropian.

184. Ndonëse prova kryesore për pjesëmarrjen e të pandehurit **S.** në këto operacione të kontrabandës paraqitet më lartë, trupi gjykues ka gjetur prova shtesë që vërtetojnë rolin e të pandehurit në grup, njohjen e strukturës së grupit dhe qëllimin e tij për përfitime materiale me aktivitete kriminale. Fakti që i pandehuri ka qenë i përfshirë në këtë grup më së voni nga shkurti i vitit 2013 dëshmohet nga raporti për zbulimin e të dhënave financiare i cili tregon se ka kryer transaksione financiare për grupin. Me 26 shkurt 2013 i

¹⁷²Raporti i vëzhgimit i datës 27 shtator 2013, Regjistratori 17, fash 11.

ka dërguar A.H. në Hungari 100 €. ¹⁷³ Kjo tregon se ai ishte në dijeni për shtrirjen ndërkombëtare të grupit.

185. Të gjeturat se **S.** dinte për anëtarët e grupit dhe për aktivitetet e tyre bazohet në analizimin e përgjimeve të telekomunikimit. Siç kishte thënë vetë ai, **S.** ka pasur kontakte të afërta me të pandehurin **K.** Nga komunikimi i **S.** dhe S.Q.1 të përgjuar mes 17 dhe 21 qershor 2013 shihet sheshazi se Sadriu ishte në mënyrë aktive i kyçur në organizimin e operacionit të kontrabandës ndërkombëtare dhe dinte nëpër cilat rrugë kanë kaluar migrantë, destinimet ku synon të shkonin, bashkë-kryesit dhe modus operandi-n e grupit. Në shtator 2013 Sadriu ishte përgjuar kur po bisedonte për kontrabandimin e migrantëve me S.Q.1 dhe **F.K.** ¹⁷⁴ Pastaj në raportin e policisë përmendet vëzhgimi i kryer me 18 nëntor 2013 që në këtë rast Sadriu po takohej vetë me S.Q.1 dhe **K.** dhe se ai ishte i angazhuar në mënyrë aktive në transportimin e migrantëve. Në dhjetor 2013 policia prapë kanë përgjuar komunikimet telefonike ndërmjet **S.** dhe **S.Q.**, në të cilën këta kanë diskutuar për një operacion kontrabandimi në proces. ¹⁷⁵

186. Në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri ka deklaruar se nuk ka përfituar nga ndihma që u ka ofruar njerëzve të imigrojnë ilegalisht por se këtë e bënte si favor. Pastaj ai është ankuar se nuk mund të ishte e vërtetë se S.Q.1. fitonte shumë kurse ky nuk kishte fituar asgjë dhe ende ishte i varfër. Trupi gjykues nuk ka gjetur shumë prova se sa kishte fituar i pandehuri nga aktivitetet. Por nga bisedat e përgjuara dhe duke qenë se ai ka njohur gjithë grupin, trupi gjykues është i bindur se i vetmi qëllim i pandehurit për t'u kyçur në aktivitete kriminale ishte të fitoj para. Gjatë një bisede ndërmjet Sadriut dhe Kastratit me 19 shtator 2013 Sadriu ankohet për S.Q.1. duke thënë se “për ne nuk do të mbetet as 100 euro për copë” ¹⁷⁶. Kjo mbështetet me të gjeturat se në maj 2013 i pandehuri kishte blerë një veturë për 3,500€ ani pse gjatë asaj kohe nuk kishte para të ligjshme. ¹⁷⁷ Sa i takon përfitimeve nga aktivitetet më vonë atë vit, trupi gjykues konstaton se është arsyeshme të besohet se fitimet e të pandehurit nuk mund të gjurmohen.

187. Fakti se i pandehuri jo vetëm që ka ekzekutuar urdhrat e S.Q.1. në grup por se ka rekrutuar klientët e vet dëshmohet edhe nga përgjimi i telekomunikimeve. Bisedat e

¹⁷³Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2014, Regjistratori 20, fash 5.

¹⁷⁴Ekipi i përbashkët hetues, raport për përgjimin e numrit 049812663, Regjistratori 11, fash 19, Regjistratori 12, fash 5 dhe 18

¹⁷⁵Ekipi i përbashkët hetues, raportin për përgjimin e telefonit 049812663, Regjistratori 11, fash 19, përgjimi 6 dhjetor 2013.

¹⁷⁶Përgjimi ligjor i datës 19 shtator 2013 në ora 22:33, Regjistratori 11, fash 24, faqe 195.

¹⁷⁷Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 28 mars 2014; Regjistratori 20, fash 5.

përgjuara në qershor 2012 tregojnë qartazi se i pandehuri **S.** brengosej për fatin e klientëve të “vet”¹⁷⁸

(5) Struktura e grupit në Hungari

188. Provat për strukturën e grupit në Hungari bazohen në deklaratën e dëshmitarit A.S. gjatë shqyrtimit gjyqësor¹⁷⁹ si edhe nga informatat prej EUROPOL-it, mesazhet e shkëmbyera dhe nga organet hungareze¹⁸⁰, në veçanti lidhur e arrestimin e shoferëve dhe migrantëve në Hungari. Informatat për aktivitetin e grupit lidhur me bashkë-kryesit në Serbi, Austri dhe Gjermani është bazuar në informatat nga përgjimin i të pandehurve.
181

F. FAKTET QË NUK JANË VËRTETUAR

189. Gjykata i konsideron faktet në vijim jo të vërtetuara nga shkaqet që shtjellohen më poshtë.

190. Trupi gjykues nuk e ka konsideruar si të vërtetuar faktin se të pandehurit kanë kryer një operacion kontrabandues në fund të nëntorit të vitit 2012, që ceket në pikën 4, 5 dhe 6 nën (1) të aktakuzës. Në këtë pikë prokuroria i ngarkon të pandehurit për ‘kontrabandim të migrantëve në fund të nëntorit 2012 bashkë me një grup të qytetarëve të Kosovës nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe Austri, të kryer si pjesë e grupit (...)’ Trupi gjykues ka gjetur se supozim në këtë Pikë ka qenë shumë i zbehtë që të vërtetohet pasi që nuk përcakton datën as identitetet apo ndonjë numër të personave përkatës.

191. Trupi gjykues nuk e ka marrë si të vërtetë përfshirjen e të pandehurve në operacionin B të kontrabandimit që është kryer me 21 dhjetor 2012 siç supozohet në pikën 4, 5 dhe nën (2) të pikës 7 nën (1) të aktakuzës. Ndonëse shkresat e lëndës tregojnë se gjatë kësaj kohe anëtarët e grupit në Kosovë u kanë transferuar para bashkë kryesve në Hungari nuk është gjetur lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet të pandehurve dhe operacionit të supozuar.

192. Pastaj, trupi gjykues nuk ka gjetur prova të mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **S.Q.** ka marrë pjesë në operacionet kontrabandues G, I, N dhe T siç supozohet në pikën 4 nën (4), (5), (8) dhe (11).

¹⁷⁸Përgjimi ligjor i datës 19 shtator 2013 në ora 22:33, Regjistratori 11, fash 24, faqe 195

¹⁷⁹Procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor me 7 korrik 2015.

¹⁸⁰Shiko Regjistratori 26, Analiza e përgjimit të ligjshëm të **S.Q.**, numra hungarez.

¹⁸¹Në këtë aspekt vërehet se informatat janë shumë të kufizuara dhe kryesisht kanë të bëjnë me pikë takimet pas transferimit të migrantëve dhe transaksioneve financiare nga Austria/Gjermania në Kosovë ose nga Kosova në Serbi.

193. Lidhur me operacionin G që është kryer me 7 dhe 19 qershor 2013, trupi gjykues ka marrë në konsideratë faktin se zbulimi financiar ka treguar se i pandehuri ka pranuar nëpërmes UFP shumë prej 1,500 eurosh dhe 400 euro nga dërguesit në Gjermani dhe Belgjikë,¹⁸² por vlerëson se kjo informatë nuk mjafton për ta vërtetuar përfshirjen e tij në operacion kontrabanduese.
194. Sa i përket operacionit I që ceket në pikën 4 nën (5) trupi gjykues ka konstatuar se provat e paraqitura nuk mjaftojnë për të vërtetuar se i pandehuri ka marrë pjesë në kontrabandim të migrantëve me 20 qershor 2013. Edhe nëse ka prova se **Q.** përmes llogarisë së gruas së vet ia ka transferuar shumë prej 1,338 eurove Z.S.H. në Hungari përmes UFP¹⁸³, ky transferim nuk mund të lidhet me operacionin në fjalë.
195. Për operacionin kontrabandues N (Pika 4 nën (8)) trupi gjykues ka gjetur se përgjimi i bisedës ndërmjet S.Q.1 dhe **L.M.** me 18 shtator 2013 tregon se i pandehuri i kishte dijeni për operacionin por nuk ka vërtetuar se ai ishte i përfshirë në të në çfarëdo mënyre. Kjo vlen edhe për operacionin T (pika 4 nën (11)), ku përgjimi i telekomunikimeve ndërmjet **S.S.** dhe **S.Q.** me 6 dhjetor 2013 zbulon se **S.Q.** ka qenë në dijeni për aktivitetet në proces, por nuk është vërtetuar lidhje direkte me operacionin.¹⁸⁴
196. Përveç të gjeturave për operacionet A dhe B trupi gjykues nuk ka gjetur si të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **L.M.** ka marrë pjesë në kontrabandimin e operacionit P (pika 6 nën (7)). Në këtë aspekt prova e vetme e paraqitur nga prokuroria është përgjimi i bisedës me 26 shtator 2013 në ora 21:30 ku i pandehuri thotë “ U krye. Ata janë brenda.” Trupi gjykues konstaton se nuk ka lidhje konkrete me operacionin në fjalë.
197. Veç kësaj, trupi gjykues nuk ka gjetur prova të mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **F.K.** ka marrë pjesë në operacionin kontrabandues K (pika 5 nën (5)). Lidhur me këtë operacion nuk ka prova relevante. Zbulimi i të dhënave financiare tregon se gjatë mesit të korrikut 2013 i pandehuri ka depozituar shumë prej 1,700 eurove në llogarinë e vet dhe të djalit të vet,¹⁸⁵ por trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë lidhje me operacionin kontrabandues në fjalë i cili supozohet se është kryer me 16 korrik dhe 10 gusht 2013.

¹⁸²Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 23 mars 2014, faqe 6, Regjistratori 20, fash 5.

¹⁸³Raporti i policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 23 mars 2014, faqe 16, Regjistratori 20, fash 5.

¹⁸⁴Raporti i ekipit të përbashkët hetues mbi përgjimin e telefonit 049602418, Regjistratori 9, fash 9, faqe 222, biseda me 6 dhjetor 2013, në ora 13:53

¹⁸⁵Raporti i Policisë së Kosovës mbi zbulimin e të dhënave financiare i datës 23 mars 2014, faqe 17, Regjistratori 20, fash 5.

198. Përveç të gjeturave që kanë të bëjnë me operacionin B, trupi gjykues nuk gjeti prova të mjaftueshme për ta përcaktuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri **S.S.** ka marrë pjesë në operacionet e kontrabandimit E, F, G, J dhe R (Akuza 7 nën (3), (4), (6) dhe (8)). Më tutje, trupi gjykues nuk gjeti prova që i pandehuri ishte i përfshirë në aktivitete kriminale të grupit përpara Shkurtit të vitit 2013. Sa i përket asaj që zbulimet financiare tregojnë se qysh në Dhjetor të vitit 2012, i pandehuri ndërmori një transfer të dyshimtë të parave, kur ai i dërgoi një shumë prej 100 EURO M.S. në Serbi,¹⁸⁶ trupi gjykues mori parasysh shpjegimin e të pandehurit dhe nuk është bindur përtej dyshimit të arsyeshëm që transferimi kishte të bënte me asistimin e aktiviteteve të grupit. I pandehuri gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, deklaroi se ai vet u mundua të shkonte në Unionin Evropian në Dhjetor të vitit 2012. Ai tha se ai ishte klient i S.Q.1, dhe se për këtë qëllim ai e kreu transferimin në Serbi, ku ai u bllokua gjatë këtij operacioni. Trupi gjykues nuk mund ta përjashtonte mundësinë që kjo ishte vërtetë mënyra sesi **S.** e takoi S.Q.1., dhe u përfshi në grup.
199. Sa i përket z. **S.** që me Akuzën 7 nën (2) është akuzuar me kontrabandim të migrantëve më 24 Janar 2013 (operacioni E), trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë provë. Trupi gjykues mori parasysh që ai më 26 Janar 2013 ia transferoi 100 EURO A.H. -t në Hungari,¹⁸⁷ por nuk e gjeti një lidhje konkrete me operacionin e ndjekur penalisht.
200. E njëjta vlen për operacionin e kontrabandimit F. Trupi gjykues pajtohet me Prokurorinë që aktivitetet financiare të pandehurit gjatë Prillit dhe Majit të vitit 2013¹⁸⁸ janë të dyshimta, pasi që ai nuk kishte një shpjegim për ndonjë burim ligjor të ardhurave, por përveç kësaj trupi gjykues nuk pa ndonjë lidhje me operacionin e ndjekur penalisht.
201. Për operacionet G, J dhe R¹⁸⁹, trupi gjykues nuk gjeti ndonjë provë që do të dëshmonte përfshirjen e z. **S.** në aktivitetet e përshkruara kriminale.

G. KUALIFIKIMI LIGJOR

I. Ligji në fuqi

202. Ligji material në fuqi është Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në fuqi që prej datës 1 janar 2013, në veçanti Nenet 170 dhe 283 të këtij kodi.

¹⁸⁶ Raporti i Policisë së Kosovës mbi shpalosjen e të dhënave financiare, i datës 23 Mars 2014, Skedari 20, tab 5.

¹⁸⁷ Raporti i Policisë së Kosovës mbi shpalosjen e të dhënave financiare, i datës 28 Mars 2014; Skedari 20, tab 5.

¹⁸⁸ Sipas Raportit të Policisë së Kosovës mbi shpalosjen e të dhënave financiare, i datës 28 Mars 2014; Skedari 20, tab 5, i pandehuri më 30 Prill 2013 i transferoi para **F.K.**, dhe më 20 Maj 2013 bleu një veturë.

¹⁸⁹ Akuzat 7.4, 7.6 dhe 7.8 i Aktakuzës.

203. Aktivitetet kriminale të të pandehurve ndodhën ndërmjet Nëntorit të vitit 2012 dhe Dhjetorit të vitit 2013. Gjatë kësaj kohe ligji penal në Kosovë ka ndryshuar, pasi që prej 1 Janarit 2013 ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Në aktakuzë, Prokuroria i referohet të dyjave, duke i akuzuar të pandehurit me Nenin 170 të KPK-së dhe ku është e aplikueshme me Nenin 138 të KPRK-së, për Kontrabandim të migrantëve, me Nenin 283 të KPK-së, dhe ku është e aplikueshme me Nenin 274 të KPRK-së. Prokuroria iu referua Nenit 3 të KPP-së për ta përcaktuar ligjin penal në fuqi.
204. Trupi gjykues vë në dukje se në këtë rast, parimi i përgjithshëm i ligjit më të favorshëm, i cili është paraqitur në Nenin 3 të KPP-së, nuk është i vlefshëm, pasi që veprat penale në këtë rast konkret, janë kryer si vepra penale në vazhdimësi, sipas Nenit 81 të KPP-së. Në një situatë të tillë, ku gjatë kryerjes së një veprës penale në vazhdimësi, ligji material ndryshon, vetëm ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës së fundit është i aplikueshëm.¹⁹⁰ Për këtë, në rastin konkret, ligji i aplikueshëm është ligji në fuqi që prej datës 1 Janar 2013, në veçanti Nenit 170 dhe 283 të KPK-së.¹⁹¹

II. Vlerësimi ligjor i fakteve të përcaktuara

(1) Kontrabandimi i migrantëve, Neni 170 (1), (3), (4), (6) dhe Neni 31 i KPK-së

205. Trupi gjykues gjeti se të katër të pandehurit janë fajtorë për Kontrabandim të migrantëve, në bashkëkryerje, sipas Nenit 170 (1), (3), (6) të KPK-së, por jo si të bashkë-akuzuar – sipas paragrafit (4).

Elementet e veprës penale

206. Sipas definicionit në paragrafin 8 të kësaj dispozite, kontrabandimi i migrantëve është çfarëdo veprimi me qëllimin për të siguruar përfitime materiale nga hyrja ilegale e një personi (...) i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, në një shtet në të cilin një person i tillë nuk është banor i përhershëm apo shtetas i një shteti të tillë. Hyrja ilegale është definuar si kalim i kufirit të shtetit pa i përmbushur kushtet e nevojshme për hyrje legale në një shtet të tillë. Për këtë, vepra penale përbëhet nga elementet: (a) kalimi i planifikuar i kufirit, pa i përmbushur kushtet e nevojshme për hyrje legale të një personi i cili nuk është banor i përhershëm apo shtetas i një shteti të tillë; (b) qëllimi për të siguruar përfitim nga kalimi i kufirit; dhe (c) çdo veprim i ndërmarrë për ta mundësuar kalimin e kufirit. Për më tutje, të pandehurit janë gjetur të kenë kryer veprën penale në (d) bashkëkryerje, sipas Nenit 31 të KPK-së. Si parim i përgjithshëm dhe sipas Neneve 22 dhe 23 të KPK-së, të pandehurit duhet të kenë vepruar me (e) qëllim, dhe duke qenë në dijeni mbi elementeve të veprës penale.

190 Shiko gjithashtu ECtHR 27 Janar 2015, Rohlena v. Republika e Çekisë, Appl. Nr. 59552/08, par. 69.

191 Sa i përket ndryshimit që ky vlerësim ka nga klasifikimi në aktakuzë, nuk është ri-kualifikim, por specifikim.

(a) Kalimi i planifikuar i kufirit në mënyrë ilegale

207. Trupi gjykues gjeti se në të gjitha operacionet e përshkruara të kontrabandimit, një grup i individëve nga Kosova u largua nga Kosova përmes Serbisë, me qëllimin për të hyrë në shtetet e Unionit Evropian, dhe se në të gjitha këto raste individët nuk ishin banor të ndonjë shteti anëtare e Unionit Evropian, dhe nuk i kanë përmbushur kushtet ligjore për të hyrë në shtetet ku ata kanë synuar të hyjnë; për këtë, qëllimi i këtyre njerëzve ishte që ti kalojnë kufijtë ilegalisht, për të hyrë në shtetet e Unionit Evropian. Trupi gjykues potencon që për veprën penale të Nenit 170 (1) të KPK-së, është e parëndësishme nëse individët në fakt e kanë kaluar ndonjë kufi apo jo. Pa marrë parasysh, në rastin konkret, shumë migrantë në fakt kanë arritur në destinacionit që ata dëshiruan të arrinin.

(b) Qëllimi për të siguruar përfitim

208. Individët në të gjitha rastet u paguan shuma të mëdha parash organizatorëve dhe ekzekutuesve të këtyre udhëtimeve. Zakonisht ata paguan një total prej së paku 1,500 EURO, por shpesh më shumë se 2,000 EUEO. Individët ishin në dijuni që shpenzimet reale të udhëtimit ishin shumë më të ulëta, dhe se ata duhej ti paguanin këto shuma për shkak të udhëtimit të tyre të paligjshëm. Trupi gjykues është i bindur që qëllimi kryesor për të pandehurit që të marrin pjesë në organizimin e udhëtimeve dhe të rekrutojnë individë të rinj, ishte për ti marrë këto para. Trupi gjykues mori parasysh që të pandehurit kanë pohuar ti kenë organizuar udhëtimet për tu ndihmuar shokëve apo anëtarëve të familjes, dhe se ata nuk kanë marrë asgjë apo vetëm “bakshishe” për shërbimet e tyre, por i vlerësoi këto deklaratat si jo të besueshme. Trupi gjykues i referohet fakteve të përcaktuara dhe në veçanti faktit se është e dëshmuar që grupi fitoi shuma të mëdha të parave nga këta individë. Edhe pse të pandehurit mund ta kenë pasur përshtypjen se ata nuk u kanë bërë asgjë të keqe migrantëve, është mjaft e qartë nga bisedat e tyre se interesi kryesor i tyre ka qenë përfitimi material.

209. Në rastin e **S.Q.**, trupi gjykues nuk ka mundur ta përcaktoj nëse ishte qëllimi i tij që të përfitoj personalisht nga aktivitetet e tija, apo nëse qëllimi i tij ishte që ti lejonte të pandehurit tjerë, në veçanti vëllain e tij, të përfitoj nga organizimi i operacioneve të kontrabandimit. Në lidhje me këtë, trupi gjykues vë në dukje se në këtë rast të pandehurit i kanë kryer veprat penale si bashkëkryerës. Për këtë, nuk është e nevojshme që secili i pandehur të kishte qëllimin që të përfitoj personalisht, përderisa veprimi i tij ishte i drejtuar drejt përfitimit, i cili mund të jetë përfitim i të tjerëve gjithashtu.

(c) Çdo veprim si sjellje inkriminuese

210. Trupi gjykues gjeti prova për të gjithë të pandehurit në rastet e lartcekura, se ata kryen veprën penale të kontrabandimit të migrantëve, pasi që ata ndërmorën veprime

për të siguruar përfitim nga kalimi ilegal i kufirit nga të tjerët. Trupi gjykues vë në dukje se pragu që një sjellje të inkriminohet nga kjo dispozitë, është shumë i ulët. Ligji kryesisht i referohet qëllimit të sjelljes.

211. Në rastin e **S.Q.**, trupi gjykues gjeti se në pesë raste ai ndërmori veprime për ta mundësuar kalimin ilegal të kufirit nga individët. Ai i mbështeti aktivitetet e grupit duke u marrë me anën financiare të operacionit. Në të gjitha këto raste, sikurse edhe në rastet tjera, ai ua transferoi pjesë të përfitimit material bashkëkryerësve në shtetet tjera. Në disa raste ai ishte i përfshirë edhe më tutje në organizimin e udhëtimeve, duke e mundësuar komunikimin ndërmjet vëllait të tij S.Q.1 dhe të pandehurve tjerë apo migrantëve të mundshëm, dhe ai personalisht i takoi të pandehurit tjerë për dorëzimin e parave të gatshme, pas ekzekutimit të operacionit.
212. Për **L.M.**, trupi gjykues gjeti prova se ai ishte i përfshirë në rekrutimin e migrantëve dhe në organizimin dhe ekzekutimin e operacioneve të kontrabandimit në tetë raste. I pandehuri po rekrutonte individë që ishin të interesuar që të shkojnë ilegalisht jashtë shtetit, dhe të cilët ishin në gjendje ti paguajnë shumat që i kërkonte grupi. Ai shërbente si personi i parë kontaktues, dhe i informonte migrantët për vendin dhe kohën e nisjes së tyre. Ai ndërli dhej me S.Q.1. dhe bashkëkryerësit e tjerë për ta organizuar kryerjen e operacionit. Në disa raste, ai personalisht kontaktonte me bashkëkryerës Serb, dhe i shoqëroi grupet e individëve për në kufirin Serbo-Hungarez.
213. Për **F.K.**, trupi gjykues gjeti prova se ai ndërmori veprime për ta mundësuar kalimin ilegal të kufirit nga individët, në pesë raste. Është dëshmuar se në shumë raste ai po rekrutonte njerëz që ishin të interesuar të shkonin jashtë shtetit dhe që ishin në gjendje të paguanin shumat që i kërkonte grupi. Ai u thoshte atyre individëve se ku dhe kur të takohen, dhe vihej në lidhje me S.Q.1 dhe bashkëkryerësit tjerë të mëtejshëm. Në shumë raste ai i shoqëronte grupet e migrantëve në rrugëtimin e tyre për në kufirin Serbo-Hungarez.
214. Trupi gjykues përcaktoi se i pandehuri **S.S.** ndërmori veprime për ta mundësuar kalimin ilegal të kufirit nga migrantët, në katër raste. Ai po rekrutonte individë që ishin në gjendje të kontrabandohen për në shtetet e Unionit Evropian. Ai i informonte ata kur dhe ku të takoheshin për nisjen e tyre, dhe në disa raste i shoqëroi ata deri në veri të Mitrovicës apo më tutje.

(d) Bashkëkryerja

215. Trupi gjykues gjeti se sipas fakteve të përcaktuara, të pandehurit i kryen veprat penale, në bashkëkryerje, sipas Nenit 31 të KPK-së, pasi që ata punuan së bashku për ta mundësuar kalimin ilegal të kufirit nga migrantët, dhe ata të gjithë morën pjesë

drejtpërdrejt në këtë apo kontribuuan në mënyrë substanciale në kryerjen e veprën penale.

216. Trupi gjykues e potencon se ai gjeti se roli i **S.Q.** ishte ai i bashkëkryerësit, dhe jo ai i ndihmësit, edhe pse përfshirja e tij ishte e ndryshme nga përfshirja e të pandehurve tjerë. **S.Q.**, siç ai e potencoi në deklaratat e tij në shqyrtim gjyqësor, pothuajse kurrë nuk kishte ndonjë kontakt personal me migrantët, dhe ai kryesisht po vepronte sipas udhëzimeve të vëllait të tij më të madh, S.Q.1.. Megjithatë, ai pati një rol të rëndësishëm në organizatën e grupit. Në një numër të madh të rasteve ai ishte përgjegjës për ti mbledhur dhe ndarë përfitimet e operacionit. Pa përfshirjen e tij, ekzekutimi i këtyre operacioneve do të ishte i vështirë, pasi që ai ishte në gjendje të transferonte para me anën e shumë mjeteve, dhe me emra të ndryshëm. Për këtë, pa asnjë dyshim ai kontribuoi në mënyrë substanciale në kryerjen e veprave penale.

(e) Qëllimi dhe të qënurit në dijuni

217. Trupi gjykues konkludoi nga faktet e përcaktuara sipas Nenit 23 të KPP-së, se të gjithë të pandehurit kanë vepruar me qëllimin e nevojshëm dhe me dijeninë e të gjitha elementeve të veprës penale. Sa i përket asaj që të pandehurit deklaruan se ata nuk ishin në dijuni që migrantët nuk i plotësonin kushtet e nevojshme ligjore, këto deklarata nuk janë të besueshme. Shumica e të pandehurve tashmë kishin udhëtuar jashtë shtetit dhe janë në dijuni mbi rregullat përkatëse. Ata e dinin që individët vetëm do ti paguanin çmimet që ata i kërkonin, pasi që ata nuk mund të hynin legalisht në shtetet e destinacionit. Dhe përveç asaj, të gjitha operacionet ishin të dizajnuara për ta mundësuar kalimin ilegal të kufirit për ata njerëz, dhe nuk do ti shërbenin ndonjë qëllimi nëse individët do të mund të hynin legalisht në Unionin Evropian.

Kualifikimet dhe variacionet

(a) Mundësimi i personave që të qëndrojnë në një shtet, Neni 170 (3) i KPK-së

218. Trupi gjykues më tutje gjeti se në disa nga rastet, të pandehurit dhe bashkëkryerësit e tyre, ua mundësuan personave që nuk ishin shtetas apo banorë të përhershëm të një shteti, të qëndrojnë në atë shtet pa i respektuar kushtet e kërkuara ligjore për të qëndruar në atë shtet, sipas paragrafit (3) të Nenit 170 të KPK-së. Duke i transportuar individët në mënyrë sekrete përmes Hungarisë apo shteteve tjera të Unionit Evropian, grupi ua mundësoi individëve që të qëndrojnë në ato shtete gjatë kohës së transportimit të tyre. Përderisa po kryheshin këto transferime, jo nga të pandehurit por nga bashkëkryerësit e tyre, është vërejtur që të pandehurit do të mbahen përgjegjës gjithashtu edhe për veprimet e planifikuara dhe të dakorduara të bashkëkryerësve të tyre. Sa i përket këtij kualifikimi, të pandehurit vepruan me qëllim jo të drejtpërdrejt,

pasi që objektivi i tyre kryesor ishte që ti sillnin ata migrantë në vendet që ata dëshironin të arrinin.

(b) Si pjesëtarë të një grupi, Neni 170 (6) i KPK-së

219. Trupi gjykues gjeti se të pandehurit i kryen veprat penale si pjesëtarë të një grupi, sipas Neni 170 (6) të KPK-së, pasi që ata po vepronin në bashkëpunim me më shumë se tre njerëz, siç kërkohet sipas definicionit në Nenin 120 nën 12 të KPK-së. Të pandehurit gjithashtu kishin dijeninë e nevojshme të grupit. Edhe pse jo të gjithë të pandehurit ishin të informuar në detaje mbi strukturën e grupit, ata të gjithë e dinin se ata po vepronin së bashku me më shumë se tre njerëz tashmë në Kosovë, dhe se ata po punonin me shumë bashkëkryerës tjerë jashtë shtetit.

(c) Tentativa, Neni 170 (4) i KPK-së

220. Në aktakuzë, Prokuroria pohon se të pandehurit në disa raste i kanë kryer veprat penale në formën e tentativës.¹⁹² Trupi gjykues thekson se sipas formulimit eksplicit të dispozitës, çdo veprim që ndërmerret me qëllimin për të siguruar përfitim nga kontrabandimi nga migrantëve, tashmë veç është vepër penale e kryer. Kjo domethënë në veçanti se është e parëndësishme se a ka qenë operacioni i kontrabandimit në fjalë i suksesshëm apo jo. Për këtë, trupi gjykues konkludon se në të gjitha rastet e përmendura, të pandehurit i përfunduan veprat penale që ata i kryen.

(d) Vepra penale në vazhdimësi

221. Trupi gjykues gjeti se disa raste të kontrabandimit të migrantëve janë kryer si vepra penale në vazhdimësi, sipas Neni 81 të KPK-së. Operacionet individuale që janë klasifikuar si kontrabandim i migrantëve, janë kryer nga të njëjtit kryerës gjatë një periudhe të caktuar kohore. Në këto operacione, të pandehurit po e shfrytëzonin të njëjtën situatë (paragrafi (1.3)), veprat penale janë kryer në të njëjtin vend (paragrafi (1.4.)) dhe qëllimi i të pandehurve ishte i njëjtë (paragrafi (1.5)). Veprat penale të kryera i përfshinin të dyja, forma të lehta dhe të rënda, dhe për këtë vepra penale në vazhdimësi është kryer në formën e rëndë, sipas Neni 81 (4) të KPK-së.

(2) Pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal, Neni 283 (1) CCK

222. Trupi gjykues gjeti se duke u bazuar në faktet e përcaktuara, të katër të pandehurit morën pjesë në një grup të organizuar kriminal, sipas Neni 283 (1) CCK.

¹⁹² Përdërisa kjo nuk është arsyetuar më tutje, është përmendur në mënyrë eksplicite në dispozitiv të aktakuzës, Akuzat 4, 5, 6 dhe 7.

Elementet e veprës penale

223. Sipas Nenit 120 nën 13 të KPK-së, një grup i organizuar kriminal është (a) një bashkim i strukturuar i tre apo më shumë personave, (b) i themeluar brenda një periudhe kohore, (c) për kryerjen e një vepre të caktuar penale, që (d) vepron në bashkëpunim me synimin e kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale, (e) në mënyrë që të siguroj, në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, përfitim financiar apo ndonjë përfitim të tjetër llojit. Sipas Nenit 283 (1) të KPK-së, i pandehuri merr pjesë në këtë grup nëse ai (f) merr pjesë në mënyrë aktive, me (g) qëllimin dhe dijeninë e synimit dhe aktivitetit të organizatës, dhe me dijeninë që pjesëmarrja e tij do të kontribuojë në të arriturat e aktiviteteve kriminale të grupit.

(a) Bashkimi i strukturuar i tre apo më shumë personave

224. Neni 120 nën 14 i KPK-së e definojnë bashkimin e strukturuar si një bashkim që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të ndonjë vepre penale, dhe e potencon që një bashkim i strukturuar nuk ka nevojë të ketë rrole të përcaktuara formalisht për anëtarët e vet, vazhdimësi apo anëtarësi apo strukturë të zhvilluar. Trupi gjykyes i referohet vlerësimit të vet për grupin dhe konkludon se në rastin konkret të pandehurit kryen vepra penale si një grup i përbërë nga më shumë se tre anëtarë. Ky grup nuk ishte i formuar rastësisht për kryerjen e një vepre penale, por përmbante një strukturë të qëndrueshme të anëtarëve të cilët ishin të gatshëm në çdo kohë që të angazhohen në kryerjen e përbashkët të veprave penale, dhe të cilët po kërkonin në mënyrë aktive për mundësi për të kryer vepra të mëtutjeshme penale. Aktivitetet e grupit udhëhiqeshin dhe koordinoheshin nga S.Q.1.. Të katër të pandehurit, së bashku me bashkëkryerësit e tjerë, po ekzekutonin dhe po organizonin veprimet e grupit në Kosovë. Detyrat kryesore të **M., K. dhe S** ishin që të rekrutojnë individë dhe ti kombinojnë ata me vendin dhe kohën e nisjes. Në disa raste detyrat e tyre ishin që gjithashtu ti dërgonin migrantët deri në kufirin Serbo-Hungarez, ti mbledhin tarifën nga të afërmit e të pandehurve pas operacioneve të suksesshme apo ta shpërndanin përfitimin. Bashkëkryerës të panjohur ishin përgjegjës për ti shoqëruar grupet e migrantëve përtej kufirit të gjelbër ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë dhe i drejtuan ata për në pika të caktuara të takimit, në të cilat pika kryesisht bashkëkryerësit Hungarez i merrnin dhe i dërgonin ata me automjete për në Vjenë apo më tutje. Kjo shpërndarje e detyrave për operacionet e kontrabandimit ishte e vendosur përgjatë një periudhe mbi një vjeçare, gjatë të cilës periudhë janë prezantuar vetëm ndryshime të vogla në *modus operandi*.

225. Rrolet e të katër të pandehurve në Kosovë, deri në njëfarë mase ishin fleksibile, pasi që ata në disa raste angazhoheshin vetëm në rekrutim, dhe në rastet e tjera edhe në ekzekutimin apo gjithashtu edhe në transaksionet financiare. Rrolet e të pandehurve kurrë nuk ishin të caktuara rastësisht, por ata e ndiqnin një model të përsëritur, i cili ia

mundësonte grupit që të punonte aq suksesshëm siç edhe e bënte. Për këtë, trupi gjykues e klasifikoi grupin si një bashkim të strukturuar, sipas Nenit 120 nën 13 dhe 14 të KPK-së.

(b) I themeluar përgjatë një periudhe kohore

226. Grupi po punonte së paku që prej Nëntorit të vitit 2012, dhe vazhdoi të operonte deri në Dhjetor të vitit 2013, dhe për këtë është themeluar përgjatë një periudhe të konsiderueshme kohore, siç kërkohet nga dispozita ligjore.

(c) Për kryerjen e ndonjë veprë të caktuar penale

227. Synimi i vetëm i grupit ishte që të kryente disa vepra të caktuara penale, domethënë kontrabandimin e migrantëve, sipas Nenit 170 (6) të KPK-së, siç është vlerësuar në pjesën më lartë. Synimi për ta themeluar grupin ishte për të qeverisur një strukturë të qëndrueshme që do të mund të përdorej në çdo kohë për të ekzekutuar operacione të mëtutjeshme të kontrabandimit.

(d) Duke vepruar në bashkëpunim, me synimin për të kryer vepra të rënda penale

228. Pjesëtarët e grupit vepruan në bashkëpunim për të kryer veprën penale të kontrabandimit të migrantëve. Siç përshkruhet më lartë, të gjithë pjesëtarët e atij grupi kontribuan në organizatë dhe në ekzekutimin e operacioneve të kontrabandimit. Ata i koordinuan veprimet e tyre ndemjet veti, apo ishin drejtuar nga i pandehuri kryesor S.Q.1.. Kontrabandimi i migrantëve është një vepër e rëndë penale sipas nënkuptimit të dispozitës. Sipas Nenit 283 (1) të KPK-së, një vepër penale në këtë kuptim është vepër penale e cila është e ndëshkueshme me burgim prej së paku katër vjetësh.¹⁹³ Edhe nëse formulimi nuk është i qartë siç mund të jetë, pa asnjë dyshim që ky definicion i referohet minimumit të një ndëshkimi maksimal, kështu që kjo i përfshinë të gjitha veprat penale që bartin një ndëshkim maksimal prej katër apo më shumë vitesh. Kontrabandimi i migrantëve në paragrafin (1) bart një ndëshkim me burgim prej dy deri në dhjetë vite, dhe për këtë është vepër penale e rëndë.

(e) Për të siguruar përfitim material

229. Synimi i vetëm i grupit ishte që të siguroj përfitim material. Ata kërkuan tarifa për udhëtimin që i tejkalonin për së tepërmi shpenzimet e transportit, duke e ditur që

¹⁹³ Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Neni 2, termet grup i Organizuar Kriminal dhe krim i organizuar janë definuar siç vijon: (a) “Grup i organizuar kriminal” do të thotë një grup i strukturuar prej tre apo më shumë personave, që ka ekzistuar përgjatë një periudhe kohore dhe që ka vepruar në bashkëpunim, me synimin e kryerjes së një apo më shumë krimeve apo shkeljeve të rënda, të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, në mënyrë që të siguroj, drejtpërdrejt apo tërthorazi, një përfitim financiar apo përfitim tjetër; dhe (b) “Krim i rëndë” do të thotë një sjellje që përbën një shkelje të ndëshkueshme me dënimin maksimal të heqjes së lirisë prej së paku katër vitesh. Duhet të vihet në pah se ligji në Kosovë është i bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara, dhe se synimi eksplícit i konventës është që të luftoj kundër – në mes tjerash – kontrabandimin e migrantëve (shih Aneksin 3).

individët apo anëtarët e familjeve të tyre do të ishin të gatshëm ti paguanin këto shuma, pasi që ata ishin të dëshpëruar për tu larguar nga Kosova, dhe të arrinin në shtetet e Unionit Evropian, pa marrë parasysh sesi.

(f) Pjesëmarrja aktive

230. Gjykata i referohet vlerësimit të bërë më lartë dhe thekson se të katër të pandehurit, më disa raste kanë qenë të angazhuar aktivisht në veprat penale të grupit, pasi që ata të gjithë kanë kryer veprat penale të kontrabandimit të migrantëve, dhe atë në disa raste.

(g) Qëllimi dhe të qënurit në dijëni

231. Elementet e kërkuara subjektive të veprave penale, janë përmbushur gjithashtu. Siç vijon nga faktet e përcaktuara, të katër të pandehurit ishin në dijëni për aktivitetet kriminale të grupit. Edhe pse jo të gjithë të pandehurit i njihnin të gjithë bashkëkryerësit tjerë, ata të gjithë ishin në dijëni mbi strukturën e grupit, dhe dallimin e rroleve ndërmjet bashkëkryerësve në shtete të ndryshme.¹⁹⁴ Siç është paraqitur nga provat, të pandehurit posaçërisht ishin në dijëni mbi pjesën e përfitimit ndërmjet pjesëtarëve të ndryshëm në grupet ndërkombëtare. Ata të gjithë e dinin që grupi po punonte në nivel ndërkombëtar, që ishte aktiv për një periudhë prej një viti apo më gjatë, dhe se objektivi i tij i vetëm ishte të siguroj përfitim. Sipas Nenit 21 të KPK-së, një person vepron me qëllim të drejtpërdrejt kur ai është në dijëni për aktin e tij apo saj, dhe dëshiron kryerjen e atij akti. Të katër të pandehurit e dinin se veprimet e tyre po kontribuonin drejt synimit të grupit për të përfituar nga mundësimi i kalimit ilegal të kufirit për migrantët, dhe kjo ishte saktësisht ajo që ata donin.

(3) Asistimi i një personi tjetër në shpëlarjen e parave, Neni 32 i Ligjit mbi Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit

232. Në akuzën 10 të aktakuzës, të pandehurit **S.Q., S.S.** dhe **L.M.** janë akuzuar me asistimin e pësonit tjetër, domethënë S.Q.1, me shpëlarjen e parave, duke shkelur kështu Nenin 32 të Ligjit mbi Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, në ndërlidhje me Nenin 25 të KPK-së. Pas negociimit të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë me të pandehurin kryesor S.Q.1, prokuroria e tërhoqi akuzën e shpëlarjes së parave, dhe në përputhje me këtë, në aktgjykim është hedhur poshtë akuza.

¹⁹⁴ Në fakt kjo është strategji tipike e punës së atyre grupeve, që jo të gjithë pjesëtarët të jenë në dijëni të plotë mbi të gjithë pjesëtarët e tjerë.

233. Gjykata konkludon se të pandehurit në rastin konkret nuk mund të dënohen për asistimin në një vepër penale e cila është hedhur poshtë për kryerësin kryesor, dhe për këtë konkludoi se të pandehuri duhet të lirohen sa i përket kësaj akuze.

III. Bashkëveprimet

234. Trupi gjykues gjeti se të katër të pandehurit në vazhdimësi kanë kryer veprën penale të kontrabandimit të migrantëve sikurse edhe veprën penale të pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal. Trupi gjykues konkludon se edhe pse këto dy vepra penale pjesërisht përbëhen nga të njëjtat elemente, të pandehurit shpallen fajtorë për të dyja veprat penale.

235. Ndërlidhja ndërmjet dy veprave penale nuk është ajo e *lex specialis*, kështu që kjo nuk shpie tek një konsumim i njëjës prej veprave penale. Një vepër penale e konsumon tjetrën vetëm nëse ato kanë të bëjnë me të njëjtat vlera të mbrojtura. Ky nuk është rasti këtu, edhe nëse të pandehurit kryen kualifikimin e veprës penale të kontrabandimit të migrantëve të dhënë në Nenin 170 (6) të KPK-së. Trupi gjykues e potencon se vlerat e mbrojtura të këtij kualifikimi – kryerja e një veprë të caktuar penale si një grup – dallon nga vlerat e mbrojtura të rregulloreve të krimit të organizuar. Përderisa kualifikimi në paragrafin (6) është i ndëshkueshëm me një dënim më të lartë për shkak të rrezikshmërisë konkrete më të lartë që imponohet gjatë kryerjes së veprës penale, kriminalizimi i grupit të organizuar ka një arsye më ndryshe dhe më të gjerë. Rreziku specifik i një grupi të organizuar kriminal siç përshkruhet në Nenet 283, dhe 120 nën 13 të KPK-së, qëndron në faktin se kjo organizatë e krijon një strukturë permanente për kryerjen e veprave penale të mëtejme, përfshirë një mekanizëm për të iniciuar vepra tjera penale. Kjo strukturë paraqet një kërcënim më të përgjithshëm për shoqërinë, që dallon nga rreziku i një grupi që bashkëpunon për ta kryer një vepër të caktuar penale.

H. Dënimi

I. Ligji në fuqi

236. Trupi gjykues i referohet vlerësimit të bërë më lartë dhe vë në dukje që ligji në fuqi sa i përket ndëshkimit janë Nenet 170 dhe 283 të KPK-së, në ndërlidhje me dispozitat e Kapitullit III të KPK-së.

II. Rregullat e Përgjithshme dhe Qëllimet e Ndëshkimit

237. Sipas Nenit 41 të KPK-së, qëllimet e ndëshkimit janë (1) për ta parandaluar kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe për ta rehabilituar kryerësin; (2) për ti parandaluar personat tjerë nga kryerja e veprave penale; (3) të ofroj kompensim për viktimat apo komunitetin për humbjet dhe dëmtimet e shkaktuara nga sjellja kriminale; dhe (4) për ta shprehur gjykimin e shoqërisë për veprat penale, ngritjen e moralit dhe fuqizimin e obligimit për ta respektuar ligjin.

238. Sipas Nenit 73 të KPK-së, Gjykata do ta përcaktoj ndëshkimin e një veprë penale brenda kufijve të përcaktuar nga ligji, për një vepër penale të tillë, duke marrë parasysh qëllimin e ndëshkimit, të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me lehtësimin apo rëndimin e ndëshkimit për secilin të pandehur, dhe në veçanti, shkallën e përgjegjshmërisë penale, motivet për kryerjen e aktit, intensitetin apo rrezikun ose lëndimin e vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer akti, sjellja e kryerësit në të kaluarën, rrethanat personale të kryerësit dhe sjellja e tij apo saj pas kryerjes së veprës penale. Në përputhje me Nenin 73 (2) të KPK-së, ndëshkimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe sjelljes dhe rrethanave të shkelësit të ligjit.

III. Bashkëveprimet

239. Në rastin konkret trupi gjykues gjeti për të gjithë të pandehurit se ata ishin fajtorë për Pjesëmarrje në një Grup të Organizuar Kriminal, sipas Nenit 283 (1), sikurse edhe për Kontrabandim të Migrantëve, sipas Nenit 170 (1), (3) dhe (6) të KPK-së.

240. Trupi gjykues gjeti se ai duhej ta jepte një ndëshkim të vetëm për secilin të pandehur, pavarësisht rregullores së Neneve 80 dhe 370 (6) të KPK-së. Trupi gjykues mori në konsideratë që të pandehurit i kryen të dyja veprat penale deri në një pjesë të caktuar përmes veprimeve të njëjta, dhe për këtë konkludoi se Neni 80 i KPK-së nuk vihet në zbatim¹⁹⁵.

241. Në përfundim gjykata gjeti se kufijtë e zbatueshëm për ndëshkim për të gjithë të pandehurit, janë ata të përcaktuar me Nenin 283 të KPK-së, që thotë se Pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal është e ndëshkueshme me gjobë dhe burgim prej së paku shtatë vjet.

IV. Lehtësimi i ndëshkimeve

242. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të rrethanave specifike për të gjithë të pandehurit, dhe duke u bazuar në Nenin 75 (1.2) në ndërlidhje me Nenin 76 (1.2) të KPK-së, trupi gjykues gjeti se ndëshkimi minimal për të gjithë të pandehurit duhej të reduktohej në atë me burgim prej së paku tri vjet.

¹⁹⁵ Në këtë drejtim vihet re se, ndërsa në pjesën e parë të nenit 80 (1) të KPK-së ai thotë se "nga një ose më shumë vepra", pjesa e dytë e këtij paragrafi i referohet në mënyrë të qartë një numri të shumëfishtë të akteve.

243. Për të pandehurin **S.Q.**, trupi gjykues gjeti një rrethanë posaçërisht lehtësuese në faktin se ai po vepronte vetëm sipas udhëzimeve të vëllait të tij më të vjetër, dhe se ai për këtë nuk ekzekutonte asnjë prej vendimeve vetanake të përgjegjshme kur merrte pjesë në grup. Edhe pse ai kishte një detyrë të rëndësishme brenda grupit, përfshirja e tij si rezultat i mungesës së përgjegjësisë mund të klasifikohet si e vogël. Më tutje, trupi gjykues nuk mund ta përcaktonte se i pandehuri mori pjesë në organizatë me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejt siguroj përfitim material, dhe se ai në të vërtetë përfitoj personalisht nga përfshirja e tij.
244. Sa i përket të pandehurve **L.M.**, **F.K.** dhe **S.S.**, trupi gjykues e gjeti si rrethanë të posaçme lehtësuese që të tre të pandehurit u deklaruan fajtorë në akuzën për Kontrabandim të Migrantëve. Edhe pse këto deklarime nuk do ti përmbushnin kushtet formale të deklarimit si i fajshëm, pasi që deklarimi i pjesshëm i fajësisë nuk është i paraparë me ligj¹⁹⁶, trupi gjykues gjeti se kjo rrethanë duhet të merret parasysh në favor të pandehurve.

V. Përcaktimi Konkret i Ndëshkimeve

245. Kur i përcaktoi ndëshkimet konkrete, trupi gjykues mori parasysh për të katër të pandehurit që rreziku ndaj vlerave të mbrojtura të dispozitave të atakuara, është shumë i lartë. Migrimi ilegal i Kosovarëve për në shtetet e Unionit Evropian nuk po i dëmton vetëm strukturat e administratës publike në shtete e destinacionit, por po e dëmton gjithashtu edhe shoqërinë në Kosovë. Fenomeni i rritur i migrimit ilegal po e destabilizon zhvillimin në Kosovë, dhe është pengesë në rrugëtimin e shtetit për në liberalizimin e vizave. Si rezultat i rregulloreve në fuqi, shumica e shtetasve të Kosovës nuk kanë perspektivë për të qëndruar në shtetet e Unionit Evropian që ata dëshirojnë të arrijnë. Shumë nga ata me gjasë do të kthehen si të zbulohet qëndrimi i tyre. Duke i ushqyer shpresat e rrejshme të atyre njerëzve për të gjetur një jetë më të mirë në shtete tjera, të pandehurit i parandalojnë ata nga krijimi i një perspektive për jetët e tyre në Kosovë.
246. Trupi gjykues më tutje mori parasysh se të pandehurit shfrytëzuan situatën e migrantëve të cilët dëshpërimisht donin që të shkonin jashtë shtetit, dhe që ata për këtë ishin në gjendje të kërkonin shuma enorme si kompensim për organizimin e udhëtimeve të tilla. Shumë shpesh personat e interesuar duhej të shpenzonin një shumë e cila i tejkalonte të ardhurat disa mujore; në një rast babai i emigrantit të kontrabanduara duhej ta shiste lopën e tij.
247. Në anën tjetër, trupi gjykues mori parasysh që ata migrantë që dhanë deklarata në shqyrtimin gjyqësor, nuk u ankuan në mënyrë eksplicite për të pandehurit, por pohuan

¹⁹⁶ Sipas nenit 326 (1), në lidhje me 248 (1) KPP deklarimi i fajësisë kërkon që i pandehuri të e pranojë fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

se ata ishin mirënjohës që të pandehurit u ndihmuan anëtarëve të familjeve të tyre që të shkonin jashtë shtetit, pavarësisht shumës së madhe të parave që është paguar për këtë ndihmë.

(1) Përcaktimi Konkret i Ndëshkimit për të Pandehurin S.Q.

248. Në rastin e **S.Q.**, trupi gjykues gjeti si një rrethanë lehtësuese shkallën bukur të ulët të pjesëmarrjes së të pandehurit në veprën penale. Edhe pse transaksionet financiare që ai i bëri përfaqësojnë një aspekt të rëndësishëm në garantimin e funksionimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të grupit, i pandehuri ishte në masë të konsiderueshme më pak i përfshirë sesa shumica e bashkëkryerësve tjerë. Trupi gjykues më tutje mori parasysh se si rezultat i strukturave tradicionale të familjes në Kosovë, mund të ketë qenë e vështirë për të pandehurin që mos ti bindet udhëzimeve të dhëna nga vëllai i tij më i vjetër.
249. Si rrethanë rënduese, trupi gjykues e mori periudhën e gjatë kohore, gjatë së cilës i pandehuri ishte i përfshirë në grup, dhe numrin e madh të viktimave të përfshira.
250. Sa i përket përgjegjësisë penale së të pandehurit, trupi gjykues gjen se ai ishte plotësisht përgjegjës. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues e mori sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, pasi që ai duhej të konsiderohej si i padënuar sepse trupi gjykues nuk shënoi asnjë dënimi të mëparshëm. Rrethanat personale të pandehurit, i cili punon si kuzhinier për ta mbajtur gruan dhe prindërit e tij, janë marrë parasysh në favor të tij.
251. Në peshimin e kujdesshëm të të gjitha rrethanave të lartpërmendura dhe duke marrë parasysh qëllimet sikurse edhe rregullat e përgjithshme për ta përcaktuar ndëshkimit, Gjykata i cakton një dënim me burgim prej 4 vitesh dhe një gjobë 1,000 Euro.

(2) Përcaktimi Konkret i Ndëshkimit për të Pandehurin L.M.

252. Kur e përcaktoi ndëshkimit konkret për të pandehurin **L.M.**, trupi gjykues e mori si rrethanë lehtësuese që i pandehuri u deklarua fajtor në veprën penale të kontrabandimit të migrantëve. Ai e pranoi që në tri apo katër raste ai i vendosi njerëzit në kontakt me organizatën dhe i udhëhoqi ata për në Veri të Kosovës. Edhe pse ai deklaroi se ai vetëm dëshiroi tu ndihmonte këtyre njerëzve dhe se ai nuk përfitoi nga aktivitetet e tija, ai deklaroi se pendohet për sjelljen e tij.
253. Si rrethanë rënduese trupi gjykues e mori periudhën e gjatë kohore gjatë së cilës i pandehuri ishte i përfshirë në grup, numrin e madh të viktimave që ishin përfshirë dhe shkallën e lartë të angazhimit të pandehurit, në grup. Trupi gjykues e përcaktoi se i

pandehuri, përgjatë një periudhe të gjatë kohore, ishte gati çdo ditë i angazhuar në rekrutimin e klientëve të rinj dhe në organizimin e udhëtimeve të tilla. I pandehuri është shok i udhëheqësit të grupit, S.Q.1, ka vite tashmë, dhe ai luajti një rrol të rëndësishëm në organizimin e veprave penale në Kosovës.

254. Sa i përket përgjegjshmërisë penale së të pandehurit, trupi gjykues gjen se ai është plotësisht përgjegjës. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues mori sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, pasi që ai duhej të konsiderohej si i padënuar sepse trupi gjykues nuk shënoi asnjë dënim të mëparshëm. Trupi gjykues e konsideroi si rrethanë lehtësuese statusin e varfër ekonomik të pandehurit, i cili i kreu veprat penale për ta mbajtur familjen e tij, sikurse edhe faktin që ai ballafaqohej me probleme me alkoolin gjatë kohës që ai i kreu veprat penale. Rrethanat personale të pandehurit, i cili është i shkurorezuar, baba i dy fëmijëve, dhe që prej së voni është duke punuar si roje e sigurisë, janë konsideruar në favor të tij.
255. Në peshimin e kujdesshëm të të gjitha rrethanave të lartpërmendura dhe duke marrë parasysh qëllimet e ndëshkimit sikurse edhe rregullat e përgjithshme për ta përcaktuar ndëshkimin, Gjykata i cakton një dënim me burgim prej 4 vitesh dhe një gjobë 1,000 Euro.

(3) Përcaktimi Konkret i Ndëshkimit për të Pandehurin F.K.

256. Kur e përcaktoi ndëshkimin konkret për të pandehurin **F.K.**, trupi gjykues e mori si rrethanë lehtësuese që i pandehuri u deklarua fajtor për veprën penale të kontrabandimit të migrantëve. Ai e pranoi se në dy raste ai i informoi njerëzit sesi të shkonin ilegalisht në shtetet e Unionit Evropian, dhe i udhëhoqi ata deri në veri të Kosovës.
257. Si rrethanë rënduese trupi gjykues e mori periudhën e gjatë kohore gjatë së cilës i pandehuri ishte i përfshirë në grup, numrin e madh të viktimave që ishin të përfshirë, dhe shkallën e lartë të angazhimit të të pandehurit, në grup. Trupi gjykues erdhi në përfundimin se i pandehuri, përgjatë një periudhe të gjatë kohore, ishte i angazhuar gati çdo ditë në rekrutimin e klientëve të rinj dhe në organizimin e udhëtimeve të tilla.
258. Sa i përket përgjegjësisë penale të të pandehurit, trupi gjykues gjen se ai është plotësisht përgjegjës. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues e mori sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, pasi që ai duhej të konsiderohej si i padënuar sepse trupi gjykues nuk shënoi asnjë dënim të mëparshëm. Trupi gjykues e konsideroi si rrethanë lehtësuese statusin e varfër ekonomik të të pandehurit, i cili i kreu veprat penale për ta mbajtur familjen e tij. Rrethanat personale të të pandehurit, i cili është baba i dy fëmijëve dhe punon si bujk, janë konsideruar në favor të tij.

259. Në peshimin e kujdesshëm e të gjitha rrethanave të lartpërmendura dhe duke marrë parasysh qëllimet e ndëshkimit sikurse edhe rregullat e përgjithshme për ta përcaktuar ndëshkimin, Gjykata i cakton një dënim me burgim prej 4 vitesh dhe një gjobë 1,000 Euro.

(4) Përcaktimi Konkret i Ndëshkimit për të Pandehurin S.S.

260. Kur e përcaktoi ndëshkimin konkret për të pandehurin **S.S.**, trupi gjykues e mori si rrethanë lehtësuese që i pandehuri u deklarua fajtor për veprën penale të kontrabandimit të migrantëve. Në veçanti është marrë parasysh që në dy nga të katër akuzat për të cilat i pandehuri është dënuar, ai e pranoi se ai u ndihmoi njerëzve të shkonin jashtë shtetit, duke i vendosur ata në kontakt me bashkëkryerësit tjerë dhe duke i udhëhequr ata deri në veri të Kosovës.

261. Gjatë shqyrtimit të dënimit konkret Trupi Gjykues ka marrë parasysh faktin se i pandehuri ishte i përfshirë në aktivitete të grupit së pakut nga muaji shkurt i vitit 2012 deri në dhjetor 2013, dhe se ka marrë pjesë në së pakut katër operacione të kontrabandës.

262. Sa i përket përgjegjësisë penale të të pandehurit Trupi Gjykues gjen se ai ishte plotësisht përgjegjës. Si rrethanë lehtësuese Trupi Gjykues ka gjetur sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, me që ai duhet të konsiderohet si i padënuar sepse Trupi Gjykues nuk ka administruar ndonjë dënim paraprak. Trupi Gjykues e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese gjendjen e dobët ekonomike të të pandehurit, dhe faktin se ai jeton me familjen e tij dhe punon si bujk.

263. Pas vlerësimit të kujdesshëm të të gjitha rrethanave të lartcekura dhe duke marrë parasysh qëllimet e dënimit si dhe rregullat e përgjithshme për caktimin e dënimit, Gjykata shqipton dënimin me burg prej 3 vjetësh dhe gjobën prej 500 Euro.

VI. Dënimet shtesë

264. Trupi Gjykues nuk e ka parë të nevojshme të shqiptoj dënime shtesë për ndonjë të pandehur.

I. KONFISKIMI

265. Trupi Gjykues ka konstatuar se disa nga sendet që ishin konfiskuar gjatë bastisjes së lokaleve të të pandehurve duhet të sekuestrohen përgjithmonë, ndërsa tjerat t'u kthehen pronarëve apo poseduesve. Sipas nenit 115 (1) KPP sendet e sekuestruara përkohësisht duhet të sekuestrohen në mënyrë të përhershme nëse Prokuroria i

përshkruan ato sende në aktakuzë (1.1) dhe nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se ato sende kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale(1.2), dhe se ato janë konfiskuar sipas ligjit (1.3).

266. Sipas nenit 283 KPP Prokurori duhet të vërtetojë gjatë shqyrtimit gjyqësor se sendet e caktuara janë përdorur në veprën penale, Sipas paragrafit (2.1) sendi është përdorur në veprën penale nëse është përdorur drejtpërdrejt për ta kryer një veprim në mbështetje të veprës penale.

267. Duke marrë parasysh faktet e vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor Trupi Gjyqësor ka konstatuar se është vërtetuar se telefonat mobil dhe SIM kartelat që janë gjetur në lokale të katër të pandehurve janë përdorur për veprimtari kriminale dhe prandaj kanë mundësuar kryerjen e veprave penale. Të pandehurit kanë përdorur telefonat dhe SIM kartelat si mënyrën kryesore të komunikimit. Prandaj ato duhet të konfiskohen përgjithmonë.

268. Sipas neneve 96 dhe 97 KPK asnjë person nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar nga vepra penale; dobia pasurore duhet të konfiskohet sipas rregullave të përcaktuara me nenin 97 KPK. Dobia pasurore sipas përkufizimit në nenin 120 Nr. 34 KPK është “çfarëdo pasurie e cila fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale. Pasuria e cila fitohet tërthorazi nga vepra penale përfshinë pasurinë në të cilën pastaj është konvertuar, transformuar apo përzier çfarëdo pasurie drejtpërdrejtë e fituar nga vepra penale, si dhe të ardhurat, kapitalin apo dobitë tjera ekonomike të fituara ose realizuara për pasurinë e tillë në çfarëdo kohe që prej kryerjes së veprës penale.” Neni 276 dhe 277 KPK përmban shpjegime të ngjashme.

269. Pas shqyrtimit të kujdesshëm informatat në dispozicion dhe faktet e vërtetuara Trupi Gjyqësor ka konstatuar se nuk është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor se veturat të cilat ishin konfiskuar tek lokalet e **S.Q.** (xxx me numër targe xxx), **F.K.** (xxx me numër targe xxx) dhe **S.S.** (xxx me numër targe xxx) ishin dobi nga veprat penale. Megjithatë ato teorikisht do mund të konfiskoheshin si dobi të drejtpërdrejta po të ishin blerë me paratë e fituara nga veprimtari kriminale, Trupi Gjyqësor nuk ka gjetur prova për këtë. Prokuroria I referohet faktit se të tre të pandehurit nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme gjatë periudhës në të cilën kanë kryer veprën penale, por nuk ka paraqitur ndonjë informatë tjetër lidhur me rrethanat e blerjes së veturave. Trupi Gjyqësor ka konstatuar se fakti kryesor se origjina e fondeve për blerjen e veturave është e panjohur nuk mjafton për të përmbushur kërkesat ligjore për sekuestrimin e veturave.

J. SHPENZIMET E PROCEDURËS

270. Sipas nenit 453 lidhur me nenin 450 KPP, shpenzimet e procedurës duhet të kompensohen nga të pandehurit.

Jennifer Seel

Kryetare e Trupit Gjykses

MJETI JURIDIK: Personat e autorizuar (i pandehuri, prokurori dhe pala e dëmtuar) mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate. Ankesa mund të parashtrohet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e marrjes së një kopje të aktgjykimit në formë të shkruar nga palët.